RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

MBI

"AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË" TË USHTRUAR NË BASHKINË PËRMET

Tiranë 2021

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4
1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit 4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 4
3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit 8
II. HYRJA 12
1. Objektivat e auditimit 12
2. Qëllimi i auditimit 12
3. Idetifikimi i çështjes 13
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 13
5. Përgjegjësitë e audituesve 13
6. Kriteret e vlerësimit 13
7. Standardet e auditimit 14
8. Metodologjia e auditimit 14
9. Dokumentimi i auditimit 16
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 16
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin 16
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit 18
2.1 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për periudhën 2019 – 2020. 18
2.2 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitet 2018-2019-2020. 37
2.3 Mbi zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, për periudhën 01.01.2018-31.12.2020. 50
2.4 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme 91
2.5 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm 97
2.6 Të ndryshme – Trajtimi i ankesave 102
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME 105
V. ANEKSET 115

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave të Ndërtimeve Informale
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
DFB	Drejtoria e Financës dhe Buxhetit
DTTV	Drejtoria e Tarifave dhe Taksave Vendore

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 873/1 Prot, datë 03.09.2021, ndryshuar me shkresën nr. 873/2 Prot., datë 30.09.2021 të miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 07.09.2021 deri më datë 22.10.2021 në Bashkinë u krye në terren auditimi financiar dhe i përputhshmërisë, për periudhën 01.01.2018-31.12.2020.

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Përmet si: menaxhimi financiar dhe kontrolli i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, vlerësimi i pasqyrave financiare, prokurimet publike, të ardhurat, zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, si dhe planifikimi dhe zhvillimi i teritorit.

Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Përmet12 akt konstatime dhe 1 akt verifikim. Mbi akt konstatimet dhe akt verifikimet e mbajtura nga grupi i auditimit janë paraqitur observacionet përkatëse nga Bashkia Përmet, të cilat janë pasqyruar gjatë hartimit të projekt raportit të auditimit. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur kundërshtime edhe mbi projekt raportin e auditimit të cilat janë trajtuar nga grupi i auditimit me objektivitet dhe profesionalizim sipas çështjeve përkatëse.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Rekomandimi
1	Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik, në zbatim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 37. Mungon Plani i Masave dhe Veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës. Ka mungesë të dokumenteve (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat të dokumentojnë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit. Nuk ka mbledhje të dokumentuara të GMS, për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë. Publikimi i dokumenteve në faqen zyrtare të bashkisë Përmet apo në vendime.al ka vonesa dhe mungesa në afatet e publikimit. Ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Realizimi i buxhetit ndaj	E lartë	Bashkia Përmet, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti zbatimi i buxhetit. Bashkia Përmet të marrë masa, të dokumentojë mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi, duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore. Bashkia Përmet të marrë masa për publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak në faqen zyrtare apo në vendime.al brenda 15 ditëve. Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të mblidhet për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit (të dokumentuara). Të kryhet Plani i Masave dhe Veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të

	planit për vitin 2018 ka arritur 85.1 %, për vitin 2019 ka arritur në 85.9 % dhe në vitin 2020 ka arritur në 84.6 %. -Detyrimet kreditore për fund vitin 2017, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 5,448,254 lekë. -Detyrimet kreditore për fund vitin 2018, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 9,782,208 lekë. -Detyrimet kreditore për fund vitin 2019, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 3,427,178 lekë. *(18-38 të RPA).*		zhvillohen, afati, personat përgjegjës.
2	Detyrimet e prapambetura deri më datë 31.12.2020 janë në vlerën 14,666,184 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò. Ndër të cilat vlerën më të lartë të shpenzimeve të pa likuiduara i zënë investimet në vlerën 10,335,785 lekë ose 70.47 %. Detyrimi i papaguar në lidhje me investimet e kryera si ndërtimi i shkollës së mesme me subjekt ñAlb Constuksionò ShPK dhe rehabilitimi i banesave me subjekt ñN.ò ShPK, faturat janë të muajt shkurt dhe maj 2020. Mallra dhe shërbime në vlerën 2,346,886 lekë ose 16 %, vlerë e pa likuiduar i cili i përket Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), faturat e pa paguara të vitit 2007. Mbi arsyet e mos likuidimit të kësaj vlere, Bashkia Përmet deklaron se i kanë dërguar shkresa OSHEE- s në lidhje me detajimin e këtij detyrimi, nga e cila nuk ka patur përgjigje. Në vlerën e detyrimeve të papaguara shfaqet edhe detyrimi 1,983,513 lekë ndaj detyrimeve të vendimeve gjyqësore ose 13.5 %, nga të cilat 554,334 lekë janë detyrime që nga viti 2012 dhe 2013. Detyrimet për vendimet gjyqësore kanë të bëjnë me detyrime ndaj punonjësve të larguar nga ky institucion. Nga totali i detyrimeve të vendimeve gjyqësore, vetëm 2 prej këtyre rasteve kanë kaluar me përmbarues. *(faqe 18-38 të RPA).*	E lartë	Bashkia Përmet të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.
3	Referuar ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò, Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018, ñPër Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeñ grupi auditues konstatoi se në Aktivet Afatgjata Financiare, llogaria 26 ñPjesëmarrja me kapitalin e vetò është në vlerën 0 lekë, vlerë e cila duhet të përfaqësonte vlerën e aksioneve që ka Ujësjellës Kanalizime Sh.a Përmet. Bashkia Përmet i vendosi në dispozicion grupit auditues Vendimin e Gjyqtarit të vetëm, më datë 02.04.1999 për miratimin e ekspertit kontabël, i cili do bënte dhe vlerësimin e kapitalit kontabël sipas ligjit 8237, datë 1.09.1997 ñPër disa ndryshime në ligjin 7926, datë 20.04.1995 ñPër transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtareò, ndryshuar dhe me akte të tjera ligjore. Gjyqtari i vetëm ka vlerësuar kapitalin themeltar të shoqërisë prej 66,315,000 lekë, nga kjo vlera e truallit është 5,590,928 lekë, numri i aksioneve është 66,315 dhe	E lartë	Nga Bashkia Përmet, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të përditësuar në kontabilitet dhe për të regjistruar pjesëmarrjen 100% në kapitalin aksionar të Ujësjellës Kanalizime Përmet Sh.a me vlerë kontabël **0 lekë** në debi të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

	vlera nominale e aksionit është 1000 lekë. Në llogarinë 26 nuk është përcaktuar dhe nuk është përditësuar vlera pasi është krijuar ndërmarrje ñUjësjellës Kanalizime Përmetò Sha. *(faqe 38-51 të RPA).*		
4	Për procedurën e prokurimitme objekt: *"Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara"* mungon argumentimi i kritereve të veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk janë në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit. Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, neni 46, pika 1 dhe kërkesat e VKM-së 914, datë 24.12.2014 ñPër rregullat e Prokurimit Publikò neni 26, pika 5. Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, dhe shpallja fitues e BOE ñE.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DT. *(faqe 51-93 të RPA).*	E lartë	Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masa për përcaktimin e DT në përputhje me **natyrë**n dhe volumin e punimeve dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DT.
5	Referuar ligjit 9632ñPër sistemin e taksave dhe tarifave vendore", në vitet 2018- 2020 ñUjësjellës Kanalizime Përmetò Sh.a, ka arkëtuar nga taksat dhe tarifat vendore vlerën 35,963,884 lekë, nga të cilat për vitet 2018 dhe 2019 ñUjësjellës Kanalizime Përmetò Sha ka përfituar 10 % të shumës mujore të derdhur dhe 5 % në vitin 2020 të të ardhurave të arkëtuara. Ky subjekt i ka transferuar nëpërmjet bankës së nivelit të dytë, Bashkisë në vlerën 22,252,444 lekë përkundrejt vlerës 32,9366,109 lekë që duhet të arkëtonte për llogari të institucionit. Detyrimi nga diferencat është rritur nga viti në vit dhe në 31.12.2020, ky detyrim është në vlerën **15,393,615 lekë, e ardhur e munguar në Bashkinë Përmet.** *(faqe 18-38 të RPA).*	E lartë	Bashkia Përmet të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **15,393,615 lekë** dhe të mos kemi rritje nga viti në vit të detyrimit të ñUjësjellës Kanalizime Përmetò Sh.a kundrejt Bashkisë Përmet.
6	Vlera e debitorëve nga bizneset deri më datë 31.12.2020 paraqitet 14,022,894 lekë, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset, e cila përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Përmet, referuar ligjit 9632ñPër sistemin e taksave dhe tarifave vendore". Vlera e gjobave llogaritet në 1,897,248 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Përmet. Në total llogaritet 15,920,142 lekë e ardhur e munguar për Bashkinë Përmet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset. Vlera e debitorëve nga familjarët deri më datë 31.12.2020 është 6,697,803 lekë, të ardhura të munguara për Bashkinë Përmet. Mbi këto debitorë familjarë nuk është aplikuar kamatëvonesë. Në lidhje me debitorët familjare, nuk disponojnë një database të saktë me të dhënat e tyre duke specifikuar taksat dhe tarifat që aplikohen, po ashtu nuk e kanë si format paraqitjen e informacionit të plotë ku të paraqitet debia për secilin vit duke filluar që nga vitet e mëparshme. Përdorimi i këtij formati ku të përmblidhen informacionet e mësipërme do të mundësonte analizimin e të dhënave dhe pasqyrimin më të plotë të situatës me debitorët, për secilën nga taksat dhe tarifat e papaguara. Të dhënat e mbajtura në	E lartë	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore në Bashkinë Përmet, të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **22,617,945 lekë** dhe të ndjek hapat e tjera vijuese në masa shtrënguese. Në lidhje me debitorët familjare, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të krijojnë një regjistër, një database të saktë me të dhënat e debitorëve familjarë, duke specifikuar taksat dhe tarifat që aplikohen, po ashtu të paraqesin informacion të plotë ku të specifikohet debia për secilin vit, duke filluar që nga vitet e mëparshme.

	këto formate ekzistuese, paraqesin informacion të cunguar. *(faqe 18-38 të RPA).*		
7	Referuar Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, vlera e debisë me 31.12.2020, bazuar në listat e vendosura në dispozicion nga Zyra e Tatim Taksave është 5,007,646 lekë, e ardhur e munguar për Bashkinë Përmet. Njësia administrative Piskovë shfaqet më problematike përsa i përket detyrimeve të prapambetura në vlerën 1,943,439 lekë dhe më pak problematike shfaqet njësia administrative Frashër me vlerën e detyrimit 256,716 lekë. *(faqe 18-38 të RPA).*	E lartë	Zyra e Tatim Taksave të marr masa me qëllim arkëtimin e detyrimeve në shumën **5,007,646lekë.**
8	Në Bashkinë Përmet operojnë 6 subjekte të cilat tregtojnë karburant dhe gaz, 4 nga këto subjekte nuk e kanë kryer pagesën për përsëritjen e liçencave në kundërshtim me VKM nr.970, datë 2.12.2015, për ñPërcaktimin e proçedurave dhe të kushteve për dhënien e liçencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò, pika 14 dhe në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.4.2017, ñPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 2.12.2015, ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò, pika 9. Të ardhurat e munguara janë në vlerën 3,200,000 lekë. Bashkia Përmet nuk ka aplikuar gjoba për fillimin e aktivitetit pa marrë liçencën në kundërshtim me Paketën Fiskale të vitit 2020, të miratuar me VKB nr. 101, datë 19.12.2019 ku specifikohet se gjoba për fillim e aktivitetit pa marrë liçensën është 20,000 lekë. Në total gjobat rezultojnë të jenë në vlerë 100,000 lekë mungesë të ardhurash për Bashkinë Përmet. *(faqe 18-38 të RPA).*	E lartë	Sektori i Shërbimeve të marrë masa në mbledhjen e detyrimeve në vlerën **3,300,000 lekë** si dhetë aplikojë gjoba për fillim e aktivitetit pa marrë liçensën në rast mospagese pasi mbaron afati i saj.
9	Nga auditimi rezultoi se për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtime të reja është 0.5 % e vlerës së investimit. Llogaritjet janë kryer në bazë të të dhënave të ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi të dërguara nga ALUIZNI, me shkresa zyrtare. Bazuar në data bazën e vënë në dispozicion nga Drejtoria e Urbanistikës, në total ndërtesa të legalizuara nga viti 2015- 2020 rezultojnë të jenë në vlerën 8,503,787.90 lekë, ku vetëm 5,378,480.90 lekë janë paguar referuar VKM, nr. 860, datë 10.12.2014, ñPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizimò si dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, të ndryshuar, neni 22. Taksa e ndikimit në infrastrukturë e pa paguar deri më datë 31.12.2020 është në vlerën 3,125,307 lekë, duke krijuar mungesë të të ardhurave në Bashkinë Përmet. *(faqe 18-38 të RPA).*	E lartë	Drejtoria e Urbanistikës të bashkëpunojë me Aluizni-n që ta ketë data bazën e plotë përsa i përket aplikuesve dhe të dhënave të tyre. Drejtoria e Urbanistikës të marr masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **vlerën 3,125,307 lekë**. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Përmet të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe ALUIZNI Gjirokastër, për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.
10	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **"Rikonstruksion i shkollës së mesme "Sami Frashëri", Bashkia Përmet,** me vlerë të kontratës (me Tvsh) 81,490,378.838 lekë, me nr. 547 prot., datë 01.03.2019, fituar nga OE ñA. K.ò Shpk, rezultuan diferenca në volume pune të pa kryera në fakt në vlerën **338,321.77 lekëpa TVSH**, në zërat ñFV Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingate Ø100mmò, ñFV Kasetë shkarkimi me llamarinë	E lartë	Nga Bashkia Përmet të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **338,321.77 lekëpa TVSH** nga OE ñA. K.ò ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 547 prot., datë 01.03.2019, me objekt: ñRikonstruksion i shkollës së mesme ñSami Frashëriò, Bashkia Përmet, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe

	xingatoò e ñF.V.bordura betoni 15x30cm (në perimetrin e shkollës përeth sheshit)ò. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve.(*faqe 51-93 të RPA).*		njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
11	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **"Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkisë Përmet dhe të Njësive Administrative", Bashkia Përmet,** me vlerë të kontratës (me TVSH) 94,712,204 lekë, me nr. 3270 prot., datë 24.12.2018, fituar nga BOE ñH.ò & ñR.ò ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **182,542.84lekëpa TVSH**, në zërat ñMbushje me çakëll/ose zhavor lumi pas muritò dhe ñNdërtim mur betoni m-200ò. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve. (*faqe 51-93 të RPA).*	E lartë	Nga Bashkia Përmet të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **182,542.84 lekëpa Tvsh** nga ñH.ò & ñR.ò Shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3270 prot, datë 24.12.2018, me objekt: **"Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkise Përmet dhe të Njësive Administrative", Bashkia Përmet**, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
12	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt **"Rikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht" Bashkia Përmet,** me vlerë të kontratës (me Tvsh) 81,490,378.838 lekë, me nr. 1363 prot., datë 04.06.2018, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **285,960 lekë pa Tvsh**, në zërat ñPërgatitje e montim litarë çeliku d=14mmò, ñF.V Morsetaò, ñF.V Tiranda d=1mmò e ñF.V. Kavallota Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve. (*faqe 51-93 të RPA).*	E lartë	Nga Bashkia Përmet të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **285,960 lekëpa TVSH** nga kontraktori ñH.ò ShPK, sipas kontratës me numër 1363 prot., datë 04.06.2018, me objekt: ñRikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht ò Bashkia Përmet, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.
13	Bashkia Përmet nuk ka marrë të gjitha masat e duhura për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit për shpërblim dëmi në vlerën 4,711,194 lekë dhe për 9 masa organizative që ende nuk janë zbatuar. *(faqe 93-98 të RPA).*	E lartë	Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë me strukturat e bashkisë si dhe në Këshillin Bashkiak mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të KLSH të dërguara me shkresat nr. 390/61 Prot., datë 22.10.2019 përkatës dhe hartimin e planeve specifike të punës për: - Zbatimin rekomandimeve për shpërblim dëmi në vlerën **4,199,595**lekë; - Zbatimin e 5 rekomandimeve organizative që janë nxjerrë urdhrat përkatës por rezultojnë ende në proces zbatimi; Zbatimin e 2 rekomandimeve organizative që ende nuk janë zbatuar.

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

<u>a. Opinioni i auditimit mbi Pasqyrat Financiare</u>
<u>Për drejtimin e Bashkisë Përmet</u>

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Përmet, për vitin ushtrimor 2020, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të Pasqyrave Financiare.

Opinion i pamodifikuar, me theksim çështjeje[1]:
Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705[2], dhe ISSAI 1200[3], pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi ñTheksimi i çështjesò.

Baza për opinionin e pamodifikuar, me theksim çështjeje:
Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Përmet, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidenca e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të bazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700).Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e *opinionit të pamodifikuar me theksim të çështjes*.

Theksimi i çështjeve:
Theksojmë nevojën e marrjes së masave nga ana e drejtimit e më pas në linjë hierarkike nga gjithë personeli i subjektit Bashkia Përmet, sa i takon llogarisë së mëposhtme**:**
Në asnjë rast nuk janë evidentuar në llogaritë analitike, si për vitin 2018, 2019 dhe 2020, debitorët për taksat dhe tarifat vendore, tokën bujqësore, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, subjekteve që tregtojnë karburante dhe dhënies me qira të apartamenteve. Nga rakordimi me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Përmet, janë evidentuar detyrimet për vitet 2018, 2019 dhe 2020.Pra nuk është pasqyruar vlera e saktë në llogarinë 468 ñDebitorë të ndryshëmò dhe kundër partinë Klasa 7 e llogarive ñTë ardhuratò, për rrjedhojë nuk janë njohur si të ardhura për vitin 2020, në vlerën 32,823,572 lekë.Nuk janë kryer kontabilizimet në lidhje me vlerën e: debitorëve familjarë për taksën e ndërtesës dhe taksën e shërbimit 6,697,803 lekë;
debitorëve nga bizneset për taksat dhe tarifat vendore 14,022,894 lekë dhe 1,897,248 lekë;
taksës së ndikimit në infrastrukturë 258,481 lekë;
tokës bujqësore 5,007,646 lekë;
subjekteve që tregtojnë karburante 3,200,000 lekë dhe 100,000 lekë gjoba të llogaritura
dhe dhënies me qira të apartamenteve sociale 1,639,500 lekë.
Llogaria 26, në Aktivet Afatgjata Financiare, ñPjesëmarrja me kapitalin e vetò, është pasqyruar në vlerën 0 lekë, e cila përfaqëson vlerën e aksioneve që ka Ujësjellës Kanalizime Sh.a, Përmet dhe nuk është kontabilizuar dhe përditësuar pasi është krijuar ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime Përmet Sh.a.

<u>b. Opinion mbi përputhshmërinë</u>

---

[1]***Opinioni i pamodifikuar me theksim cështjeje.*** *Në rrethana të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të pazakonta ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodh mund të keqinterpretohet si modifikim. Për të evituar dhënien e kësaj përshtypje të gabuar, referencat e menduara si "theksimi i çështjes" përfshihen në një paragraf të veçuar nga ai i opinionit.*

[2] *Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.*

[3]*Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi*

Opinion i pamodifikuar me theksim çështje

Ne kemi audituar planifikimin e nevojave për investime, përputhshmërinë ligjore për zbatimin e kuadrit rregullator në fuqi mbi zhvillimin e procedurave të prokurimit publik. Në opinionin tonë, përsa i takon shkallës së zbatimit nga subjekti Bashkia Përmet të kuadrit rregullator për fushën e prokurimeve publike, referuar kërkesave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar, duke përjashtuar disa anomali materiale, jo të përhapura dhe jo thelbësore për arsyetimin mbi fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një opinioni të pamodifikuar me theksim çështje. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë, si më poshtë:

- Nga auditimi i **4** procedurave me fond limit **80,505,424** lekë (nga të cilat një është anuluar dhe zhvilluar përsëri), nga 29 procedura të zhvilluara më fond limit **431,833,959.20**, janë konstatuar devijime të akteve ligjore/nënligjore të LPP konkretisht si:
- Në **3** raste, kriteret e vendosura nga NJP nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumet e punës.
- Në **2** raste, kualifikimi i ofertës fituese nuk është në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara.
- efektet negative nga zhvillimi i procedurave të prokurimit është në vlerën **81,490,378.838lekëme Tvsh mijë lekë me Tvsh**
-dëmin i shkaktuar nga zbatitimi i kontratave është në vlerën **806,824.61 lekë pa Tvsh**
- Në auditimin e dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave konstatohet se detyrimet e subjekteve fizikë/juridikë deri më 31.12.2020 (debitorët progresiv), janë **15,920,142lekë**, ndërsa detyrime nga familjet për pagesat e taksave dhe tarifave vendore janë **6,697,803lekë.**
- Detyrime nga mos arkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë në **vlerën 3,125,307 lekë.**
- Detyrime nga subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse në vlerën **3,300,000 lekë.**
- Detyrime nga kontratat e qirave në vlerën **1,639,500 lekë.**

Mbi planifikimin, zbatimin e planit të buxhetit dhe realizimin e të ardhurave:

Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik në zbatim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 37.

Mungon Plani i Masave dhe Veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Ka mungesë të dokumenteve (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat të dokumentojnë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit.

Nuk ka mbledhje të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë. Publikimi i dokumenteve në faqen zyrtare të bashkisë Përmet apo në vendime.al ka vonesa dhe mungesa në afatet e publikimit.

Ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Realizimi i buxhetit ndaj planit për vitin 2018 ka arritur 85.1 %, për vitin 2019 ka arritur në 85.9 % dhe në vitin 2020 ka arritur në 84.6 %.

- Detyrimet kreditore për fund vitin 2017, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 5,448,254 lekë.
- Detyrimet kreditore për fund vitin 2018, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 9,782,208 lekë.
- Detyrimet kreditore për fund vitin 2019, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 3,427,178 lekë.

Mbi funksionimin e sistemit të kontrollit dhe auditit të brendshëm:

- Në Bashkinë Përmet nuk është hartuar ñHarta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzoreò, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve.
- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).
- Bashkia Përmet nuk ka miratuar ñStrategjinë e Menaxhimit të Riskutò si dhe nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Përmet nuk ka miratuar Plan Pune Vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjikò. Nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email- it zyrtar të institucionit duke qënë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.
- Në vitin 2018 janë kryer vetëm 40 trajnime dhe për vitin 2019 vetëm 46 trajnime për punonjësit. Në vitin 2020 janë kryer trajnime nëpërmjet Zoom (online). Burimet Njerëzore nuk kanë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera për periudhën e auditimit.
- Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.
- Bashkia Përmet nuk ka patur në strukturën e saj Auditin e Brendshëm, e cila sjell mungesën e vlerësimeve specifike për sistemet e kontrollit të brendshëm.
- Bashkia nuk ka implementuar programe, sisteme për burimet njerëzore, për financën dhe për drejtoritë që mbledhin taksat.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin ñ*Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e Pasqyrave Financiare"* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga subjekti, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e pasqyrave financiare në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë.

<u>Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Përmet</u>

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Përmet, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

<u>Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së</u>

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një

opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.
Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 873/1 Prot, datë 03.09.2021, ndryshuar me shkresën nr. 873/2, datë 30.09.2021, miratuar nga Kryetari i KLSH-^{së}, nga data 07.09.2021 deri në datë 22.10.2021, në subjektin Bashkia Përmet u krye auditimi *Financiar dhe i Përputhshmërisë për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2020.* Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. G. K. ï *Përgjegjës Grupi*
2. E. M. ï *Anëtare*

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Përmet ka si objektiva kryesor:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)[4];
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Përmet është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 2018 - 2020, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

[4]Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

3. Idetifikimi i çështjes
Raporti Përfundimtar i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Përmet dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.
Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:
Pika 1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit,burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
Pika 2. Vlerësimi i raportimit financiar për vitet 2018-2020.
Pika 3. Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike dhe zbatimin e kontratave të punëve publike.
Pika 4. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese
Strukturat drejtuese të Bashkisë Përmet, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve
Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit
Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Përmet është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Përmet. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-^{së} nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar;
- Ligji nr. 109/2017, datë 30.11.2017 ñPër buxhetin e shtetit të vitit 2018ò, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 99/2018, datë 03.12.2018ñPër buxhetin e vitit 2019ò, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019ñPër buxhetin e vitit 2020ò;

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 ñPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshmeò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 ñPër unifikimin e procedurave tëkontrollit të territorit ngaInspektorati Kombëtar iMbrojtjes së Territorit dhe ai iNjësisë Vendoreò;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò.
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò;
- Udhëzimi plotësues Nr. 2 datë 19.1.2019 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò,
- Udhëzimi MFE nr. 1 datë 17.1.2019 ñPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2019ò
- Udhëzimi MFE nr. 2 datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2020ò
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 ñPër nëpunësit zbatues të të gjitha niveleveò;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde te monitorimit te buxhetit te Njësive te vetëqeverisjes vendoreò;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeõõ;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 ñPër Prokurimin Publikò i ndryshuar;
- Udhëzimi i APP nr. 3, datë 08.01.2018 ñPër procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”; etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë.
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 ñPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeòetj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Përmet grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 ñParimet themelore të auditimit të sektorit publikñ;
- ISSAI 400 ñParimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 ñPrezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim *(Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).*

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.
Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.
Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.
4. Kontrolli i vlerësimit.
Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.
5. Konfirmim nga të tretët.
Transaksionet e përzgjedhura për tôju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.
6. Kontrolli sipas një treguesi.
Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.
7. Intervistimi
U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Përmet me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.
8. Raporte dhe Informacione
U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.
9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.
U zhvilluan pyetësorë me strukturat e Bashkisë Përmet për të vlerësuar sistemet e kontrollit të brendshëm.
Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit
Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[5].
Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450,duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tôu audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.
Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c)

[5]ISSAI 1315

funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.
Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon[6].
Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Auditimi nësubjektin ñBashkia Përmetò,ukrye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tâu audituar. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta. Bashkia Përmet është e organizuar dhe

[6]Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

funksionon në bazë Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò dhe Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, Rregulloren e funksionimit të Këshillit Bashkiak, Rregulloren e Funksionimit dhe Organizimit të Bashkisë Përmet si dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Përmet.

Profili i Bashkisë Përmet: Përmeti kufizohet në veri me bashkinë Skrapar, në lindje me bashkinë Kolonjë, në perëndim me bashkinë Libohovë dhe Këlcyrë. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Përmetit. Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 10,614 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil, kjo bashki numëron 20.301 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 601.95 km^2 me një densitet prej 33.72 banorë/km^2. Kjo bashki përbëhet nga 5 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 49 fshatra. Bashkia e Përmetit rrethohet nga pasuri të rralla natyrore e monumentale, por edhe historike, kisha dhe manastire të vjetra. Parku Kombëtar i Hotovës me bredhin e rrallë mesdhetar, banjat kuruese në Bënjë, kanionet e Bënjës dhe të Lengaricës, Shtëpia e vëllezërve Frashëri, Kishat e Leusës, Kosinës, Bualit, Bënjës pasohen nga disa ura tipike me harqe, ndërtime të shek. të XVIII-të si ajo e Katiut apo Bënjës. Këto pasuri natyrore e bëjnë bashkinë e Përmetit një destinacion të lakmueshëm për turistët shqiptarë dhe të huaj. Përmetarët merren me aktivitete të vogla tregtare, të cilat janë fragmentare dhe shpesh punësohen vetëm disa nga anëtarët e familjeve. Ndonëse sektori i turizmit është një nga sektorët kryesorë të zhvillimit ekonomik, ai ende ka pak zhvillim, kapacitete të vogla hotelerie në qytet dhe më pak shtëpi pritëse për turistët në fshatrat përreth. Zonat malore të Përmetit, ndonëse kanë hapësira të mëdha e të virgjëra që mund të shërbejnë për shëtitje dhe alpinizëm. Një nga pasuritë e rralla të zonës, Ujërat Termale të Bënjës, gati 14 km larg qytetit të Përmetit.



Qyteti i Përmetit mori formë pas rregullimeve urbanistike të kryera në vitin 1964 dhe më pas njohu zhvillim të vogël demografik, kryesisht nga banorët që zbrisnin nga fshatrat përreth. Qyteti ka një arkitekturë tipike të periudhës socialiste, me pak ndërtime të reja. Përmeti është ndoshta qyteti me më shumë sipërfaqe të gjelbëruara e lulishte, që vazhdon të ruajë traditën e shëtitjeve të mbrëmjes.

Sfidat me të cilat përballet pushteti vendor pas ndarjes së re

Bashkia e Përmetit ka një strategji zhvillimi të hartuar me konsulence ndërkombëtare, e cila do të kërkojë një mbështetje të fuqishme financiare për t`u realizuar.

Të ardhurat në këtë bashki janë në nivele minimale dhe shpesh bashkia nuk arrin të paguajë as shërbimet për furnizim me energji të institucioneve të saj. Bashkisë do t`i duhet të shtojë lidhjet me programe ndërkombëtare për të thithur donatorë dhe mbështetur sektorin turistik. Ky sektor lidhet edhe me rritjen e tregut për produktet origjinale të zonës apo punimet artizanale. Po kështu, grupet turistike do tõi jepnin mbështetje turizmit familjar që ka nisur të aplikohet në disa zona në mënyrë spontane.

Bashkia duhet të gjejë mundësi të reja për punësimin e grave, sidomos në biznese të vogla prodhuese dhe me profilin e ri të zhvillojë sektorin e agrobiznesit, të vreshtarisë dhe prodhimit të verës. Disa kantina të verës janë në faliment prej problemeve në këtë treg apo investimeve me kredi, ndaj bashkia duhet të hartojë politika se si ky biznes të gjejë një frymëmarrje të re dhe të bëhet i qëndrueshëm.

Shërbimet shëndetësore kanë nevojë të përmirësohen, ndërsa spitali i Përmetit ka nevojë për një staf më profesional dhe për mirëmenaxhim të shërbimeve. Po kështu, sektori arsimor ka nevojë të ristrukturohet në funksion të mbështetjes së transportit të nxënësve dhe të përmirësimit të mjediseve shkollore.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për periudhën 2019 – 2020.

Bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008*"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në* RSHò, ligjet vjetore *përbuxhetin e shtetit të* vitit 2018, 2019 dhe 2020, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit ò, u ushtrua auditimi sa më poshtë vijon:.

Nënpika A.1: Programi buxhetor afatmesëm

Programimi i PBA 2019-2021

Me Urdhrin nr. 14, datë 29.01.2018, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2019- 2021.

Nuk është miratuar nga Këshilli i Bashkisë, kalendari i programit buxhetor afatmesëm në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 33.

Nukjanë miratuar, vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 34.

Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik në zbatim me kërkesat e Ligjit nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 37.

<u>Programimi i PBA 2020-2022</u>

Me Urdhrin nr. 40, datë 19.02.2019, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020- 2022.

Është miratuar nga Këshilli Bashkiak, Vendimi me nr. 10, datë 25.02.2019, ñPër vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Përmet për vitet 2020-2022ò, jo më vonë se 31 janar, jashtë afatit të kërkesave të Ligjit Nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 34.

Këshilli Bashkiak Përmet ka marrë Vendimin për Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2020- 2022 jashtë afatit të kërkesave të Ligjit Nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 33, e specifikuar brenda datës 31 Dhjetor.

Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik në zbatim me kërkesat e ligjit Nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 37.

<u>Programimi i PBA 2021-2023</u>

Me Urdhrin nr. 86, datë 11.02.2020, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2021- 2023.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2021- 2023 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 74, datë 21.10.2020.

Miratimi i tavaneve të buxhetit afatmesëm 2021-2023 Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 51, datë 11.08.2020, jashtë afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 37.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 1, datë 31.01.2020, ñPër vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Përmet për vitet 2021-2023ò, jo më vonë se 31 Janar,

brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 34.
Këshilli Bashkiak Përmet ka marrë Vendimin për Miratimin e Kalendarit të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2021- 2023 dhe Buxhetin Vjetor 2021, me Nr. 2, datë 31.01.2020, në mos zbatim të afateve të Ligjit nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 33, e specifikuar brenda datës 31 Dhjetor.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet periodike të monitorimit.

- *Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të Bashkisë Përmet - Viti 2018*

Buxheti i vitit 2018 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr. 4, datë 18.01.2018. Buxheti fillestar për vitin 2018 nuk i është nënshtruar asnjëherë ndryshimeve.
Bashkia Përmet menaxhon dhe administron fondet, sipas 13 programeve të miratuara:
1. Programi ñPlanifikim, menaxhim dhe administrimò
2. Programi ñArsim i mesëmò
3. Programi ñInfrastruktura rrugoreò
4. Programi ñShërbime Publikeò
5. Programi ñUjitja dhe Kullimiò
6. Programi ñNdriçimi Publikò
7. Programi ñKonviktetò
8. Programi ñMjedisi dhe mbrojtja e pyjeve e kullotaveò
9. Programi ñArsimi para universitar dhe edukimiò
10. Programi ñShërbimet socialeò
11. Programi ñKultura dhe aktivitetet kulturoreò
12. Programi ñRinia dhe Sportetò
13. Programi ñEmergjencat Civileò
-Detyrimet kreditore për fund vitin 2017, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 5,448,254 lekë.

Zbatimi i buxhetit viti 2018. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve buxhetore, monitorimi i buxhetit dhe pasqyrimi në raportet përkatëse.

Pasqyra nr. 1. Shpenzimet buxhetore sipas zërave dhe burimeve për vitin 2018

000 lekë

Nr.	Emërtimi i Shpenzimeve /burimet e fondeve	Burimet e fondeve	Viti 2018		
			Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzimet për pagat		146,542	132,210	90,2
2	601 Sig shoqërore dhe shëndetësore		25,255	16,923	67,0
3	602Shpenzimet operative		69,538	52,473	75,5
4	604+ 609 Ndihmat ekonomike		89,785	86,364	96,2
5	230+231 Studime projektime		157,023	127,348	81,1
6	466 Mjete ne ruajtje				
7	Te trashëguara nga viti I kaluar	65,679			
8	Transferta te pakushtëzuara	117,464			
9	Transferta specifike	70,355			
10	Te ardhura vendore te vitit	53,000			
11	Fonde nga FZHR				
12	Donatore				
13	Transferta e kushtëzuar	181,645			
	Etj				
	TOTALI	**488,143**	**488,143**	**415,318**	**85,1**

Burimi: Të dhënat e nxjerra nga Drejtoria Ekonomike dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e pasqyrës mbi realizimin e tregueseve buxhetorë, konstatohet se në total buxheti është programuar për 488,143 mijë lekë, realizuar 415,318 mijë lekë ose në masën 85.1 %.
Pagat janë realizuar në masën 90.2 %, shpenzimet operative janë realizuar 75.5 % dhe investimet llogaritë 230 dhe 231 janë realizuar në masën 81.1%.
Burimet e financimit të këtij buxheti, janë:
-65,679 mijë lekë të trashëguara nga viti paraardhës pjesë e pa përdorur të ardhura të veta dhe grande,
-53,000 mijë lekë të ardhura lokale të vitit ushtrimor.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit 12 mujor të vitit 2018

000 lekë

	Plani përfundimtar 12 mujor 2018			**Realizimi faktik 12 mujor 2018**		**Realizimi ne%i buxhetit vjetor ndaj Planit te vitit**
Artikull	**Vlera**	**Struktura ne %**	**Diferenca**	**Vlera**	**Struktura ne %**	**2018**
600+601	171,797	35,2	22,664	149,133	35,9	86,8
602+606	159,323	32,6	20,486	138,837	33,4	87,1
230+231	157,023	32,2	29,675	127,348	30,7	81,1
						0,0
TOTALI	**488,143**		**72,825**	**415,318**		85,1

- *Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të Bashkisë Përmet - Viti 2019*

Buxheti i vitit 2019 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 8, datë 04.02.2019.
Bashkia Përmet menaxhon dhe administron fondet, sipas 12 programeve të miratuara:
1. Programi ñPlanifikim, menaxhim dhe administrimò
2. Programi ñInfrastruktura rrugoreò
3. Programi ñUjitja dhe Kullimiò
4. Programi ñNdriçimi Publikò
5. Programi ñKonviktetò
6. Programi ñMjedisi dhe mbrojtja e pyjeve e kullotaveò
7. Programi ñArsimi para universitarò
8. Programi ñKultura dhe aktivitetet kulturoreò
9. Programi ñRinia dhe Sportetò
10. Programi ñEmergjencat Civileò
11. Programi ñKujdesi për fëmijët, çerdhe
12. Programi ñZhvillimi ekonomik, Shërbime Publikeò

Buxheti fillestar për vitin 2019 i është nënshtruar 1 herë ndryshimeve, e cila është miratuar sipas VKB-s së mëposhtme:

Nr.	**VKB nr.datë**	**Konfirmimi i Prefektit**
1	Nr. 79 datë 02.10.2019	Nr. 1459/1 Prot., datë 19.10.2019

-Detyrimet kreditore për fund vitin 2018, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 9,782,208 lekë.

- *Zbatimi i buxhetit viti 2019. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve buxhetore, monitorimi i buxhetit dhe pasqyrimi në raportet përkatëse.*

Pasqyra nr. 1. Shpenzimet buxhetore sipas zërave dhe burimeve për vitin 2019

000 lekë

Nr.	**Emërtimi i Shpenzimeve /burimet e fondeve**	**Burimet e fondeve**	**Viti 2019**		
			Plani	**Fakti**	**%**
1	600 Shpenzimet për pagat		150,619	139,819	92,8
2	601 Sig shoqërore dhe shëndetësore		30,196	18,006	59,6

3	602Shpenzimet operative		72,074	43,483	60,3
4	604+609 Ndihmat ekonomike		85,227	82,965	97,3
5	230+231 Studime projektime		110,611	101,373	91,6
6	466 Mjete ne ruajtje				
7	Te trashëguara nga viti i kaluar	53,855			
8	Transferta te pakushtëzuara	115,574			
9	Transferta specifike	71,099			
10	Te ardhura vendore te vitit	53,000			
11	Fonde nga FZHR				
12	Donatore				
13	Transferta e kushtëzuar	155,199			
	TOTALI	**448,727**	**448,727**	**385,646**	**85,9**

Burimi: Të dhënat e nxjerra nga Drejtoria Ekonomike dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e pasqyrës mbi realizimin e treguesève buxhetorë, konstatohet se në total buxheti është programuar për 488,727 mijë lekë, realizuar 385,646 mijë lekë ose në masën 85.9 %.

Pagat janë realizuar në masën 92.8 %, shpenzimet operative janë realizuar 60.3 % dhe investimet llogaritë 230 dhe 231 janë realizuar në masën 91.6 %.

Burimet e financimit të këtij buxheti, janë:

-53,855 mijë lekë të trashëguara nga viti paraardhës pjesë e pa përdorur të ardhura të veta dhe grande,

-53,000 mijë lekë të ardhura lokale të vitit ushtrimor.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit 12 mujor të vitit 2019

000 lekë

	Plani përfundimtar 12 mujor 2019			**Realizimi faktik 12 mujor 2019**		**Realizimi në % i buxhetit vjetor ndaj Planit te vitit 2019**
Artikull	**Vlera**	**Struktura ne %**	**Diferenca**	**Vlera**	**Struktura ne %**	
600+601	180,815	40,3	22,990	157,825	41,1	87,3
602+606	157,301	35,1	30,853	126,448	32,8	80,4
230+231	110,611	24,6	9,238	101,373	26,3	91,6
TOTALI	**448,727**		**63,081**	**385,646**		85,9

- *Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të Bashkisë Përmet - Viti 2020*

Buxheti i vitit 2020 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 111, datë 31.12.2019.

Bashkia Përmet menaxhon dhe administron fondet, sipas 12 programeve të miratuara:

1. Programi ñPlanifikim, menaxhim dhe administrimò
2. Programi ñInfrastruktura rrugoreò
3. Programi ñUjitja dhe Kullimiò
4. Programi ñMjedisi dhe mbrojtja e pyjeve e kullotaveò
5. Programi ñArsimi para universitar dhe konviktetò
6. Programi ñKultura dhe aktivitetet kulturoreò
7. Programi ñRinia dhe Sportetò
8. Programi ñEmergjencat Civileò
9. Programi ñKujdesi për fëmijët, çerdhe
10. Programi ñZhvillimi ekonomik, Shërbime Publikeò
11. Programi ñPërfshirja socialeò
12. Programi ñArsimi parashkollorò

Buxheti fillestar për vitin 2020 i është nënshtruar 2 herë ndryshimeve, të cilat janë të miratuara sipas VKB të mëposhtme:

Nr.	**VKB nr.... datë**	**Konfirmimi i Prefektit**
1	Nr. 58 datë 24.09.2020	Nr. 931/1 Prot., datë 08.10.2020
2	Nr. 53 datë 11.08.2020	Nr. 807/2 Prot., datë 01.09.2020

-Detyrimet kreditore për fund vitin 2019, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 3,427,178 lekë.

- *Zbatimi i buxhetit viti 2020. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve buxhetore, monitorimi i buxhetit dhe pasqyrimi në raportet përkatëse.*

Pasqyra nr. 1. Shpenzimet buxhetore sipas zërave dhe burimeve për vitin 2020

000 lekë

Nr.	Emërtimi i Shpenzimeve /burimet e fondeve	Burimet e fondeve	Viti 2020		
			Plani	Fakti	%
1	600 Shpenzimet për pagat		148,857	138,217	92,9
2	601 Sig shoqërore dhe shëndetësore		26,074	22,134	84,9
3	602Shpenzimet operative		55,869	36,199	64,8
4	604+609 Ndihmat ekonomike		105,510	101,696	96,4
5	230+231 Studime projektime		124,921	92,040	73,7
6	466 Mjete ne ruajtje				
7	Te trashëguara nga viti i kaluar	62,053			
8	Transferta te pakushtëzuara	118,211			
9	Transferta specifike	71,595			
10	Te ardhura vendore te vitit	56,093			
11	Fonde nga FZHR				
12	Donatore				
13	Transferta e kushtëzuar	153,279			
	TOTALI	**461,231**	**461,231**	**390,286**	**84,6**

Burimi: Të dhënat e nxjerra nga Drejtoria Ekonomike dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e pasqyrës mbi realizimin e tregueseve buxhetorë, konstatohet se në total buxheti është programuar për 461,231 mijë lekë, realizuar 390,286 mijë lekë ose në masën 84.6 %.
Pagat janë realizuar në masën 92.9 %, shpenzimet operative janë realizuar 64.8 % dhe investimet llogaritë 230 dhe 231 janë realizuar në masën 73.7 %.
Burimet e financimit të këtij buxheti, janë:
-62,053 mijë lekë të trashëguara nga viti paraardhës pjesë e pa përdorur të ardhura të veta dhe grande,
-56,093 mijë lekë të ardhura lokale të vitit ushtrimor,

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit 12 mujor të vitit 2020

000 lekë

Artikull	Plani përfundimtar 12 mujor 2020			Realizimi faktik 12 mujor 2020		Realizimi ne% i buxhetit vjetor ndaj Planit te vitit 2020
	Vlera	Struktura ne %	Diferenca	Vlera	Struktura ne %	
600+601	174931	37,9	14580	160351	41,1	91,7
602+606	161379	35,0	23484	137895	35,3	85,4
230+231	124921	27,1	32881	92040	23,6	73,7
TOTALI	**461231**		**70945**	**390286**		84,6

Ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Realizimi i buxhetit ndaj planit për vitin 2018 ka arritur 85.1 %, për vitin 2019 ka arritur në 85.9 % dhe në vitin 2020 ka pësuar ulje në 1.3 % krahasuar me vitin 2019 dhe ka arritur në 84.6 %.

Bashkia Përmet i dërgon Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, për periudhat Janar-Prill, Janar- Gusht dhe Janar- Dhjetor, në total tre raporte vjetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve. Ky Raportim monitorimi për periudhën Janar- Prill është dërguar në MFE: për vitin 2018 me komunikim me email në datën 07.09.2018 për vitin 2019 me shkresën përcjellëse nr. 1295, datë 27.05.2019; për vitin 2020

me shkresën përcjellëse nr. datë. Për periudhën Janar- Gusht është dërguar në MFE: për vitin 2018 me shkresën përcjellëse nr. 2491 datë 09.10.2018 për vitin 2019 me komunikim me email në datën 27.09.2019; për vitin 2020 me komunikim me email në datën 17.09.2020. Për periudhën Janar- Dhjetor është dërguar në MFE: për vitin 2018 me shkresën përcjellëse nr. 1106 datë 28.02.2019 për vitin 2019 me shkresën përcjellëse nr. 604, datë 25.02.2020; për vitin 2020 me komunikim me email në datën 25.02.2021. (nisja e tyre është kryer brenda afatit të përcaktuar në pikën 48, të Urdhrit nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendoreò, 3.2, duke përjashtuar 4 mujorin e parë dhe të dytë të vitit 2018 të cilat janë jashtë afatit, po ashtu theksojmë se disa janë dërguar vetëm elektronikisht nëpërmjet email-it).

Mbi observacionet e paraqituara nga Bashkia Përmet për Projekt Raportin e Auditimit.

Pretendimi i subjektit: Për sa trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar Bashkia Përmet është paraqitur observacioni, më datë 13.12.2021: *Detyrimet kreditore për fund vitet sipas pasqyrave financiare të raportimit, në llogaritë 401-408 janë programuar si zë më vete i treguesve të buxhetit, kjo është realizuar në zbatim të plotë të nenit nr. 101 të UMF nr. 2 datë 06.02.2012 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit". Kjo vërtetohet nga mosshtimi i detyrimeve të pasqyruara në raportimet tre mujore në MFE (për detyrimet e prapambetura).* **Qëndrimi i grupit të auditimit:** Grupi i auditimit mori në konsideratë duke qënë se ju paraqit relacioni.**Për sa më sipër observacion merret në konsideratë e pasqyrohet në Raportin Përfundimtar të Auditimit.**

Titulli i Gjetjes nr. 1:	Probleme në lidhje me procedurat e diskutimit, planifikimit, miratimit, publikimit dhe analizës së buxheteve.
Situata:	Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik në zbatim me kërkesat e neni 37 tëLigjit nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò. Mungon Plani i Masave dhe Veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës. Ka mungesë të dokumenteve (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat të dokumentojnë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit. Nuk ka mbledhje të dokumentuara të GMS për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit. Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA-të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë. Publikimi i dokumenteve në faqen zyrtare të bashkisë Përmet apo në vendime.al ka vonesa dhe mungesa në afatet e publikimit. Ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Realizimi i buxhetit ndaj planit për vitin 2018 ka arritur 85.1 %, për vitin 2019 ka arritur në 85.9 % dhe në vitin 2020 ka arritur në 84.6 %. -Detyrimet kreditore për fund vitin 2017, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 5,448,254 lekë. -Detyrimet kreditore për fund vitin 2018, sipas pasqyrave financiare të raportimit

	për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 9,782,208 lekë. -Detyrimet kreditore për fund vitin 2019, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 3,427,178 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò nenet 2, 3, 6, 9, 10,15,27 dhe 32, i ndryshuar me Ligjin nr. 114/2012 datë 07.12.2012 dhe Ligjin nr. 57/2016, datë 2.6.2016; Ligji nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 37 Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, neni 9 pika 1.3 gërma ñcò dhe ñçò; Ligji nr. 109/2017, datë 30.11.2017 ñPër buxhetin e vitit 2018ò; UMF Plotësues nr. 8, datë 29.03.2012 ñPër procedurat standard të përgatitjes së buxhetit afatmesëmò UMF nr. 2, datë 6.02.2012 ñPër procedurat standard të zbatimit të buxhetitò i ndryshuar pika 101. Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendoreò.
Ndikimi/Efekti:	Mangësi e menaxhimit për të projektuar, miratuar, realizuar dhe analizuar buxhetet e institucionit që drejton, shkakton mosfunksionim e duhur tënjësisë vendore. Planifikimi i të ardhurave të veta, zërave të shpenzimeve dhe investimeve dhe mos realizimi i tyre, më së shumti për shkak të mosrealizimit të të ardhurave, sjellin mungesa në plotësimin e nevojave reale të komunitetit dhe ulje të performancës të njësisë vendore në drejtim të këtyre shërbimeve.
Shkaku:	Analizat e punës për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetet paraardhëse nuk janë bërë të plota, duke mos nxjerrë konkuzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve gjatë viteve të audituara.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Bashkia Përmet të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti zbatimi i buxhetit. Bashkia Përmet të marrë masa, të dokumentoj mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore. Bashkia Përmet të marrë masa, për publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak në faqen zyrtare apo në vendime.al brenda 15 ditëve. Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të mblidhet për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit (të dokumentuara). Të kryhet Plani i Masave dhe Veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Detyrimet e prapambetura 31.12.2020

Titulli i Gjetjes nr. 2:	Risqet buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara
Situata:	Vlerat e faturave të palikuiduara nga viti 2019 në 2020 vlen të theksohet se janë vlera progresive. Detyrimet e prapambetura në vitin 2019 dhe 2020 janë vlera të mbartura edhe nga vitet e mëparshme të cilat vijojnë të jenë të palikuiduara. Detyrimet e prapambetura deri më datë 31.12.2020 janë në vlerën 14,666,184 lekë. Ndër të cilat vlerën më të lartë të shpenzimeve të pa likuiduara i zënë Investimet në vlerën 10,335,785 lekë ose 70.47 %. Detyrimi i papaguar në lidhje me

	investimet e kryera si :*"Rikonstruksion i Shkollës së mesme Naim Frashëri"*me sipërmarrësñA. C.ñ Shpk dhe ñRehabilitim, përforcime të banesave ekzistueseò me sipërmarrësñN.ñ Shpk, faturat janë të muajt shkurt dhe maj 2020. Mallra dhe Shërbime në vlerën 2,346,886 lekë ose 16 %, vlerë e pa likuiduar i cili i përket OSHEE- Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, faturat e papaguara të vitit 2007. Në komunikimin me Bashkinë Përmet mbi arsyet e mos likuidimit të kësaj vlere, Bashkia Përmet deklaron se i kanë dërguar shkresa OSHEE- s në lidhje me detajimin e këtij detyrimi, nga e cila nuk ka patur përgjigje. Në vlerën e detyrimeve të papaguara shfaqet edhe detyrimi 1,983,513 lekë ndaj detyrimeve të vendimeve gjyqësore ose 13.5 %, nga të cilat 554,334 lekë janë detyrime të cilat datojnë që nga viti 2012 dhe 2013. Detyrimet për vendimet gjyqësore kanë të bëjnë me detyrime ndaj punonjësve të larguar nga ky institucion. Nga total detyrimi ndaj vendimeve gjyqësore vetëm 2 prej këtyre rasteve kanë kaluar me përmbarues. **Detyrime të prapambetura** Investime: 10,335,785 Mallra dhe shpenzime: 2,346,886 Vendime gjyqësore (Personeli): 1,983,513 **Total: 14,666,184** *Burimi: Drejtoria Ekonomike, Bashkia Përmet*
Kriteri:	- Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 5, datë 27.02.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, i ndryshuar me Udhëzimin nr.5/1, datë 21.05.2014, pika 4.
Ndikimi/Efekti:	Mos shlyerja në kohë të detyrimeve ndaj të tretëve krijon risk për pagesa penalitetesh të panevojshme.
Shkaku:	Moszbatim i kërkesave ligjore për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Bashkia Përmet të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

Burimi i krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/ nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor; Niveli i arkëtimit të gjobave të vendosura nga IMTV, apo organet e tjera;

Përdorimi i të ardhurave

Pasqyra e shpërndarjes së të ardhurave sipas natyrës së shpenzimeve

000 lekë

VITI 2018				
Emërtimi	**Total**	**Transfertë e pakushtëzuar dhe specifike**	**Të ardhura te veta**	**Transfertë e kushtëzuar**
600	**132,006**	113,632	13,818	4,556
601	**17,337**	16,299	312	726
602-604-606	**139,086**	33,911	20,281	84,894
230-231	**127,348**	32,743	3,728	90,877
Totali	**415,777**	196,585	38,139	181,053
VITI 2019				
Emërtimi	**Total**	**Transfertë e pakushtëzuar dhe specifike**	**Të ardhura te veta**	**Transfertë e kushtëzuar**
600	**135,573**	115,538	15998	4037
601	**22,251**	20,896	629	726
602-604-606	**126,448**	27,297	17349	81802
230-231	**101,373**	23,673	9453	68247
Totali	**385,645**	187,404	43,429	154,812
VITI 2020				
Emërtimi	**Total**	**Transfertë e pakushtëzuar dhe specifike**	**Të ardhura te veta**	**Transfertë e kushtëzuar**
600	**133,510**	116,809	12,726	3,975
601	**22,212**	20,663	895	654

602-604-606	**142,583**	29,913	18,161	94,509
230-231	**91,981**	2,6791	2824	62,366
Totali	**390,286**	194,176	34,606	161,504

Nga të dhënat e pasqyrës, konstatohet se në totalin e shpenzimeve, Bashkia Përmet me të ardhurat e veta mbulon 9.17 % të vitit 2018, 11.26 % të shpenzimeve për vitin 2019 dhe 8.87 % të shpenzimeve për vitin 2020. Të ardhurat e veta kanë njohur një rritje nga viti 2018 në 2019 në vlerën 5,290 mijë lekë dhe një ulje në nivel të lartë nga viti 2019 në 2020 në vlerën 8,823 mijë lekë. Mbulimi i shpenzimeve nga të ardhurat e veta është shumë i ulët.

Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave

Miratimi i taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë Përmet për vitin 2018 është kryer me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 3, datë 18.01.2018. Paketa fiskale e vitit 2019 është miratuar me Vendim nr. 95, datë 17.12.2018 dhe për vitin 2020 me Vendimin nr. 101, datë 19.12.2019.

000 lekë

		2018			2019			2020		
Nr	**Emërtimi i të ardhurave**	**Plan**	**Fakt**	**% Realiz**	**Plan**	**Fakt**	**% Realiz**	**Plan**	**Fakt**	**%Realizimi**
I	**Sektori i Tatim-Taksave (1-14)**									
1	Takse mbi ndërtesat	6710	5660	84	6710	6259	93	7543	5602	74
2	Tatim i thjeshtuar i bizn të vogël	310	299	96	310	364	117	35	45	129
3	Takse tabele	1000	381	38	1000	431	43	1000	490	49
4	Tarife pastrami	7597	8180	108	7597	7576	100	8597	7669	89
5	Tarife ndriçimi	3784	3694	98	3784	2797	74	3784	2727	72
6	Tarife gjelbërimi	1843	2358	128	1843	1695	92	1843	1305	71
7	Takse trualli	715	533	75	715	575	80	715	641	90
8	Takse vendore fjetje ne hotel	200	77	39	200	66	33	53	59	111
9	Takse mbi token bujqësore	2435	1441	59	2435	2617	107	2435	1997	82
10	Tarife për lende drusore	1109	290	26	1109	342	31	1109	865	78
11	Tarife për ujin	145	41	28	145	99	68	145	110	76
12	Tarife mirëmbajtje kanal vaditje							300	102	34
13	Tatim mbi te ardhurat personale							1602	2403	150
14	Tarife KUZ	2240	0	0	2240		0			
	Total I	**28088**	**22954**	**82**	**28088**	**22821**	**81**	**29161**	**24015**	**82**
II	**Urbanistika dhe shërbim (1-9)**									
1	Takse ndik. infrastrukturë nd.i ri	10202	4903	48	10202	3651	36	10202	2094	21
2	Takse regjistrim automjeti	3000	4322	144	3000	4417	147	3000	4437	148
3	Tarife zënie hapësire publike	600	356	59	600	380	63	714	715	100
4	Leje regjistrim veprimtarie	2250	266	12	2250	191	8	4250	1120	26
5	Qira objekti	500	476	95	500	542	108	500	713	143
6	Tarife Parkimi	450	466	104	450	327	73	78	127	163
7	Takse kalimit te drejtës së pronësisë	230	1129	491	230	1019	443	230		0
8	Tarife vendore për urbanistiken	300	333	111	300	1774	591	300	1093	364
9	Te tjera të ardh. ndërmarrje në pronësi	3500	2177	62	3500	2359	67	3500	2529	72
	Totali II	**21032**	**14428**	**69**	**21032**	**14660**	**70**	**22774**	**12828**	**56**
III	**Sektori I Pyje kullotave**									
1	Tarife kullotje	2000	1709	85	2000	1643	82	2000	1921	96
IV	**Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi**									
1	Tarifë shërbimesh të M N Z	120	131	109	120	156	130	120	88	73
V	**Veterineri(Sektori Mbro se konsumatorit)**									
1	Tarife certifikim mishi							300		0
VI	**Sektori i Arsimit**									
1	Te ardhura nga çerdhja dhe kopshti	260	275	106	260	199	77	260	492	189
VII	Te tjera te ardhura	1500	4082	272	1500	1499	100	1500	992	66
	Shuma	**53,000**	**43,579**	**82,2**	**53,000**	**40,978**	**77,3**	**56,115**	**40,336**	**71,9**

Nga të dhënat e pasqyrave të realizimit të të ardhurave, konstatohet se për vitin 2018, është planifikuar si e ardhur vlera 53,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 43,579 mijë, të ardhurat paraqiten të realizuara ndaj planit fillestar në masën 82.2 %. Për vitin 2019, është planifikuar si e ardhur vlera 53,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 40,978 mijë lekë, të ardhurat paraqiten të realizuara ndaj planit fillestar në masën 77.3 %. Për vitin 2020, është planifikuar si e ardhur vlera 56,115 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 40,336 mijë lekë,

të ardhurat paraqiten të realizuara ndaj planit fillestar në masën 71.9 %. Planifikimi i të ardhurave nuk është bërë saktë pasi ka zëra të ardhurash të cilat kanë tejkalim, si në rastin e tatimit të thjeshtuar të biznesit të vogël, taksës së regjistrimit të automjeteve, tarifës së parkimit, tarifës vendore për urbanistikën, taksës së kalimit të së drejtës së pronësisë. Ka disa taksa të tjera me realizim shumë të ulët si leja e regjistrimit të veprimtarive, tarifa për lëndën drusore, tarifa e ujit, taksa e tabelës.

Të ardhurat nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore

Sektori i buxhet finance, tatim taksa e NE- PAK, ka në strukturën e saj 12 punonjës. Zyra e tatim- taksave është pjesë e këtij sektori dhe ka në përbërje të saj 3 punonjës nga të cilët 2 inspektor taksash tregje dhe 1 specialist taksash. Bashkia Përmet ka lidhur kontratë 1- vjeçare me ñU. K. Përmetñ Sha. Marrëveshje ñPër kryerjen e shërbimit të arkëtimit të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendoreò, për vitin 2018, në datën 26.02.2018, nr. 461, për vitin 2019, në datën 15.01.2019, nr. 52, për vitin 2020, në datën 14.01.2020, nr. 114. Për vitin 2018 dhe 2019 agjenti tatimor ñU.ò Sha. ka përfituar 10 % të të ardhurave të përfituara ndërsa për vitin 2020 ky agjent ka përfituar 5 % duke krijuar hapësirë fitimi 95 % të të ardhurave Bashkisë Përmet. ñUjësjellës Kanalizime Përmetò Sha, kryen shërbimin e faturimit dhe arkëtimit për llogari të bashkisë Përmet të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore si: taksa e truallit, takes ndërtese, tarifa e pastrimit, tarifa e ndriçimit, tarifa e gjelbërimit, taksa e tarifa vendore për Njësitë Administrative sipas Paketës Fiskale.

Vitet	Faturimi	Arkëtimi- Bashkia Përmet	Përqindja qe i takon subjektit	Arkëtimet për bashkinë	Paguar bashkinë	Diferenca
	Detyrim i mbartur viti 2017					4,709,950
2018	13,137,643	12,619,597	1,261,960	11,357,637	7,159,813	4,197,824
2019	12,071,912	11,972,017	1,197,202	10,774,815	6,813,977	3,960,838
2020	12,376,077	11,372,270	568,614	10,803,657	8,278,654	2,525,003
Totali	37,585,632	35,963,884	3,027,775	32,936,109	22,252,444	15,393,615

Burimi: Akt- rakordimet me Ujësjellës- Kanalizime Përmet 2018- 2020

Në vitet 2018- 2020 ñU.K. Përmetò Sha, ka arkëtuar nga taksat dhe tarifat vendore vlerën 35,963,884 lekë, nga të cilat për vitet 2018 dhe 2019 ñU.K. Përmetò Sha, ka përfituar 10 % të shumës mujore të derdhur dhe 5 % në vitin 2020 të të ardhurave të arkëtuara. Ky subjekt i ka transferuar nëpërmjet bankës së nivelit të dytë, bashkisë vlerën 22,252,444 lekë përkundrejt vlerës 32,9366,109 lekë që duhet të arkëtonte për llogari të institucionit. Detyrimi nga diferencat është rritur nga viti në vit dhe në 31.12.2020 ky detyrim është në vlerën **15,393,615 lekë, e ardhur e munguar në bashkinë Përmet.**

Titulli i Gjetjes nr. 3:	Mungesë të arkëtimeve për llogari të bashkisë Përmet të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore nga ñU.K. Përmetò Sh.a
Situata:	Bashkia Përmet ka lidhur kontratë 1- vjeçare me ñU. K. Përmetò Sha. Marrëveshje ñPër kryerjen e shërbimit të arkëtimit të detyrimeve për taksat dhe tarifat vendoreò, për vitin 2018, në datën 26.02.2018, nr. 461, për vitin 2019, në datën 15.01.2019, nr. 52, për vitin 2020, në datën 14.01.2020, nr. 114. Për vitin 2018 dhe 2019 agjenti tatimor ñUjësjellësò Sha. ka përfituar 10 % të të ardhurave të përfituara ndërsa për vitin 2020 ky agjent ka përfituar 5 % duke krijuar hapësirë fitimi 95 % të të ardhurave Bashkisë Përmet. Në vitet 2018- 2020 ñU.K. Përmetò Sha ka arkëtuar nga taksat dhe tarifat vendore vlerën 35,963,884 lekë, nga të cilat për vitet 2018 dhe 2019 ñU.K. Përmetò Sha ka përfituar 10 % të shumës mujore të derdhur dhe 5 % në vitin 2020 të të ardhurave të arkëtuara. Ky subjekt i ka transferuar nëpërmjet bankës së nivelit të dytë, bashkisë vlerën 22,252,444 lekë përkundrejt vlerës 32,9366,109 lekë që duhet të arkëtonte për llogari të institucionit. Detyrimi nga diferencat është rritur nga viti në

	vit dhe në 31.12.2020 ky detyrim është në vlerën **15,393,615 lekë, e ardhur e munguar në Bashkinë Përmet.**

Vitet	Faturimi	Arkëtimi-Bashkia Përmet	Përqindja qe i takon subjektit	Arketimet per bashkine	Paguar bashkine
	Detyrim i mbartur viti 2017				
2018	13,137,643	12,619,597	1,261,960	11,357,637	7,159,813
2019	12,071,912	11,972,017	1,197,202	10,774,815	6,813,977
2020	12,376,077	11,372,270	568,614	10,803,657	8,278,654
Totali	37,585,632	35,963,884	3,027,775	32,936,109	22,252,444

	Burimi: Akt- rakordimet me U.- K. Përmet 2018- 2020
Kriteri:	Ligji 9632ñPër sistemin e taksave dhe tarifave vendore"
Ndikimi/Efekti:	Mos arkëtimin e të ardhurave në interes të Bashkisë Përmet në vlerën 15,393,615 lekë
Shkaku:	Mungesë të ardhurash
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Bashkia Përmet të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **15,393,615 lekë**.

Zyra e Tatim Taksave në Excel i ka paraqitur grupit auditues emrin e subjektit, Niptin, llojin e aktivitetit, vlera e debisë për çdo vit por nuk disponon një regjistër analitik të subjekteve debitorë, në të cilin të pasqyrohet horizontalisht vlera e debisë e secilit subjekt për secilën nga taksat dhe tarifat që aplikohen.
Në lidhje me debitorët familjarë, nuk disponojnë një database të saktë me të dhënat e tyre duke specifikuar taksat dhe tarifat që aplikohen, po ashtu nuk e kanë si format paraqitjen e informacionit të plotë ku të paraqitet debia për secilin vit duke filluar që nga vitet e mëparshme. Përdorimi i këtij formati ku të përmblidhen informacionet e mësipërme do të mundësonte analizimin e të dhënave dhe pasqyrimin më të plotë të situatës me debitorët, për secilën nga taksat dhe tarifat e papaguara. Të dhënat e mbajtura në këto formate ekzistuese, paraqesin informacion të cunguar.

Debitorët familjarë për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit

	Debitorë familjarë për taksën e ndërtesës			Debitorë familjarë për tarifën e shërbimit		
Përmet Bashkia	**2018**	**2019**	**2020**	**2018**	**2019**	**2020**
	1,935,856	2,745,322	3,427,543	2,250,597	2,866,261	3,270,260
	Debitorë biznes për taksën e ndërtesës			**Debitorë biznes për tarifën e shërbimit**		
	2018	**2019**	**2020**	**2018**	**2019**	**2020**
	1,680,435	2,332,693	3,561,535	4,734,336	6,566,525	10,461,359

Vlera e debisë progresive nga familjarët për taksën e ndërtesës deri në vitin 2020 është 3,427,543 lekë ndërsa për tarifën e shërbimit deri në vitin 2020 është 3,270,260 lekë, në total **6,697,803 lekë të cilat janë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Përmet.**
Vlera e debisë progresive nga bizneset për taksën e ndërtesës deri në vitin 2020 është 3,561,535 lekë ndërsa për tarifën e shërbimit deri në vitin 2020 është 10,461,359 lekë, në total **14,022,894 lekë të cilat janë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Përmet.**

Zyra e Financave, në Bashkinë Përmet, ka regjistruar në regjistrin e saj duke filluar nga viti

2015 e në vazhdim debitorët nga bizneset, vlerën dhe gjobat e llogaritura.

Subjekte e regjistruara, çregjistruara, të pezulluara dhe të riaktivizuara

	Vitet		
	2018	2019	2020
Regjistrim biznese te reja	10	20	23
Çregjistrim biznesesh	3	19	19
Pezullim biznesesh	23	20	16
Riaktivizim biznesesh	4	17	7

Në tabelën e mësipërme pasqyrohet numri i subjekteve të cilët kanë kërkuar ndryshime në statusin e tyre. Në vitet 2019 dhe 2020 kemi rritje të numrit të bizneseve që kanë regjistruar biznesin e tyre respektivisht 20 për vitin 2019, 23 për vitin 2020 dhe numri i subjekteve të cilët kanë çregjistruar bizneset e tyre 19 për të dyja vitet.

	2018	2019	2020
Biznes i vogël	325	343	334
Biznes i madh	95	92	93

Vlera e debitorëve nga bizneset

Vlera debitore deri 31.12.2020	*Gjobat deri 31.12.2020*	Total debia e llogaritur deri 31.12.2020
14,022,894	*1,897,248*	15,920,142

Vlera e Debitorëve nga bizneset më datë 31.12.2020 paraqitet rreth 14,022,894 lekë, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset, e cila përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë Përmet. Nga ana e institucionit rezulton të jenë marrë masat e nevojshme për përmirësimin e situatës. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkinë Përmet, **për periudhën e audituar ka llogaritur gjoba për mospagimin në afat të taksave dhe tarifave nga subjektet**, në zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò

Në bazë dhe për zbatim të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në R.SH.*ò, i ndryshuar, lidhur me mospagimin në afat të detyrimit tatimor, tatimpaguesit duhet të paguajnë gjobë, sikurse përcaktohet në nenin 114 të këtij ligji ó*Tatimpaguesi, i cili nuk arrin që, brenda afatit të parashikuar në këtë ligj për pagesë, të paguajë shumën e detyrimit tatimor e të kontributit, detyrohet të paguajë një gjobë, të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike'.* **Gjobat për taksat dhe tarifat vendore të papaguara shkojnë në vlerën 1,897,248 lekë, vlerë e cilapërbën detyrim tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Përmet.**

Grupi i auditimit ka konstatuar se nga ana e bashkisë Përmet nuk janë kryer në vite kontabilizimet për debitorët e taksave, por duke qenë se nuk është bërë rakordim periodik dhe në fund të secilit vit, me mbylljen e Bilancit Kontabël, Zyra e Taksave dhe sektori i Financës duhet të hartojnë akt rakordimet përkatëse dhe të pasqyrohen në Bilancin e vitit në vazhdim.

Për vitin 2018 ndaj debitorëve janë ndjekur këto hapa:		
1. Në datën 21.03.2018 u është dërguar "Njoftim Për mos pagesën e Detyrimeve Vendore në afat"	Nr 583 Prot	47 subjekte
2.Në datën 31.07.2018 u është dërguar "Njoftim kërkese për shlyerje detyrimesh"	Nr 1938 Prot	207 subjekte
3.Në datën 14.08.2018 është nxjerrë urdhër për mbledhjen me forcë të detyrimeve të papaguara	Nr 2039 Prot	
4.Në datën 14.08.2018 është nxjerrë urdhër për mbledhjen me forcë të detyrimeve të hapësirës publike		
5.Në datën 02.10.2018 u është dërguar "Njoftim për mos pagesën e detyrimeve vendore"	Nr 2409 Prot	150 subjekte
6.Në datën 15.10.2018 u është dërguar pranë bankavee "Urdhër bllokimi"	Nr 2409/1 Prot	70 subjekte
Për vitin 2019 ndaj debitorëve janë ndjekur këto hapa:		
1.Në datën 26.03.2019 u është dërguar "Njoftim .Për mos pagesën e DetyrimeveVendore në afat"	Nr. 704 Prot.	118 subjekte
2.Në datën 23.08.2019 u është dërguar "Njoftim kërkese për shlyerje detyrimesh"	Nr. 704/1 Prot.	302 subjekte
3.Në datën 13.11.2019 u është dërguar "Njoftim kërkese për shlyerje detyrimesh"	Nr. 704/2 Prot.	120 subjekte

Për vitin 2020 ndaj debitorëve janë ndjekur këto hapa:		
1.Në datën 29.06.2020 u është dërguar "Njoftim .Për mos pagesën e Detyrimeve Vendore në afat"	Nr. 1726 Prot.	110 subjekte
2.Në datën 09.07.2020 është nxjerë urdhër për mbledhjen me forcë të detyrimeve të pa paguara	Nr. 1875 Prot.	
3.Në datën 09.10.2020 u është dërguar "Njoftim kerkese per shlyerje detyrimesh"	Nr. 2962 Prot.	350 subjekte

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
Znj. E.K., Drejtoreshë e Drejtorisë së Financave; Z. L. S., Zyra e Tatim Taksave;

Titulli i Gjetjes nr. 4:	Të ardhurat nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore
Situata:	Vlera e debitorëve nga bizneset deri më datë 31.12.2020 paraqitet rreth 14,022,894 lekë, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset, e cila përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e bashkisë Përmet. Vlera e gjobave llogaritet në 1,897,248 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e bashkisë Përmet. Në total llogaritet 15,920,142 lekë e ardhur e munguar për bashkinë Përmet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset. Vlera e debitorëve nga familjarët deri më datë 31.12.2020 është 6,697,803 lekë, të ardhura të munguara për bashkinë Përmet. Mbi këto debitorë familjarë nuk është aplikuar kamatëvonesë.Në lidhje me debitorët familjare, nuk disponojnë një database të saktë me të dhënat e tyre duke specifikuar taksat dhe tarifat që aplikohen, po ashtu nuk e kanë si format paraqitjen e informacionit të plotë ku të paraqitet debia për secilin vit duke filluar që nga vitet e mëparshme. Përdorimi i këtij formati ku të përmblidhen informacionet e mësipërme do të mundësonte analizimin e të dhënave dhe pasqyrimin më të plotë të situatës me debitorët, për secilën nga taksat dhe tarifat e papaguara. Të dhënat e mbajtura në këto formate ekzistuese, paraqesin informacion të cunguar.
Kriteri:	Ligji 9632ñPër sistemin e Taksave dhe Tarifave Vendore" Ligji 9920 ñPër Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò
Ndikimi/Efekti:	Mos arkëtimin e të ardhurave në interes të Bashkisë Përmet në vlerën 22,617,945 lekë
Shkaku:	Mungesë të ardhurash
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore në bashkinë Përmet të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **22,617,945 lekë**. Në lidhje me debitorët familjare, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të krijojnë një regjistër, një database të saktë me të dhënat e debitorëve familjarë duke specifikuar taksat dhe tarifat që aplikohen, po ashtu të paraqesin informacion të plotë ku të specifikohet debia për secilin vit, duke filluar që nga vitet e mëparshme.

Nuk ka patur observacione nga Bashkia Përmet.

<u>Taksa e ndikimit në infrastrukturë</u>

<u>Baza ligjore në lidhje me këtëçështje është:</u>
<u>Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò, i ndryshuar</u>
<u>VKM nr. 408, datë 13.05.2015 ñPër miratimin e rregullores së zhvillimit të territoritò, i ndryshuar</u>
<u>VKM nr. 271, datë 06.04.2016 ñPër një ndryshim në VKM nr. 408, datë 13.05.2015</u>
<u>Vendimi nr. 1, datë 30.07.2015 të Këshillit Kombëtar të Territorit</u>
<u>Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas preventivit ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për m^2 të investimit të ri. Klasifikimi si ndërtim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.</u>

Nr.	Emërtimi	Niveli
1.	Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 4 % të çmimit të shitjes për m^2	4%
Në rastin e ndërtimeve të ndryshme, niveli i taksës shprehet si % e vlerës së investimit		

1.	Për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë, të bujqësisë	3%
2.	Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, porteve, aeroporteve	0,10%
3.	Për ndërtesat në poçes legalizimi	0,50%
4.	Për ndërtesat që destinohen për qëllime banimi në zonat malore	3%

Në vitin 2019 janë shtuar subjekte të tjera për të cilat Zyra e Urbanistikës ka mungesa të dhënash dhe i ka përfshirë si vlerë detyrimi në vitin 2019. Zyra e Urbanistikës ka një database, në Excel, ku ka të dhënat e subjekteve (emër, mbiemër, sipërfaqja e ndërtimit, vendndodhja, taksa, funksion banimi/ ekonomik ku për të dyja ka të njëjtin nivel takse) të cilët kanë arkëtuar këtë taksë. Taksa e ndikimit në infrastrukturë është aplikuar bazuar në çmimin e kostos së ndërtimit për m^2 për bashkinë Përmet, për vitet 2018- 2020 të miratuar nga Enti Kombëtar u Banesave. Çmimi ka qënë 37,000 lekë/ m^2. Taksa e ndikimit është aplikuar sipërfaqe ndërtimi x çmimi x 0.5 %. Sipërfaqet ndërtimore janë vënë në dispozicion nga ana e ALUIZNI Gjirokastër.
Agjensia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të zonave/ndërtimeve informale, Drejtoria e ALUIZNIT Gjirokastër, në zbatim të nenit 3, të Ligjit 9482, datë 03.04.2006 ñPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeò, i ndryshuar si dhe në referuar nenit 27, të Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, së fundmi sipas Ligjit nr. 95/2018, i ka nisur më datë 04.02.2019, me nr. 381/1, bashkisë Përmet listën emërore të subjekteve deklaruese dhe të dhënat përkatëse për ndërtimet e kualifikuara për legalizim të ndodhura në territorin e bashkisë. Kryetari i Bashkisë konfirmon sipërfaqen e ndërtimit dhe shumën e paguar nga qytetari për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, për qytetarin i cili është në proces legalizimi. Bashkia Përmet dhe ALUIZNI Gjirokastër kanë njoftuar qytetarët të cilët nuk kanë kryer ende pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.
Grupi audites, në fzën e auditimit në terren, i kërkoj bashkisë Përmet ti dërgonte shkresë Drejtorisë Vendore të ASHK ALUIZNI-t Gjirokastër në lidhje me numrin e subjekteve të cilat nuk e kanë paguar këtë taksë dhe shumën debitore. Shkresa është nisur në datën 04.10.2021 dhe deri më datë 22.10.2021 nuk ka patur përgjigje nga ASHK - ALUIZNI Gjirokastër.

Grupi i auditimit mori disa dosje me zgjedhje në shqyrtim për të konfirmuar pagesat e kryera nga aplikuesit.
- Dh. J.P., sipërfaqe ndërtimi 254 m^2, mandat pagese më datë 11/02/2019 nga Tirana Bank: Taksë e ndikimit në infrastrukturë 46,990 lekë dhe Tarifë vendore për urbanistikën 1,000 lekë
- H. S. H., sipërfaqe ndërtimi 250 m^2, mandat pagese më datë 22/04/2020 nga Tirana Bank: Taksë e ndikimit në infrastrukturë 46,250 lekë dhe Tarifë vendore për urbanistikën 1,000 lekë
- A. L. T., sipërfaqe ndërtimi 310.7 m^2, mandat pagese më datë 26/05/2020 nga Tirana Bank: Taksë e ndikimit në infrastrukturë 57,480 lekë dhe Tarifë vendore për urbanistikën 1,000 lekë
- S. M. P., sipërfaqe ndërtimi 369.3 m^2, mandat pagese më datë 30/04/2018 nga Alpha Bank: Taksë e ndikimit në infrastrukturë 68,320 lekë dhe Tarifë vendore për urbanistikën 1,000 lekë
- H. E. I., sipërfaqe ndërtimi 19 m^2, mandat pagese më datë 30/04/2018 nga Raiffeisen Bank: Taksë e ndikimit në infrastrukturë 3,515 lekë dhe Tarifë vendore për urbanistikën 1,000 lekë
- H. P., sipërfaqe ndërtimi mungon m^2, mandat pagese më datë 09/10/2018: Taksë e ndikimit në infrastrukturë 4,070 lekë dhe Tarifë vendore për urbanistikën 1,000 lekë
- H. P. sipërfaqe ndërtimi mungon m^2, mandat pagese më datë 09/10/2018 Taksë e ndikimit në infrastrukturë 12,377 lekë dhe Tarifë vendore për urbanistikën 1,000 lekë
- Dh. P., sipërfaqe ndërtimi mungon m^2, mandat pagese më datë 31/07/2018 nga Raiffeisen Bank: Taksë e ndikimit në infrastrukturë 27,861 lekë dhe Tarifë vendore për urbanistikën 1,000 lekë

Bazuar në data bazën e nisur nga Drejtoria e Urbanistikës në total ndërtesa të legalizuara nga viti 2015- 2020 rezultojnë të jenë në vlerën 8,503,787.90 lekë ku vetëm 5,378,480.90 lekë janë paguar. Taksa e ndikimit në infrastrukturë e papaguar deri më datë 31.12.2020 është në vlerën 3,125,307 lekë, duke krijuar mungesë të të ardhurave në buxhetin e bashkisë Përmet.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi: ***Z. E.M.;***

<table>
<tr><td>Titulli i Gjetjes nr. 5:</td><td>Të ardhura të munguara nga Taksa e ndikimit në infrastrukturë</td></tr>
<tr><td>Situata:</td><td>Për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimete reja është 0.5 % e vlerës së investimit. Llogaritjet janë kryer në bazë të të dhënave të ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi të dërguara nga ALUIZNI, me shkresa zyrtare. Bazuar në data bazën e nisur nga Drejtoria e Urbanistikës në total ndërtesa të legalizuara nga viti 2015- 2020 rezultojnë të jenë në vlerën 8,503,787.90 lekë ku vetëm 5,378,480.90 lekë janë paguar. Taksa e ndikimit në infrastrukturë e papaguar deri më datë 31.12.2020 është në vlerën 3,125,307 lekë, duke krijuar mungesë të të ardhurave në buxhetin e bashkisë Përmet.
<table>
<tr><td colspan="3">2015-01.07.2018</td></tr>
<tr><td>Totali</td><td>Paguar</td><td>Detyrimi</td></tr>
<tr><td>5,247,031.0</td><td>2,561,134.4</td><td>2,685,896.6</td></tr>
<tr><td colspan="3">01.07.2018-31.12.2018</td></tr>
<tr><td>Totali</td><td>Paguar</td><td>Detyrimi</td></tr>
<tr><td>2,685,896.6</td><td>1,293.951.0</td><td>1,391,945.6</td></tr>
<tr><td colspan="3">01.01.2019-31.12.2019</td></tr>
<tr><td>Totali</td><td>Paguar</td><td>Detyrimi</td></tr>
<tr><td>4,648,702.45</td><td>1,261,119.5</td><td>3,387,583.0</td></tr>
<tr><td colspan="3">01.01.2020-31.12.2020</td></tr>
<tr><td>Totali</td><td>Paguar</td><td>Detyrimi</td></tr>
<tr><td>3,387,583</td><td>262,276</td><td>3,125,307</td></tr>
</table></td></tr>
<tr><td>Kriteri:</td><td>VKM, nr. 860, datë 10.12.2014, ñPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizimò
Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, të ndryshuar, neni 22</td></tr>
<tr><td>Ndikimi/Efekti:</td><td>Mos arkëtimin e të ardhurave në interes të Bashkisë Përmet deri 31.12.2020 në vlerën 3,125,307 lekë</td></tr>
<tr><td>Shkaku:</td><td>Mosbashkëpunim midis drejtorive dhe institucioneve përgjegjës për këtë taksë</td></tr>
<tr><td>Rëndësia:</td><td>E lartë</td></tr>
<tr><td>Rekomandimi:</td><td>Drejtoria e Urbanistikës të bashkëpunojë me institucionet përgjegjëse që ta ketë data bazën e plotë përsa i përket aplikuesve dhe të dhënave të tyre.
Drejtoria e Urbanistikës të marrë masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për vlerën 3,125,307 lekë. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Përmet të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) dhe ALUIZNI Gjirokastër, për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.</td></tr>
</table>

Nuk ka patur observacione nga Bashkia Përmet.

Taksë mbi tokën bujqësore

Zyra e Tatim Taksave, takson qytetarët që disponojnë tokë bujqësore sipas të dhënave që disponon nga Formulari 06, si dhe dokumenteve të pronësisë të depozituara nga qytetarët.

Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 *"Për sistemin e taksave vendore",* i ndryshuar

Sipas nenit 23 të ligjit nr. 9632 baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore në hektar në pronësi ose përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

Vlera e taksës mbi tokën bujqësore, vit pas viti përcaktohet me Vendim të Këshillit Bashkiak Përmet. Përkatësisht për vitet 2018, 2019 dhe 2020 taksa e tokës është si më poshtë, e njëjtë për të tre vitet në auditim:

A2.2 Taksat mbi tokën bujqësore	Njësia	Taksa
Taksa mbi tokën bujqësore për territorin e Bashkisë Përmet, ku sipas klasifikimit të Ministrisë Bujqësisë është kategori e V-të, VI- -të, VII-të- X-të	Lekë/ha/vit	1,000

Planifikimi dhe arkëtimi i taksës bujqësore për vitet 2018, 2019 dhe 2020

Viti	Plani (leke)	Fakti (leke)	Realizimi %
2018	2,435,000	1,441,000	59.2%
2019	2,435,000	2,617,000	107%
2020	2,435,000	1,997,000	82%

Si është paraqitur edhe në tabelën e mësipërme realizimi nga viti 2018 në vitin 2019 ka ardhur në rritje madje ka tejkalim të planifikimit. Realizimi ka pësuar rënie me 25 % në vitin 2020 kundrejt vitit 2019 duke sjellë ulje të të ardhurave të veta të Bashkisë Përmet nga taksa mbi tokën bujqësore.

Tab. Gjendja e Debitorëve në Bashkinë Përmet

Lloji i taksës/tarifes	Debitore për taksën e tokës- progresive				
Vitet	2018	Diferenca	2019	Diferenca	2020
Bashkia Përmet	2,943,131	1,522,477	4,465,608	542,038	5,007,646

Gjendja e debitorëve mbi taksën e tokës është paraqitur në tabelën e mësipërme, ku duhet theksuar se vlera nga viti 2019 në 2020 ka pësuar rënie dhe mbledhja e kësaj takse nëpërmjet agjentit tatimor Sh.a U. Përmet 2019- 2020 ka dhënë rezultate pozitive.
Grupi auditues ka konstatuar se nga ana e Bashkisë Përmet nuk janë kryer në vite kontabilizimet për debitorët e taksave, por duke qenë se nuk është bërë rakordim periodik dhe në fund të secilit vit, me mbylljen e Bilancit Kontabël, Zyra e Taksave dhe sektori i Financës duhet të hartojnë akt rakordimet përkatëse dhe të pasqyrohen në Bilancin e vitit në vazhdim.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:
Znj. E.K., Drejtoreshë e Drejtorisë së Financave; Z. L.S., Zyra e Tatim Taksave;

Titulli i Gjetjes nr. 6:	Të ardhura nga taksa mbi tokën bujqësore
Situata:	Vlera e debisë me 31.12.2020, bazuar në listat e nisura nga Zyra e Tatim Taksave është 5,007,646 lekë, e ardhur e munguar për Bashkinë Përmet. Njësia Administrative Piskovë shfaqet më problematike përsa i përket detyrimeve të prapambetura në vlerën 1,943,439 lekë dhe më pak problematike shfaqet njësia administrative Frashër me vlerën e detyrimit 256,716 lekë. Tab. Gjendja e Debitorëve në Bashkinë Përmet sipas NJA

	Lloji i taksës/tarifës	DEBITORE PER TAKSEN E TOKES		
	Njësia Administrative	2018	2019	2020
1	**Çarshovë**	2,028,930	1,747,624	1,340,773
2	**Frashër**	126,393	239,816	256,716
3	**Petran**	149,315	1,239,597	1,466,718
4	**Piskovë**	638,493	1,238,571	1,943,439
	Totali	2,943.131	4,465,608	5,007,646

Kriteri:	*Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar*
Ndikimi/Efekti:	Mos arkëtimin e të ardhurave në interes të Bashkisë Përmet në vlerën 5,007,646 lekë
Shkaku:	Mungesë të ardhurash
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Zyra e Tatim Taksave të marrë masa me qëllim arkëtimin e detyrimeve në shumën **5,007,646lekë.**

<u>Subjektet që tregtojnë karburante</u>

Aplikimi i tarifës për lejet dhe autorizimet për subjektet që tregtojnë hidrokarbure

Në Bashkinë Përmet gjatë periudhës objekt auditimi kanë ushtruar aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë 6 subjekte. Autoriteti përgjegjës për dhënien e këtyre lejeve si dhe mbledhjen e këtyre tarifave është Sektori i Shërbimeve. Në paketën fiskale janë specifikuar tarifat për dhënie liçence për tregtimin e naftës bruto 5 vjeçar.

Tarifa për dhënie licence për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj.	Tarifa për 5 vite
Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante	1,000,000 Lekë
Dhënie e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë (bombola gazi)	1,000,000 Lekë

Në Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 ñ*Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre"*, neni 4 citohhet se: ñé ushtrimi i veprimtarive në këtë fushë kryhet vetëm nga persona juridik pasi të jenë pajisur me licencat dhe autorizimet përkatëse. Dhënia e licencave për tregti me pakicë bëhet nga organet e qeverisjes vendore sipas juridiksionit përkatës, me një afat 5 vjeçar, me të drejtë përsëritje, për subjektet që zhvillojnë veprimtarinë e tregtimit të nënprodukteve të naftës në territorin e tyreñ.Bashkia Përmet menr. 378 prot., datë 07.02.2020, i është drejtuar me shkresë administratorëve të subjekteve ñS. Gò Shpk, ñM. & L.ò Shpk., ñI. & D.ò Shpk (ñK.ò Shpk) dhe për dijeni të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Inspektoriatit Qëndror Teknik ku kanë kërkuar të aplikojnë dhe të pajisen me licence subjektet.

Nr.	Personi Fizik/Juridik	Nipt	Autorizim (Për tregtim me pakicë të karburanteve dhe të lëndëve djegëse)	Lëshimi i Liçencës	Totali i detyrimit	Totali i gjobave
1	K. Sh.p.k	J61813529P	19/06/2015- 19/06/2020	06/08/2020-05/08/2025		
2	E. Sh.p.k	K09424205F	12/05/2015- 12/05/2020		1,000,000	20,000
3	K. Sh.p.k	L21721005U	03/12/2013- 03/12/2018		1,000,000	40,000
4	M. & L. Sh.p.k	L59313201N	28/01/2015- 28/01/2020		200,000	20,000
5	S. G	K04004205V	25/02/2015- 24/02/2020		1,000,000	20,000
6	R. Sh.p.k	L29222201G		21/05/2018-21/05/2022		
					3,200,000	100,000

Në total operojnë 6 subjekte të cilat tregtojnë karburant dhe gaz, 4 nga këto subjekte nuk e kanë kryer pagesën për përsëritjen e licencave në kundërshtim me VKM nr.970, datë 2.12.2015, për ñPërcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò, pika 14 dhe në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.4.2017, ñPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 2.12.2015, ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò, pika 9.

<u>Të ardhurat e munguara janë në vlerën 3,200,000 lekë. Bashkia Përmet nuk ka aplikuar gjoba për fillimin e aktivitetit pa marrë licencën në kundërshtim me Paketën Fiskale të vitit 2020 ku specifikohet se gjoba për fillim e aktivitetit pa marrë licencën është 20,000 lekë. Në total gjobat rezultojnë të jenë në vlerë 100,000 lekë mungesë të ardhurash për bashkinë Përmet.</u>

ñM. & L.ò Shpk, subjekti me Nipt L..N, e ka pezulluar aktivitetin e saj më datë 16.03.2021, shprehur në Ekstraktin Historik të shkarkuar nga QKB.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Z. E. N., specialist i Licencave dhe Strehimit, Sektori i Shërbimeve;

Titulli i gjetjes nr. 7:	Mos evidentim i subjekteve me veprimtari tregtare speciale, mos aplikim në formën dhe në vlerën e duhur i tarifave për këto kategori subjektesh dhe llogaritjen e gjobave (subjekte që tregtojnë karburante).
Situata:	Në Bashkinë Përmet në total operojnë 6 subjekte të cilat tregtojnë karburant dhe gaz, 4 nga këto subjekte nuk e kanë kryer pagesën për përsëritjen e licencave në kundërshtim me VKM nr.970, datë 2.12.2015, për ñPërcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò, pika 14 dhe në kundërshtim me VKM nr. 344, datë 19.4.2017, ñPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 2.12.2015, ñ*Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*ò, pika 9. Të ardhurat e munguara arrijnë në vlerën 3,200,000 lekë. Bashkia Përmet nuk ka aplikuar gjoba për fillimin e aktivitetit pa marrë licencën në kundërshtim me Paketën Fiskale të vitit 2020 ku specifikohet se gjoba për fillim e aktivitetit pa marrë licencën është 20,000 lekë. Në total gjobat rezultojnë të jenë në vlerë 100,000 lekë mungesë të ardhurash për Bashkinë Përmet.
Kriteri:	VKM nr.970, datë 2.12.2015, për ñPërcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò, pika 14, 15.1 VKM nr. 344, datë 19.4.2017 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò, pika 9, pika 15.1, pika 15.2
Ndikimi/Efekti:	Mos rinovimi i licencave, ka shkaktuar të ardhura të munguara në vlerën 3,300,000 lekë**.**
Shkaku:	Subjektet që ushtrojnë veprimtarinë pa licencë.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Sektori i Shërbimeve të marrë masa në mbledhjen e detyrimeve në vlerën **3,300,000 lekë .**

Nuk ka patur observacione nga Bashkia Përmet.

<u>Të ardhura nga qiratë e ndryshme.</u>

Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 8, datë 04.03.2016, ñPër miratimin e dhënies me qira të apartamenteve sociale të pallateve me numër pasurie 93/3 dhe 83/3 në pronësi të bashkisë Përmetò, ka vendsur

- Të miratojë vlerën e qirasë mujore për pasuritë me sipërfaqe 84.2 m^2- 88.7 m^2 në vlerën 3500 lekë/muaj për 20 apartamente
- Të miratojë vlerën e qirasë mujore për pasuritë me sipërfaqe 49.6 m^2 në vlerën 2500 lekë/muaj për 3 apartamente
- Me lidhjen e kontratave të qirasë dhe kryerjen e pagesave të qerave mujore të çdo apartamenti për 5 vite, përdoruesve u lind e drejta e privatizimit të banesës.

Prefekti i Qarkut e ka miratuar Vendimin më datë 18/03/2016, nr. 523/1.

Tab. Lista e përfitueseve

Nr.	**Emër Mbiemër**	Vlera / Muaj	**Vlera që duhet arkëtuar deri më 31.12.2020**	**Viti 2016-2017**	**Viti 2018**	**Viti 2019**	**Viti 2020**
				Vlera e pag.	Vlera e pag.	Vlera e pag.	Vlera e pag.
1	V. H.	3500	192,500	70,000	17,500	7,000	42,000
2	K. B.	2500	137,500	50,000	30,000	15,000	42,000
3	P. S.	3500	192,500	49,000	14,000	35,000	0
4	V. M.	3500	192,500	70,000	42,000	42,000	0
5	Q. N.	2500	137,500	0	0	0	0
6	D. C.	3500	192,500	0	0	0	0

7	I. D.	3500	192,500	66,500	38,500	31,500	27,500
8	Y. R.	3500	192,500	0	0	0	0
9	A. Dh.	2500	137,500	50,000	30,000	30,000	21,000
10	B. D.	3500	192,500	21,000	0	0	0
11	A. D.	3500	192,500	56,000	31,500	66,500	24,500
12	Sh. C.	3500	192,500	0	0	0	0
13	A. N.	3500	192,500	31,500	21,000	0	122,500
14	E. D.	3500	192,500	59,500	17,500	42,000	42,000
15	K. K.	3500	192,500	0	7,000	7,000	42,000
16	K. H.	3500	192,500	70,000	42,000	42,000	42,000
17	S. Gj.	3500	192,500	70,000	42,000	42,000	42,000
18	H. M.	3500	192,500	70,000	42,000	42,000	42,000
19	I.C. /A. D.	3500	192,500	28,000	42,000	42,000	112,000
20	Q. D.	3500	192,500	56,000	17,500	31,500	0
21	V. B.	3500	192,500	0	0	0	70,000
22	K. B.	3500	192,500	52,500	21,000	66,500	0
23	N. C.	3500	192,500	63,000	21,000	0	0
	Shuma		**4,262,500**	**933,000**	**476,500**	**542,000**	**671,500**

Të 23 subjektet përfituese kanë lidhur një kontratë me bashkinë Përmet ku është përcaktuar se qeraja duhet të paguhet brenda datës 10 të muajit pasardhës, kontratat janë lidhur për një afat 5 vjeçar nga 2016- 2021. Në periudhën e audituar 2018- 2020 janë arkëtuar nga Bashkia Përmet 1,690,000 lekë. Deri më 31.12.2020 duhet të paguheshin sipas kontratës së lidhur 55 muaj qera në vlerën 4,262,500 lekë në total ndërkohë deri më 31.12.2020 janë paguar në total 2,623,000 lekë diferencë prej **1,639,500 lekë**, **të ardhura të munguara për bashkinë Përmet.**

Grupi auditimit mori në analizë të gjitha këto kontrata nga të cilat mungojnë kontratat e lidhura me: D. Ç., Y. R., Sh. C. dhe V. B.

A. D., ka lidhur kontratë me bashkinë më 19.04.2016 për dhënien me qira të apartamentit 2+1 për një afat 5 vjeçar për vlerën 3500 lekë për muaj. Më 24.11.2017 ka firmosur deklaratën ku heq dore nga strehimi në këtë banesë ku deklaron se do kryej pagesën e gjithë detyrimeve.

Në Vendimin nr. 4, datë 05.12.2017 Këshilli Bashkiak miraton prishjen e kontratës së qirasë dhënë në përdorim qytetarit të pastrehë z. A. D. dhe lidhjen e kontratës për këtë banesë z. I. C. i cili ka përfituar statusin e të pastrehut me VKB. Kontrata midis Bashkisë Përmet dhe z. I. C. është lidhur më datë 29.12.2017.

Grupi i auditimit konstatoi se nuk ka patur dorëzim të dokumenteve me proces verbal nga punonjësi i mëparshëm i institucionit.

Kryetari i Bashkisë duhet të ngre një komision për dorëzimin e dokumentacionit të punës.

Për veprimet dhe mosveprimet në lidhje me ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve mbajnë përgjegjësi: Z. N.Sh., ish Kryetar i Bashkisë Përmet;dheZnj. A. H., Kryetar i Bashkisë Përmet; Z. E.N., specialist i Liçencave dhe Strehimit, Sektori i Shërbimeve;

Titulli i Gjetjes nr. 8:	Mungesë të ardhurash nga ambientet e dhëna me qira nga Bashkia Përmet
Situata:	Me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 8, datë 04.03.2016, ñPër miratimin e dhënies me qira të apartamenteve sociale të pallateve me numër pasurie 93/3 dhe 83/3 në pronësi të bashkisë Përmetò kanë lidhur kontratë me bashkinë 23 individë mbi marrjen me qira të 6 objekteve të saj. Të 23 përfituesit kanë lidhur një kontratë me bashkinë Përmet ku është përcaktuar se qiraja duhet të paguhet brenda datës 10 të muajit pasardhës, kontratat janë lidhur për një afat 5 vjeçar nga 2016- 2021. Në periudhën e audituar 2018- 2020 janë arkëtuar nga bashkia Përmet 1,690,000 lekë. Deri më 31.12.2020 duhet të paguheshin sipas kontratës së lidhur 55 muaj qira në vlerën 4,262,500 lekë në total ndërkohë deri më 31.12.2020 janë paguar në total 2,623,000 lekë diferencë prej **1,639,500 lekë**, **të**

	ardhura të munguara për bashkinë Përmet. Grupi auditues mori në analizë të gjitha këto kontrata nga të cilat mungojnë kontratat e lidhura me: D. Ç, Y. R., Sh. C. dhe V. B.
Kriteri:	VKM nr. 54, datë 05.02.2014ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, VKM nr. 735, datë 05.11.2014, VKM nr. 606, datë 31.08.2016 dhe VKM nr. 693, datë 05.10.2016, Kreu II plotësisht kërkesat të pikave (b; c; ç; d; e)
Ndikimi/Efekti:	Mos arkëtimin e të ardhurave në interes të bashkisë Përmet në vlerën 1,639,500 lekë
Shkaku:	Mungesë të ardhurash
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Sektori i Shërbimeve në bashkëpunim me Zyrën Juridike të marrë masa për ndjekjen dhe për detyrimin në vlerën **1,639,500 lekë**.

Nuk ka patur observacione nga Bashkia Përmet.

2.2 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitet 2018-2019-2020.

Mbi Analizën e Pasqyrave Financiare ***viti 2018***

Pasqyra Financiare Vjetore 2018 e Institucionit Bashkia Përmet është hartuar në zbatim të VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñPër miratimin e Planit Kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale si dhe të njësive që varen prej tyreò, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006 ñPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyre ò i ndryshuar.

Pasqyra Financiare Vjetore 2018, e bashkisë Përmet është depozituar në Degën e Thesarit Përmet me Shkresën nr. 697, datë 25.03.2019 dhe depozituar në Degën e Thesarit Përmet me Prot. nr. 11, datë 25.03.2019.

Pasqyra Financiare Vjetore 2018 është hartuar me Programin e Kontabilitetit

Janë kontabilizuar gjithë veprimet financiare të institucionit si:

-Banka e Shpenzimeve dhe e të ardhurave

-Magazinat

-Blerjet

-Inventarët

-Pagat e punonjësve dhe sigurimet shoqërore, shëndetësore e suplementare.

Nga programi gjenerohet raporte të llojeve të ndryshme në shërbim të analizës së aktivitetit financiar.

Me të dhënat e programit financiar, janë plotësuar Pasqyrat Financiare të vitit 2018, të cilat po i analizojmë si më poshtë:

1. Pasqyra 1 & 2: Aktivi është i barabartë me pasivin në shumën **962,829,584 lekë.**

-Klasa 2 e Aktivit të Bilancit: Janë pasqyruar elementet e AQT-ve, toka troje terrene, ndërtime e konstruksione, rrugë rrjete instalime, mjete transporti, inventar ekonomik e amortizimi në shumën 77,073,132**lekë.**

-Llogaria 210 "Toka, troje, Terrene", është shtuar me vlerën 0 lekë. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike.

-Llogaria 212 "Ndërtime & Konstruksione", është shtuar me vlerën 15,673,467lekë. 5,190,046 lekë për vlerën e ñRikualifikimit urban Qendra e Qytetitò5,926,853lekë, Kontabilizimi i ñProjektit të përmirësimit te kushteve te banimit për komunitete te favorizuaraò 4,556,568 leke, ñRikonstruksion i konviktit të qytetit ñ. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike.

- Llogaria 213 "Rrugë rrjete, vepra ujore"është shtuar për vlerën 111,474,661 lekë**,**për vlerën 13,493,659 lekë ñRehabilitim i rrjetit te ujësjellësit dhe rrugët e brendshme te fshatit Piskovëò, ñRikonstruksion e ndërtimi i urave ne fshatrat Kutal, Vercisht dhe Zhepeò,në vlerën 3,799,810 lekë, ñRikualifikimi Urban i disa Zonave në Përmetòpër vlerën 76,476,972 leke e ñProjektit të ndërtimit të urës se fshatit Pëllumbarò, për vlerën 13,873,260 lekë,Supervizime ne vlerën 546,490 lekë

-Llogaria 214 "Instalime, pajisje, vegla, etj.ò është shtuar ne vlerën 12,425,600 lekë, në llogarinë 214 pajisje kompjuterike të MB, për zyrat e bashkisë në vlerën 12,425,600 lekë. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike.

-Llogaria 215 "Mjete transportiò është shtuar me vlerën 0 lekë. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike

-Llogaria 218 "Inventar Ekonomikò është shtuar me vlerën 0 lekë. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Llogaria 219 "Amortizimi i AQT" është shtuar me vlerën 77,073,132lekë, për vlerën e amortizimit vjetor të AQT-ve viti 2018. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike.

<u>Klasa 3 e Aktivit të Bilancit</u>: Janë pasqyruar materialet, në shumën 39,748,099**lekë**, inventari kontabël i të cilave, përputhet me atë fizik. Inventari i imët u shtua për vlerën 4,157,129 lekë, vlera e materialeve të blera gjatë vitit ushtrimor 2018.

-Llogaria 31 "Materialeò është shtuar me vlerën 569,003 lekë, për vlerën e materialeve të blera gjatë vitit 2018 gjendje në magazinë. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Llogaria 32 "Objekte Inventari" është shtuar në vlerën 3,588,126 lekë, për vlerën e inventarit të imët hyrje gjatë vitit 2018. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike, Lista bashkëlidhur e fotokopjuar dhe në mënyrë elektronike. Për të gjitha llogaritë e klasës 2 e 3 të Aktivit të Bilancit, inventarët fizike përputhen me ato kontabile.

<u>Klasa 4 e Aktivit të Bilancit</u>: Pasqyron të tjera operacione me shtetin **34,036,249 lekë** dhe Debitorë në shumën **19,865,514 lekë**. Shuma e klasës 4 të aktivit është **53,901,763 lekë**.

-Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëmò ka ndryshime nga viti 2017, për vlerën 2,488,687leke vlera e lënë nga KLSH ne raportin e fundit. **Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.**

-<u>Klasa 5 e Aktivit të Bilancit</u>: Nuk ka gjendje në **arkë. Gjendja e bankës 76,241,587 lekë.** Gjendja në fund tregon gjendjen në Thesar në Dhjetor 2018 e në Bankë 2018 sipas Akt Rakordimit me Degën e Thesarit Përmet më datë 20.01.2019.

-Klasa 1Pasivit të Bilancit: Pasqyron fondet e bashkisë në shumën **962,829,584 lekë.**
, nga të cilat **76,166,598 lekë** janë grande të brendshme**.**

-Llogaria 101 "Fonde Bazë" është pakësuar me vlerën 77,073,132lekë për konsumin e aktiveve të qëndrueshme. Fondet janë shtuar për 139,573,728 lekë për grande të brendshme kapitale, të cilësuara në klasën 2 të aktivit të bilancit kontabël. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

<u>Klasa 4 e Pasivit të Bilancit</u>: Pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve, punonjësve, tatim taksave e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësorenë shumën **50,926,372`123 lekë.** Shuma e llogarisë që e ka kundër partinë në llog. 468 dhe 4342 në aktiv të bilancit.

-Llogaria 401-404 "Furnitorë e llogari të lidhur me to" Janë furnitorë të vjetër. Detyrimet ndaj furnitorëve kanë të bëjnë më detyrimin për energjinë elektrike, deri në Dhjetor 2015. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike

Detyrimet viti 2018 Bashkia Përmet

Bashkia	Kodi i Bashkisë	Kodi Degës thesarit	Emri i Furnitorit	Shuma totale e kontratës	Shuma e faturës
Përmet	2135001	128	A. K.		113,650
Përmet	2135001	128	H.&S.	217,360	
Përmet	2135001	128	A.	41,84,525	
Përmet	2135001	128	Këshilltarët		8819,787
Përmet	2135001	128			

Përmet	2135001	128			
Ërmet	2135001	128			
Përmet	2135001	128			
Përmet	2135001	128			
Përmet	2135001	128	Fatura OSHEE pa likuiduar		22,346,886.00
Përmet	2135001	128	T. C.	2,200,000	

-Llogaria 421 "Personel llogari të lidhur me to". Vlera 7,320,786 është vlera e pagave të punonjësve muaj Dhjetor 2018. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.
-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit Tatim-Taksa" është 303,145 lekë vlera e tatimeve të pagës për muajin Dhjetor 2018. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.
-Llogaria 435 "Sigurime Shoqërore, Shëndetësore e Suplementare" vlera 2,459,375 lekë, i takojnë vlerës së Sigurime Shoqërore, Shëndetësore e Suplementaretë muajit Dhjetor 2017. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.
-Llogaria 467 "Kreditorë te ndryshëm" lekë, që i takojnë vlerës për detyrime për vendimet gjyqësore të papaguara deri ne dhjetor te vitit 2018. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.
-Pasqyra 3/1 dhe 3/2 janë të barazuara në 329,154,273 **lekë**.Pasqyra 3/1 pasqyron shpenzimet faktike për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shpenzime operative, ndihma ekonomike, të konstatuara nga data 01.01.2018 deri 31.12.2018. Theksojmë se në këtë pasqyrëështë përfshirë ndryshimi i gjendjeve të inventarit për shumën 4,157,129 **lekë, shtesë ndryshim gjendjeje**. Pasqyra 3/2, tregon fondet e derdhura në thesar për funksionimin dhe llogarinë 7206 të vitit 2018.
1. **Pasqyra 4 "Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet"**. Ajo pasqyron investimet nga Buxheti i Shtetit që për vitin 2018 janë 139,573,728 **lekë**.
-Formati 5 "Pasqyra e Lëvizjes në CASH": Kjo është plotësuar sipas Situacionit të Degës së Thesarit Përmet. Gjendja në fund të së cilës tregon likuidimet e kaluara në Thesar në Dhjetor 2017 e në Bankë 2018. Teprica e bankës prej 76,241,587 lekë, tregon shpenzimin e kaluar në Thesar në vitin 2018 dhe në Bankë në vitin 2018.
-Formati 6 "Gjendja dhe ndryshimi i AQT-ve: Janë pasqyruar gjendja e AQT-ve nga kalimet kapitale nga jashtë dhe brenda sistemit tek shtesat gjatë vitit 2018. Gjendja në fund të vitit 2018 përkon me gjendjen në aktiv të bilancit 2018. Ndryshimi i grandeve të brendshme tek Pasivi i Bilancit, me lëvizjet pa pagesë tek kjo pasqyrë, ka të bëjë me faktin që diferenca janë inventar i imët, jo AQT.
-Formati 7 "Pasqyra e amortizimeve": Është plotësuar sipas VKM nr. 401 të vitit 1989, ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike. Vlerat e saj përputhen me atë të Aktivit të bilancit.
1.Formati 8 "Pasqyra e lëvizjes së fondeve": Kjo pasqyrë është plotësuar për shtesat dhe pakësimet e fondeve gjatë vitit 2018. Fondet janë shtuar për investimet e vitit 2018, është pakësuar për amortizimin e llogaritur të vitit 2018. Shumat në fund të pasqyrës përputhet me gjendjet e fondeve në vitin 2018, në pasiv të bilancit.
2.Formati 9 "Numri i punonjësve dhe fondi i pagave": Pasqyron shpenzimet për paga, etj. të konstatuara (jo të likuiduara) nga 01.01.2018 deri 31.12.2018. Kjo pasqyrë është plotësuar me të dhënat e pasqyrës 3/1, për zërat paga, tatime, shpërblime, ndihma, sigurime shoqërore e shëndetësore.

<u>Mbi Kryerjen e Inventarizimeve, për vitin 2018</u>:
Për vitin 2018, në bashkinë Përmet, sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve në sektorin publikò, janë kryer **inventarizimet si më poshtë:**

Sipas urdhrit të Kryetarit nr. 319, datë 26.12.12.2018 është ngritur Komisioni për vlerësimin e aktiveve të vitit 2018 i përbërë nga 5 antarë, respektivisht për Komisionin e bashkisë: Klarita Graci (specialiste finance-Kryetare), Ledian Komino (anëtar-punonjës bashkie), Laert Bushi(anëtare-Punonjes Bashkie,Specialist Urbanistike),Ligor Simoni (Specialist taksash(financier-anëtar), Mimoza Ajazi (punonjëse arkivi-Antar).
Komisioni i Inventarizimit ka kryer inventarizimin e aktiveve të ambienteve të zyrave, të ambienteve të përbashkëta të PMNZ-shë në të,kopshte, shkolla, konvikt,çerdhe,NjA, rrugët rurale si dhe automjeteve. Ka hartuar pasqyrat përkatëse duke bërë edhe rakordimet me gjendjen kontabile dhe nuk janë konstatuar diferenca. Janë konstatuar pajisje zyrash dhe inventar i imët i amortizuar, por nuk kanë dalë ende jashtë përdorimit. Theksojmë se në këtë shumë janë përfshirë edhe materialet të cilat janë përgatitur për tû nxjerrë jashtë përdorimit, gjatë viteve të mëparshme 2013 dhe 2014,2015,2016, të cituara më sipër, por ende deri më datën 31.12.2018 nuk ishin kryer procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit. Në përfundimin e procesit të inventarizimit, nuk kanë rezultuar diferenca.

<u>Mbi Analizën e Pasqyrave Financiare</u> ***viti 2019***
Pasqyra Financiare Vjetore 2019 e Institucionit Bashkia Përmet është hartuar në zbatim të VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñPër miratimin e Planit Kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale si dhe të njësive që varen prej tyreò, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006 ñPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyreò i ndryshuar.
Pasqyra Financiare Vjetore 2019, e Bashkisë Përmet është depozituar në Degën e Thesarit Përmet me Shkresën nr. 811, datë 31.03.2020 dhe depozituar në Degën e Thesarit Përmet me Prot. nr. 135, datë 31.03.2020.
Pasqyra Financiare Vjetore 2019 është hartuar me Programin e Kontabilitetit
Janë kontabilizuar gjithë veprimet financiare të institucionit si:
-Banka e Shpenzimeve dhe e të ardhurave
-Magazinat
-Blerjet
-Inventarët
-Pagat e punonjësve dhe sigurimet shoqërore, shëndetësore e suplementare.
Nga programi gjenerohet raporte të llojeve të ndryshme në shërbim të analizës së aktivitetit financiar.
Me të dhënat e programit financiar, janë plotësuar Pasqyrat Financiare të vitit 2019, të cilat po i analizojmë si më poshtë:
1. Pasqyra 1 & 2: Aktivi është i barabartë me pasivin në shumën **972,246,637lekë.**
-<u>Klasa 2 e Aktivit të Bilancit</u>: Janë pasqyruar elementet e AQT-ve, toka troje terrene, ndërtime e konstruksione, rrugë rrjete instalime, mjete transporti, inventar ekonomik e amortizimi në shumën 84,050,764**lekë.**
-Llogaria 210 "Toka, troje, Terrene", është shtuar me vlerën 0 lekë. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike.
-Llogaria 212 "Ndërtime & konstruksione", është shtuar me vlerën 55,909,162 lekë. 49,846,798 për vlerën e objektit: ñRikonstruksion Gjimnazi ñSami Frasheriò 5,702,364 lekë Kontabilizimi i ñProjektit të përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të favorizuaraò,360,000 lekë, òSupervizimeñ. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.
- Llogaria 213 "Rrugë rrjete,vepra ujore" është shtuar për vlerën 45,004,827 lekë**,**për vlerën 6,997,516 lekë ñRehabilitim i rrjetit të ujësjellësit dhe rrugët e brendeshme të fshatit Piskovëò,òNdriçim i Gurit të Qytetitò, në vlerën 4,184,423 lekë, òSistemim asfaltim rrugët e Bashkisë Përmetò, për vlerën 20,059,608 lekë ,òKanali Stermbecò, për vlerën 12,699,120

lekë, ,òSistemim Asfaltim rruga e pularisë së vjetërò, për vlerën 83,760 lekë, Supervizime në vlerën 356,400 lekë, ñF.V Transformatori dhe paneli elektrikò, në vlerën 624,000 lekë, Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Llogaria 214 "Instalime, pajisje, vegla, etj.ò është shtuar ne vlerën 122.400 lekë, në llogarinë 214ñBlerje krevat për çerdhenò në vlerën 122,400. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike.

-Llogaria 215 "Mjete transportiò është shtuar me vlerën 0 lekë. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike.

-Llogaria 218 "Inventar Ekonomikò është shtuar me vlerën 0 lekë. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Llogaria 219 "Amortizimi i AQT" është shtuar me vlerën 84,050,764lekë, për vlerën e amortizimit vjetor të AQT-ve, viti 2018. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike, Lista bashkëlidhur e fotokopjuar dhe në mënyrë elektronike.

Klasa 3 e Aktivit të Bilancit: Janë pasqyruar materialet, në shumën 41,114,774lekë, inventari kontabël i të cilave, përputhet me atë fizik. Inventari i imët u shtua për vlerën 1,366,675 lekë, vlera e materialeve të blera gjatë vitit ushtrimor 2019.

-Llogaria 31 "Materialeò është shtuar me vlerën 530,900 lekë, për vlerën e materialeve të blera gjatë vitit 2019 gjendje në magazinë. Llogaria sintetikekuadron me llogaritë analitike.

-Llogaria 32 "Objekte Inventari" është shtuar në vlerën 835,775lekë, për vlerën e inventarit të imët hyrje gjatë vitit 2019. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike, Lista bashkëlidhur e fotokopjuar dhe në mënyrë elektronike. Për të gjitha llogaritë e klasës 2 e 3 të Aktivit të Bilancit, inventarët fizike përputhen me ato kontabile.

Klasa 4 e Aktivit të Bilancit: Pasqyron të tjera operacione me shtetin **12,750,942 lekë** dhe Debitorë në shumën **34.036,249 lekë**. Shuma e klasës 4 të aktivit është **46,787,191 lekë**.

-Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëmò s̄ka ndryshime nga viti 2018,për vlerën. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Klasa 5 e Aktivit të Bilancit: Nuk ka gjendje në **arkë. Gjendja e bankës 73,778,076 lekë.** Gjendja në fund tregon gjendjen në Thesar në Dhjetor 2019 e në Bankë 2019 sipas Akt Rakordimit me Degën e Thesarit Përmet me date 22.01.2020.

-Klasa 1Pasivit të Bilancit: Pasqyron fondet e Bashkisë në shumën **972,246,637 lekë.**, nga të cilat **56,543,536 lekë** janë grande të brendshme**.**

-Llogaria 101 "Fonde Bazë" është pakësuar me vlerën 84,050,763lekë për konsumin e aktiveve të qëndrueshme.Fondet janë shtuar për 101,438,269 lekë për grande të brendshme kapitale, të cilësuara në klasën 2 të aktivit të bilancit kontabël. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike, Lista bashkëlidhur e fotokopjuar dhe në mënyrë elektronike.

Klasa 4 e Pasivit të Bilancit: Pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve, punonjësve, tatim taksave e Sigurimeve Shoq. e Shënd.në shumën **41,526,195 lekë.** Shuma e llogarisë që e ka kundër partinë në llog. 468 dhe 4342 në aktiv të bilancit.

-Llogaria 401-404 "Furnitorë e llogari të lidhur me to" Janë furnitorë të vjetër. Detyrimet ndaj furnitorëve kanë të bëjnë më detyrimin për energjinë elektrike, deri në Dhjetor 2015. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike

Detyrimet viti 2019 Bashkia Përmet

Bashkia	Kodi i Bashkise	Kodi i Deges së Thesarit	Emri i Furnitorit	Totali i pa likuiduar	Data e fatures	Nr i faturës	Shuma e fatures
Përmet	2135001	1128	A. G. shpk	21,600	23.08.2019	1414	21,600
Përmet	2135001	1128	B.	136,800	22.11.2019	46	138,600
Përmet	2135001	1128	H.	119,880	02.12.2019	36	119,880
Përmet	2135001	1128	E. L.	346,800	22.11.2019	33	346,800
Përmet	2135001	1128	E. S.	52,500	25.10.2019	26	52,500
Përmet	2135001	1128	A. C.	32,000	22.11.2019	171	32,000
Përmet	2135001	1128	K. Xh.	120,000	02.12.2019	96	120,000
Përmet	2135001	1128	E. L.	252,000	27.11.2019	37	252,000
Përmet	2135001	1128	D. S.	17,360	14.02.2019	215	17,360

Përmet	2135001	1128	E.	87,925	23.12.2019	639	87,925
Përmet	2135001	1128	E.	43,963	23.12.2019	642	43,963
Përmet	2135001	1128	E.	63,306	24.12.2019	644	63,306
Përmet	2135001	1128	E.	109,027	24.12.2019	648	109,027
Përmet	2135001	1128	E.	8,792	18.12.2019	651	8,792
Përmet	2135001	1128	T. M.	54,900	18.12.2019	26/19	54,900
Përmet	2135001	1128	R.	105,000	27.10.2019	140	105,000
Përmet	2135001	1128	H. P.	49,980	26.10.2019	12	49,980
Përmet	2135001	1128	J. C.	35,315	26.010.2019	10	35,315
Përmet	2135001	1128	E. S.	52,500	25.10.2019	26	52,500
Përmet	2135001	1128	P. L.	31,120	02.12.2019	46	31,120
Përmet	2135001	1128	IT Gj. K.	93,750	25.06.2019	270012827	93,750
Përmet	2135001	1128	K. Xh.	26,400	12.12.2019	146	26,400
Përmet	2135001	1128	R. N.	167,800	21.11.2019	41	167,800
Përmet	2135001	1128	I. I.	120,000	25.11.2019	17	120,000
Përmet	2135001	1128	4.D.	218,976	13.12.2019	2680677989	218,976
Përmet	2135001	1128					
							2,369,494
Detyrime viti 2019 Bashkia Përmet							
Bashkia	Kodi i bashkise	Kodi i deges se thesarit	Emri i furnitorit	Totali i pa likuidua	Data e fatures	Nr i fatures	Shuma e fatures
Përmet	2135001	1128	Trajner futbolli	17,000			17,000
Përmet	2135001	1128	Dieta pinpongu	33,760			33,760
Përmet	2135001	1128	Trajner futbolli	8,500			8,500
Përmet	2135001	1128	Kryetaret e fshat	85,000			85,000
Përmet	2135001	1128	Dieta personeli	38,720			38,720
Përmet	2135001	1128	Dieta personeli	109,980			109,980
Përmet	2135001	1128	Këshilltaret	175,440			175,440
Përmet	2135001	1128	Këshilltaret	29,240			29,240
Përmet	2135001	1128	Dieta futbolli	35,600			35,600
Përmet	2135001	1128	Kryetaret e fshat	212,500			212,500
Përmet	2135001	1128	Keshilltaret	102,000			102,000
Përmet	2135001	1128	posta	62,555			62,555
Përmet	2135001	1128	telek	16,308			16,308
Përmet	2135001	1128					0
Përmet	2135001	1128					0
Përmet	2135001	1128					

-Llogaria 421 "Personel llogari të lidhur me to". Vlera 6,717, 081 është vlera e pagave të punonjësve nëmuajin Dhjetor 2019. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit Tatim-Taksa" është 328,184 lekë vlera e tatimeve të pagës për muajin Dhjetor 2019. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Llogaria 435 "Sigurime Shoqërore, Shëndetësore e Suplementare" vlera 2,278,499 lekë, i takojnë vlerës së sigurime shoqërore, shëndetësore e suplementaretë muajit Dhjetor 2019. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Llogaria 467 "Kreditorë te ndryshëm" 11,540,713lekë, që i takojnë vlerës per detyrime e vendimet gjyqësore të papaguara deri në Dhjetor te vitit 2019. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Pasqyra 3/1 dhe 3/2 janë të barazuara në 303,991,013 lekë.Pasqyra 3/1 pasqyron shpenzimet faktike për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shpenzime operative, ndihma ekonomike, të konstatuara nga data 01.01.2019 deri 31.12.2019. Theksojmë se në këtë pasqyrëështë përfshirë ndryshimi i gjendjeve të inventarit për shumën 1,366,675lekë, **shtesë ndryshim gjendjeje**. Pasqyra 3/2, tregon fondet e derdhura në thesar për funksionimin dhe llogarinë 7206 të vitit 2019.

1. **Pasqyra 4 "Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet"**. Ajo pasqyron investimet nga buxheti i shtetit që për vitin 2019 janë 101,438,269 **lekë**.

-Formati 5 "Pasqyra e Lëvizjes në CASH": Kjo është plotësuar sipas Situacionit të Degës së Thesarit Përmet. Gjendja në fund të së cilës tregon likuidimet e kaluara në thesar në Dhjetor 2019 e në bankë 2019. Teprica e bankës prej 73,777,712 lekë, tregon shpenzimin e kaluar në thesar ne vitin 2019 dhe në bankë në vitin 2019.

-Formati 6 "Gjendja dhe ndryshimi i AQT-ve": Janë pasqyruar gjendja e AQT-ve nga kalimet kapitale nga jashtë dhe brenda sistemit tek shtesat gjatë vitit 2019. Gjendja në fund të vitit 2019 përkon me gjendjen në aktiv të bilancit 2019. Ndryshimi i grandeve të brendshme tek pasivi i bilancit, me lëvizjet pa pagesë tek kjo pasqyrë, ka të bëjë me faktin që diferenca janë inventar i imët, jo AQT.
-Formati 7 "Pasqyra e amortizimeve": Është plotësuar sipas VKM nr. 401 të vitit 1989, ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike. Vlerat e saj përputhen me atë të aktivit të bilancit.
1.Formati 8 "Pasqyra e lëvizjes së fondeve": Kjo pasqyrë është plotësuar për shtesat dhe pakësimet e fondeve gjatë vitit 2019. Fondet janë shtuar për investimet e vitit 2019, është pakësuar për amortizimin e llogaritur të vitit 2019. Shumat në fund të pasqyrës përputhet me gjendjet e fondeve në vitin 2019, në pasiv të bilancit.
2.Formati 9 "Numri i punonjësve dhe fondi i pagave": Pasqyron shpenzimet për paga, etj, të konstatuara (jo të likuiduara) nga 01.01.2019 deri 31.12.2019. Kjo pasqyrë është plotësuar me të dhënat e pasqyrës 3/1, për zërat paga, tatime, shpërblime, ndihma, sigurime shoqërore e shëndetësore.

<u>Mbi Kryerjen e Inventarizimeve, për vitin 2019</u>:
Për vitin 2019, në bashkinë Përmet, sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve ne sektorin publikò, janë kryer **inventarizimet si më poshtë:**
Sipas urdhrit të Kryetarit nr. 319, datë 26.12.12.2018 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Aktiveve të vitit 2018 i përbërë nga 5 anëtarë, respektivisht: Për Komisionin e Bashkisë: K. G. (specialiste finance-Kryetare), L. K. (anëtar- punonjës bashkie), L. B.(anëtare- punonjës bashkie, specialist urbanistike), L. S.(specialist taksash (financier-Antar), M. A. (punonjëse arkivi-Anëtar).
Komisioni i Inventarizimit ka kryer inventarizimin e aktiveve të ambienteve të zyrave, të ambienteve të përbashkëta të PMNZ-shë në kopshte, shkolla, konvikt,çerdhe, NjA, rrugët rurale si dhe automjeteve. Ka hartuar pasqyrat përkatëse duke bërë edhe rakordimet me gjendjen kontabile dhe nuk janë konstatuar diferenca. Janë konstatuar pajisje zyrash dhe inventar i imët i amortizuar, por nuk kanë dalë ende jashtë përdorimit. Theksojmë se në këtë shumë janë përfshirë edhe materialet të cilat janë përgatitur për tôu nxjerrë jashtë përdorimit, gjatë viteve të mëparshme 2013 dhe 2014,2015,2016, të cituara më sipër, por deri më datën 31.12.2019 nuk ishin kryer procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit. Në përfundimin e procesit të Inventarizimit, nuk kanë rezultuar diferenca.

<u>Mbi Analizën e Pasqyrave Financiare</u> ***viti 2020***
Pasqyra Financiare Vjetore 2020, e institucionit bashkia Përmet është hartuar në zbatim të VKM nr. 248, datë 10.04.1998 ñPër miratimin e Planit Kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore e Lokale si dhe të njësive që varen prej tyreò, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 14, datë 28.12.2006 ñPër përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006 për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësive që varen prej tyreò i ndryshuar.
Pasqyra Financiare Vjetore 2020, e bashkisë Përmet është depozituar në Degën e Thesarit Përmet me Shkresën nr. 838, datë 30.03.2021 dhe depozituar në Degën e Thesarit Përmet me Prot. nr. 142, datë 31.03.2021.
Pasqyra Financiare Vjetore 2020, është hartuar me Programin e Kontabilitetit
Janë kontabilizuar gjithë veprimet financiare të institucionit si:
-Banka e Shpenzimeve dhe e të ardhurave
-Magazinat

-Blerjet
-Inventarët
-Pagat e punonjësve dhe sigurimet shoqërore, shëndetësore e suplementare.
Nga programi gjenerohen raporte të llojeve të ndryshme në shërbim të analizës së aktivitetit financiar.
Me të dhënat e programit financiar, janë plotësuar Pasqyrat Financiare të vitit 2020 të cilat po i analizojmë si më poshtë:
1.Pasqyra 1 & 2: Aktivi është i barabartë me pasivin në shumën **990,352,998lekë.**
-Klasa 2 e Aktivit të Bilancit: Janë pasqyruar elementet e AQT-ve, toka troje terrene, ndërtime e konstruksione, rrugë rrjete instalime, mjete transporti, inventar ekonomik e amortizimi në shumën 84,050,764**lekë.**
-Llogaria 210 "Toka, troje, terrene", është shtuar me vlerën 0 lekë. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike, Lista bashkëlidhur e fotokopjuar dhe ne Elektronike
-Llogaria 212 "Ndërtime & Konstruksione", është shtuar me vlerën 55,909,162 lekë. 49,846,798 për vlerën e objektit: ñRikonstruksion Gjimnazi ñSami Frasheriò, 5,702,364 lekë Kontabilizimi i ñProjektit të përmirësimit të kushteve të banimit për komunitete të favorizuaraò 360,000 leke, ñSupervizimeò. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike.
- Llogaria 213 "Rrugë rrjete, vepra ujore" është shtuar për vlerën 45,004,827 lekë**,**për vlerën 6,997,516 lekë ñRehabilitim i rrjetit te ujësjellësit dhe rrugët e brendëshme të fshatit Piskoveò, ñNdriçim i Gurit të Qytetitò ,në vlerën 4,184,423 lekë,òSistemim asfaltim rrugët e bashkisë Përmetòpër vlerën 20,059,608 leke ,òKanali Stermbecò, për vlerën 12,699,120 lekë, ,òSistemim Asfaltim rruga e pularisë së vjetër ò për vlerën 83,760 lekë, Supervizime në vlerën 356,400 lekë, ñF.V Transformatori dhe paneli elektrikò, në vlerën 624,000 lekë, Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike.
-Llogaria 214 "Instalime, pajisje, vegla, etjò është shtuar në vlerën 122.400 lekë, në llogarinë 214 ñBlerje Krevat për çerdhenò në vlerën 122,400. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike.
-Llogaria 215 "Mjete transportiò është shtuar me vlerën 0 lekë. Llogaria sintetike kuadron me llogarite analitike
-Llogaria 218 "Inventar Ekonomikò është shtuar me vlerën 0 lekë. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.
-Llogaria 219 "Amortizimi i AQT" është shtuar me vlerën 84,050,764lekë, për vlerën e amortizimit vjetor të AQT-ve, viti 2018. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.
Klasa 3 e Aktivit të Bilancit: Janë pasqyruar materialet, në shumën 41,114,774**lekë**, inventari kontabël i të cilave, përputhet me atë fizik. Inventari i imët u shtua për vlerën 1,366,675 lekë, vlera e materialeve të blera gjatë vitit ushtrimor 2019
-Llogaria 31 "Materialeò është shtuar me vlerën 530,900 lekë, për vlerën e materialeve të blera gjatë vitit 2019 gjendje në magazinë. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.
-Llogaria 32 "Objekte Inventari" është shtuar në vlerën 835,775lekë, për vlerën e inventarit të imët hyrje gjatë vitit 2019. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike, Lista bashkëlidhur e fotokopjuar dhe në mënyrë elektronike. Për të gjitha llogaritë e klasës 2 e 3 të Aktivit të Bilancit, inventarët fizike përputhen me ato kontabile.
Klasa 4 e Aktivit të Bilancit: Pasqyron të tjera operacione me shtetin **23,198,811 lekë** dhe debitorë në shumën **33,198,811 lekë**. Shuma e klasës 4 të aktivit është **57,020,315 lekë**.
-Llogaria 468 "Debitorë të ndryshëmò ka ndryshime nga viti 2019, për vlerën 837,438 lekë, vlera e pagesave për aluiznin, lejet e ndërtimit. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.
-Klasa 5 e Aktivit të Bilancit: Nuk ka gjendje nëarkë. **Gjendja e bankës** 73,541,911 **lekë.**
Gjendja në fund tregon gjendjen në Thesar në Dhjetor 2020 e në Bankë 2020 sipas Akt Rakordimit me Degën e Thesarit Përmet më datë 22.01.2021.

-Klasa 1Pasivit të Bilancit: Pasqyron fondet e Bashkisë në shumën **990,352,998lekë**, nga të cilat **59,960,970 lekë**, janë grande të brendshme**.**

-Llogaria 101 "Fonde Bazë" është pakësuar me vlerën **89,121,675 lekë** për konsumin e aktiveve të qëndrueshme. Fondet janë shtuar për **100,218,231 lekë** për grande të brendshme kapitale, të cilësuara në klasën 2 të aktivit të Bilancit kontabël. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

Klasa 4 e Pasivit të Bilancit: Pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve, punonjësve, tatim taksave e Sigurimeve Shoq. e Shënd.në shumën **45,666,546 lekë.** Shuma e llogarisë që e ka kundër partinë në llog. 468 dhe 4342 në aktiv të bilancit.

-Llogaria 401-404 "Furnitorë e llogari të lidhur me to" Janë furnitorë të vjetër. Detyrimet ndaj furnitorëve kanë të bëjnë më detyrimin për energjinë elektrike, deri në Dhjetor 2015. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

Detyrime viti 2020, Bashkia Përmet

Bashkia	Kodi i bashkise	Kodi i deges se thesarit	Emri i furnitorit	Totali i pa likuiduar	Data e faturës	Nr i fatures	Shuma e fatures
Përmet	2135001	1128	A. shpk	359,400	29.12.2020	28	359,400
Përmet	2135001	1128	A. shpk	293,040	29.12.2020	27	293,040
Përmet	2135001	1128	A. C.	8,149,036	07.02.2020	7	8,149,036
Përmet	2135001	1128	N. shpk	2,186,750	01.05.2020	37	2,186,750
Përmet	2135001	1128	Keshilltaret ,nentor,dhjetor	258,000	Nentor-dhjetor		258,000
Përmet	2135001	1128	Kryetar fshatrash	700,000	Shtat.tet.nent.dhjeto		700,000
Përmet	2135001	1128	Kreitor ,largime viti 2020	352,500			352,500
Përmet	2135001	1128	M. DH.	91,000	2020		91,000
Përmet	2135001	1128	S. K.	88,000	2020		88,000
Përmet	2135001	1128	M. Z.	13,000	2020		13,000
Përmet	2135001	1128	I. C.	136,500	2020		136,500
Përmet	2135001	1128	K. M.	24,000	2020		24,000
Përmet	2135001	1128	Sporti te ndryshme	448,400	2020		448,400
Përmet	2135001	1128	Librari dyrrahu shpk	573,332	28.12.2020		573,332
Përmet	2135001	1128	Oshee 2007-2015	2,346,886	2007-2015		2,346,886
Përmet	2135001	1128	T.	2,200,102			2,200,102
Përmet	2135001	1128	Vendime gjyqesore	1,717,113	2007-2015		1,717,113
Përmet	2135001	1128					
Përmet	2135001	1128					
Përmet	2135001	1128					
Përmet	2135001	1128					
Përmet	2135001	1128					
Përmet	2135001	1128					
Përmet	2135001	1128					
Përmet	2135001	1128					
Përmet	2135001	1128					

-Llogaria 421 "Personel llogari të lidhur me to". Vlera 7,595,527 është vlera e pagave të punonjësve muaj Dhjetor 2020. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit Tatim-Taksa" është 345,106 lekë vlera e tatimeve të pagës për muajin Dhjetor 2020. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Llogaria 435 "Sigurime Shoqërore, Shëndetësore e Suplementare" vlera 2,560,413 lekë, i takojnë vlerës së Sigurime Shoqërore, Shëndetësore e Suplementaretë muajit Dhjetor 2020. Llogaria sintetikekuadron me llogaritë analitike.

-Llogaria 467 "Kreditorë te ndryshëm" 6,264,101lekë, që i takojnë vlerës për detyrime e vendimet gjyqësore të papaguara deri ne dhjetor te vitit 2020. Llogaria sintetike kuadron me llogaritë analitike.

-Pasqyra 3/1 dhe 3/2 janë të barazuara në 318,320,986 **lekë**.Pasqyra 3/1 pasqyron shpenzimet faktike për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore, shpenzime operative, ndihma ekonomike, të konstatuara nga data 01.01.2020 deri 31.12.2020. Theksojmë se në këtë pasqyrëështë përfshirë ndryshimi i gjendjeve të inventarit për shumën 2,289,470**lekë, shtese ndryshim gjendjeje**. Pasqyra 3/2, tregon fondet derdhura në thesar për funksionimin dhe llogarinë 7206 të vitit 2020.

1. **Pasqyra 4 "Burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet"**. Ajo pasqyron investimet nga Buxheti i Shtetit që për vitin 2020 janë 100,218,231 **lekë**.
-Formati 5 "Pasqyra e Lëvizjes në CASH": Kjo është plotësuar sipas Situacionit të Degës së Thesarit Përmet. Gjendja në fund të së cilës tregon likuidimet e kaluara në Thesar në Dhjetor 2020 e në Bankë 2020. Teprica e bankës prej 73,541,911 lekë, tregon shpenzimin e kaluar në Thesar ne vitin 2020 dhe në Bankë në vitin 2020.
-Formati 6 "Gjendja dhe ndryshimi i AQT-ve": Janë pasqyruar gjendja e AQT-ve nga kalimet kapitale nga jashtë dhe brenda sistemit tek shtesat gjatë vitit 2020. Gjendja në fund të vitit 2020 përkon me gjendjen në aktiv të bilancit 2020. Ndryshimi i grandeve të brendshme tek Pasivi i Bilancit, me lëvizjet pa pagesë tek kjo pasqyrë, ka të bëjë me faktin që diferenca janë inventar i imët, jo AQT.
-Formati 7 "Pasqyra e amortizimeve": Është plotësuar sipas VKM nr. 401 të vitit 1989, ndërsa për pajisjet informatike dhe elektronike. Vlerat e saj përputhen me atë të Aktivit të bilancit.
1.Formati 8 "Pasqyra e lëvizjes së fondeve": Kjo pasqyrë është plotësuar për shtesat dhe pakësimet e fondeve gjatë vitit 2019. Fondet janë shtuar për investimet e vitit 2020, është pakësuar për amortizimin e llogaritur të vitit 2020. Shumat në fund të pasqyrës përputhet me gjendjet e fondeve në vitin 2020, në pasiv të bilancit.
2.Formati 9 "Numri i punonjësve dhe fondi i pagave": Pasqyron shpenzimet për paga, etj, të konstatuara (jo të likuiduara) nga 01.01.2020 deri 31.12.2020. Kjo pasqyrë është plotësuar me të dhënat e pasqyrës 3/1, për zërat paga, tatime, shpërblime, ndihma, sigurime shoqërore e shëndetësore.

<u>Mbi Kryerjen e Inventarizimeve, për vitin 2020</u>:
Për vitin 2020, në bashkinë Përmet, sipas procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve ne sektorin publikò, janë kryer **inventarizimet si më poshtë:**
Sipas urdhrit të Kryetarit nr. 319, datë 26.12.12.2018 është ngritur Komisioni për Vlerësimin e Aktiveve të vitit 2018 i përbërë nga 5 antarë, respektivisht: Për Komisionin e Bashkisë : E. M. (Përgjegjëse finacës -Kryetare) K. G. (specialiste finance-Anëtare), E. A. (anëtar-punonjës bashkie), S. S. (anëtar- Punonjës Bashkie, specialist urbanistike), B. Dh. (specialist taksash).
Komisioni i Inventarizimit ka kryer inventarizimin e aktiveve të ambienteve të zyrave, të ambienteve të përbashkëta të PMNZ-shë në kopshte, shkolla, konvikt, çerdhe, NjA, rrugët rurale si dhe automjeteve. Ka hartuar pasqyrat përkatëse duke bërë edhe rakordimet me gjendjen kontabile dhe nuk janë konstatuar diferenca. Janë konstatuar pajisje zyrash dhe inventar i imët i amortizuar, por nuk kanë dalë ende jashtë përdorimit. Theksojmë se në këtë shumë janë përfshirë edhe materialet të cilat janë përgatitur për tôu nxjerrë jashtë përdorimit, gjatë viteve të mëparshme 2013 dhe 2014,2015,2016, të cituara më sipër, por ende deri më datën 31.12.2020 nuk ishin kryer procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit. Në përfundimin e procesit të inventarizimit, nuk kanë rezultuar diferenca.
Duke ju referuar Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò, Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018, ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeñ grupi i auditimit konstatoi se në Aktivet Afatgjata Financiare, llogaria 26 ñPjesëmarrja me kapitalin e vetò është në vlerën 0 lekë, e cila duhet të përfaqësonte vlerën e aksioneve që ka ñUjësjellës Kanalizime Përmetò Sha, nuk është përcaktuar vlera, dhe nuk është përditësuar pasi është krijuar ndërmarrje ñUjësjellës Kanalizime PërmetòSha, bashkia Përmet i vendosi në dispozicion grupit auditues Vendimin e Gjyqtarit të vetëm më 02.04.99 për miratimin e ekspertit kontabël, i cili do bënte dhe vlerësimin e kapitalit kontabël sipas Ligjit 8237, datë 1.09.1997 ñPër disa ndryshime në Ligjin 7926, datë 20.04.1995 ñPër transformimin e

ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtareò, ndryshuar dhe me akte të tjera ligjore, i cili vlerësoi kapitalin themeltar të shoqërisë 66,315,000, nga kjo vlera e truallit është 5,590,928 lekë, numri i aksioneve është 66,315 dhe vlera nominale e aksionit është 1000 lekë.

Nuk janë kryer kontabilizimet në lidhje me vlerën e:

- debitorëve familjarë për taksën e ndërtesës dhe taksën e shërbimit 6,697,803 lekë
- debitorëve nga bizneset për taksat dhe tarifat vendore 14,022,894 lekë dhe 1,897,248 lekë të gjobave për taksat dhe tarifat vendore
- taksës së ndikimit në infrastrukturë 258,481 lekë
- tokën bujqësore 5,007,646 lekë (nga të cilat 256,716 lekë në njësinë administrative Frashër)
- subjekteve që tregtojnë karburante 3,200,000 lekë dhe 100,000 lekë gjoba të llogaritura
- dhënies me qira të apartamenteve sociale 1,639,500 lekë

Vlerat janë mbajtur jashtë bilancit nga drejtoria e financës dhe e drejtorive përkatëse të taksave në regjistrat e tyre progresivisht.

OSHEE vazhdon vendosjen në faturën mujore të energjisë elektrike vlerën e tarifës së shërbimit të televizorit prej 100 lekë/muaj, në kontratat për ndriçim publik të rrugëve të qytetit edhe pse Bashkia Përmet i ka bërë kërkesë.

Titulli i gjetjes nr. 9:	Mbi kontabilizimin e debitorëve të taksave, llogaria 468 ñDebitorë të ndryshëmò
Situata:	Më datë 31.12.2020 balanca e llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò rezulton në vlerën 33,198,811 lekë për penalitete dhe kamatëvonesa. Në asnjë rast nuk janë evidentuar në llogaritë analitike, si për vitin 2018, 2019 dhe 2020, debitorët për taksat dhe tarifat vendore, tokën bujqësore, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, subjekteve që tregtojnë karburante dhe dhënies me qira të apartamenteve. Nga rakordimi me zyrën e Taksave dhe Tarifave të bashkisë Përmet, janë evidentuar detyrimet për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Pra nuk është pasqyruar vlera e saktë në llogarinë 468 ñDebitorë të ndryshëmò dhe kundër partinë Klasa 7 e llogarive ñTë ardhuratò, për rrjedhojë nuk janë njohur si të ardhura për vitin 2020, në vlerën 32,823,572 lekë. Nuk janë kryer kontabilizimet në lidhje me vlerën e: -debitorëve familjarë për taksën e ndërtesës dhe taksën e shërbimit 6,697,803 lekë; -debitorëve nga bizneset për taksat dhe tarifat vendore 14,022,894 lekë dhe 1,897,248 lekë; -taksës së ndikimit në infrastrukturë 258,481 lekë; -tokës bujqësore 5,007,646 lekë subjekteve që tregtojnë karburante 3,200,000 lekë dhe 100,000 lekë, gjoba të llogaritura dhënien me qira të apartamenteve sociale 1,639,500 lekë Vlerat janë mbajtur jashtë bilancit nga Drejtoria e Financës dhe e drejtorive përkatëse të taksave në regjistrat e tyre progresivisht. OSHEE, vazhdon vendosjen në faturën mujore të energjisë elektrike vlerën e tarifës së shërbimit të televizorit prej 100 lekë/muaj, në kontratat për ndriçim publik të rrugëve të qytetit edhe pse bashkia Përmet i ka bërë kërkesë, për heqjen e kësaj tarife.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 6; ku citohet: ñKontabiliteti i të drejtave dhe detyrimeve përbëhet nga: Llogaritë e klientëve dhe debitorëve të ndryshëm. Llogaritë e furnitorëve e kreditorëve të ndryshëm. Të drejtat. Funksionimi i llogarive të të drejtave 411, 468 e të tjera, në rastet e përdorimit të tyre në sektorin publik debitohen (në rastin e konstatimeve), në kredi të llogarive respektive të klasës 7 dhe klasës 1 (116). Detyrimet. Kreditohen llogaritë (401/404 e 467), në debi të llogarive përkatëse të klasës 6 dhe 23 (në rastin e konstatimeve). Funksionimi kontabël sipas rasteve në mënyrë të përmbledhur është si më poshtë: a) Konstatohet e arkëtohen të ardhurat: - Debitohet 411, 468 e të tjera me analiza (rasti i konstatimit); Debitohet 520, 512, 531 e të tjera financiare (për rastet e arkëtimeve

	direkte); - Kreditohet klasa 7 me analiza; Kreditohet 466 me analiza (kur bëhet fjalë për mjetet në ruajtje). b) Arkëtohen të drejta të konstatuara: - Debitohet klasa 5 (512,520), llogaritë financiare me analiza; - Kreditohet 411, 468, 466 e të tjera me analiza. c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale: - Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse); - Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë; - Kreditohet klasa 5 llogaritë financiare (kur paguhet menjëherë)ò
Ndikimi/Efekti:	Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformimi i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të taksave dhe tarifave të arkëtueshme paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatim i Ligjit 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò neni 6; të nenit 10 dhe 11, të Ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga bashkia Përmet, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò duke e debituar për vlerën 32,823,572 lekë. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 ñRezultat i mbartur i seksionit të funksionimitò të vitit në vazhdim.

Titulli i Gjetjes nr. 10:	Mbi kontabilizimin e llogarisë 26 ñ*Aktivet Afatgjata Financiare*ò
Situata:	Duke ju referuar Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò, Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018, ñPër Proçedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeñ grupi auditues konstatoi se në Aktivet Afatgjata Financiare, llogaria 26 ñPjesëmarrja me kapitalin e vetò është në vlerën 0 lekë, e cila duhet të përfaqësonte vlerën e aksioneve që ka ñU. K. Përmetò Sha, nuk është përcaktuar vlera, dhe nuk është përditësuar pasi është krijuar ndërmarrje ñU. K. Përmetò Sha, bashkia Përmet i vendosi në dispozicion grupit auditues Vendimin e gjyqtarit të vetëm më 02.04.99 ñPër miratimin e ekspertit kontabëlò, i cili do bënte dhe vlerësimin e kapitalit kontabël sipas Ligjit 8237, datë 1.09.1997 ñPër disa ndryshime në Ligjin nr. 7926, datë 20.04.1995 ñPër transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtareò, ndryshuar dhe me akte të tjera ligjore, i cili vlerësoi kapitalin themeltar të shoqërisë 66,315,000, nga kjo vlera e truallit është 5,590,928 lekë, numri i aksioneve është 66,315 dhe vlera nominale e aksionit është 1000 lekë.
Kriteri:	Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Urdhri i Ministrit nr. 64, datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr.14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò
Ndikimi/Efekti:	Mos përditësimi i vlerës së saktë të aksioneve të UKK Sha dhe të regjistrimit të saj në kontabilitet për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2020 të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò
Shkaku:	Mos zbatim i Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Urdhrit nr.64, datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr.5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeò dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 ñInvestime në Pjesëmarrjeò.

Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga bashkia Përmet, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të përditësuar në kontabilitet dhe për të regjistruar pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të U. K. Përmet sh.a me vlerë kontabël **0 lekë** në debi të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Fondet e shpenzuara nga njësia vendore për shkak të situatës Covid 2019, miratimi i këtyre fondeve sipas kuadrit rregullator në fuqi.

Baza Ligjore

Ligji nr. 45/2019 ñPër mbrojtjen civileò

Ligji nr. 15/2016 ñPër parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektiveò

VKM nr. 236, datë 19.03.2020 ñPër marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë në kushtet e epidemisë të shkaktuar nga Covidi- 19

Ngritja e grupit të punës për shpërndarjen e paketave në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19:

- Me Urdhër nr. 137/1 prot., datë 16.04.2020, është ngritur grupi i punës për shpërndarjen e ndihmave tek familjet në nevojë. Grupi i punës: Administratorët sipas Njësive Administrative, E. M., A. K., E. S. dhe K. I.

Me fondet e Bashkisë Përmet janë kryer ñBlerje për materiale dezinfektimi dhe veshje mbrojtëseò në vlerën 466,800 lekë me Tvsh si dhe ñPaketa ushqimore dhe detergjentò, në vlerën 854,400 lekë me Tvsh. Këto materiale, veshje dhe paketa ushqimore janë bërë hyrje në magazinën e Bashkisë Përmet dhe janë bërë dalje grupeve të punës që ishin ngarkuar për shpërndarjen e pakove ushqimore sipas zonave bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar.

Hyrjet dhe daljet e pakove ushqimore:

	Urdhër Shpenzim		**Fletë Hyrje**		**Përshkrimi**		
Nr.	**Nr.**	**Date**	**Nr.**	**Datë**	**Njësi**	**Sasi**	**Vlerë**
1	320	24.04.2020	17	27.03.2020	Blerje për materiale dezinfektimi dhe veshje mbrojtëse		466,800
2	346	29.04.2020	19	19.04.2020	Paketa ushqimore dhe detergjent	300	854,400
					1,321,200		

Vendim i Këshillit Bashkiak Përmet nr. 10, datë 10.03.2020, ñPër miratimin e fondit që do të përdoret për përballimin e situatës emergjente të krijuar nga përhapja e sëmundjes akute të frymëmarrjes Covid-19ò

Verifikim i ligjshmërisë së akteve të depozituara te Prefekti i Qarkut,me nr. 301/1 prot.,datë 17.03.2020 1. Urdhër Shpenzimi nr. 320, 49ate 24.04.2020 në vlerën 466,800 lekë

Urdhër Prokurimi nr. 139, datë 19.03.2020, me vlerë të vogël, ñPër blerjen e materialeve të dezinfektimit dhe veshjeve mbrojtëseò

- Ftesë për ofertë, data e zhvillimit në datën 24.03.2020, ora 09:00, në adresën www.app.gov.al
- ñS. Rr.ò (person fizik) është shpallur fitues me ofertën ekonomike me vlerë 389,000 lekë pa Tvsh, dhe 466,800 lekë me Tvsh.
- Fatura tatimore, me nr. 42 dhe nr. Serial 85466093, 49ate 27.03.2020,
- Me nr. 17, 49ate27.03.2020, është bërë Fletë- hyrje në magazinën e bashkisë Përmet
- Me nr. 42, fature, 49ate 27.03.2020, është mbajtur proçes verbali në magazinën e bashkisë Përmet (komisioni i pritjes se mallit K. G., M. S., D. L.)

Vendim i Këshillit Bashkiak Përmet nr. 15, datë 31.03.2020, ñPër miratimin e fondit që do të përdoret për përballimin e situatave emergjente të krijuar nga përhapja e sëmundjes akute të frymëmarrjes Covid-19ò

Urdhër Shpenzimi nr. 346, datë 29.04.2020 në vlerën 854,400 lekë

Urdhër Prokurimi nr. 150, datë 09.04.2020, me vlerë të vogël, ñPër blerjen e paketave ushqimore dhe detergjenteve për familjet në nevojë në kushtet e fatkeqësisë natyroreò

- Ftesë për ofertë, në datën 09.04.2020, nr. 842, data e zhvillimit 14.04.2020, ora 09:00, në adresën wwwapp.gov.al;
- ñA. K.ò (person fizik) është shpallur fitues me ofertën ekonomike me vlerë 712,000 lekë pa Tvsh, dhe 854,400 lekë me Tvsh
- Fatura tatimore, më datë 16.04.2020, me nr. 42 fature dhe nr. serial 78275442
- Më 16.04.2020, me nr. 19 është bërë Fletë- hyrje në magazinën e bashkisë Përmet
- Më 16.04.2020, me nr. 42 fature është mbajtur proces verbali në magazinën e bashkisë Përmet (Komisioni i pritjes se mallit në magazinë K. G., M. S., D. L.)

Grupi i auditimit përzgjodhi disa nga deklaratat për tërheqjen e paketave, të datës 28.04.2020 të cilat ishin të firmosura nga përfituesi dhe 2 nga anëtarët e komisionit.

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike

- Ligji nr. 10 296, datë 8.7.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò
- Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit përputhje me objektivat e miratuara nga titullari, të pyetësorëve të vetëvlerësimit të komponentëve

2.3 Mbi zbatimin e kërkesave të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, për periudhën 01.01.2018-31.12.2020.

1-*Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.*

Në bashkinë Përmet, u audituan zbatimi i procedurave të prokurimit të kryera bazuar në aktet ligjore e nënligjore të prokurimit publik që kanë lidhje me objektet e prokurimit, sipas çështjeve të trajtuara.Nga ana e Autoritetit Kontraktore (këtu e vijim AK), janë respektuar afatet ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e regjistrit vjetor të parashikimeve për prokurimet, në përputhje me formën dhe mënyrën, që është parashikuar në udhëzimet e APP-së. Shtesat dhe ndryshimet e bëra në regjistrat e parashikimeve të prokurimeve nuk janë botuar, në formë elektronike, në faqen e app.gov.al.

Për periudhën objekt auditimi (01.01.2018 ï 31.12.2020), nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat e sektorëve përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e studimit të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, si dhe në përputhje midis parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB.

Realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB, respektivisht për vitin 2018 me VKB nr. 4, datë 18.01.2018, për vitin 2019 me VKB nr. 8, datë 04.02.2019 dhe për vitin 2020 me VKB nr. 111, datë 31.12.2019.

Pasqyrat, të dhëna dhe likujdimet e prokurimeve të realizuar gjatë periudhës objekt auditimi (01.01.2018 ï 31.12.2020), paraqitet në pasqyrën Aneks C/1, 2 dhe 3 bashkëlidhur materialit.

2-*Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetuara.*

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në Sistemin e Prokurimit

Elektronik (SPE) marrë nga sistemi i APP, konstatoi shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*

PROKURIMET 2018

Për vitin 2018: Bashkia Përmet ka zhvilluar gjithesej 11 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 222,145,475.60 lekë me Tvsh, vlerë të kontratës 213,049,988.10 lekë me Tvsh, diferencë midis tyre prej 9,095,487.50 lekë Tvsh.

Kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit 23 (gjithsej) OE dhe janë skualifikuar 11

- ñNegocim me/pa shpalljeò, nuk ka zhvilluar procedura prokurimi.

-ñKërkesë për propozimò, 8 procedura, me fondin limit në total prej 34,163,847 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 31,181,438.50 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 2,982,408.50 lekë pa Tvsh.

- ñTender i Hapurò, 2 procedura, me fondin limit në total prej 151,761,318 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej 147,599,084.37 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej lekë 4,162,233.63 pa Tvsh ose në masën 2.7 % të fondit limit.

-ñBlerje me vlerë të vogëlò, 15 procedura, me fondin limit në total prej 6,441,045 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 3,159,535 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 3,281,510 lekë pa Tvsh;

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 ï 31.12.2018 nga subjekti bashkia Përmet, janë zhvilluar gjithsej 11 procedura prokurime me vlera të larta, si vijon:

EMËRTIMI	VLERA 000/Lekë	Në %ndaj fondit
Fonde të prokuruar gjithsej	222,145,475.60	
Nga të cilat		
- Në fushën e punëve publike	208,423,280.60	94 %
- Në fushën e shërbimeve/blerjeve	13,722,195	6 %
Financime nga Bashkia/Grande	107,998,755	49 %
Financim nga FZHR	105,051,230	47 %
Financim me grande specifike	0	

PROKURIMET 2019

Për vitin 2019: Bashkia Përmet ka zhvilluar gjithesej 9 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 62,602,815.60 lekë me Tvsh, vlerë të kontratës 56,530,063 lekë me Tvsh, diferencë midis tyre prej 5,174,532 lekë Tvsh.

Kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit 28 (gjithesej) OE dhe BOE janë skualifikuar 19

-ñNegocim me/pa shpalljeò, nuk ka zhvilluar procedura prokurimi.

-ñKërkesë për propozimò, 8 procedura, me fondin limit në total prej 33,253,289 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 31,403,613 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 1,849,676 lekë pa Tvsh.

- ñTender i Hapurò, 1 procedura, me fondin limit në total prej 18,915,724 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej 16,453,290 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej lekë 2,462,434 pa Tvsh ose në masën 13 % të fondit limit.

-ñBlerje me vlerë të vogëlò, 17 procedura, me fondin limit në total prej 7,772,611 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 5,609,687 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 2,162,924 lekë pa Tvsh;

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2019 ï 31.12.2019, nga subjekti bashkia Përmet, janë zhvilluar gjithsej 9 procedura prokurime me vlera të larta,si vijon:

EMËRTIMI	VLERA 000/Lekë	Në %ndaj fondit
Fonde të prokuruar gjithsej	62,602,815.60	91 %
Nga të cilat		
- Në fushën e punëve publike	44,335,752	71 %
-Në fushën e shërbimeve/blerjeve	18,267,063.60	29 %
Financime nga Bashkia/Grande	15,244,090	24%

Financim nga FZHR	41,285,973	66 %
Financim me grande specifike		

PROKURIMET 2020

Për vitin 2020: Bashkia Përmet ka zhvilluar gjithesej 9 procedura prokurimi me vlera të larta, me vlerë të fondit limit 147,085,668 lekë me Tvsh, vlerë të kontratës 145,240,127.76 lekë me Tvsh, diferencë midis tyre prej 1,845,540.24 lekë me Tvsh.

Kanë marrë pjesë në procedurat e prokurimit 18 (gjithesej) OE dhe BOE janë skualifikuar 9

-ñNegocim me/pa shpalljeò, nuk ka zhvilluar procedura prokurimi.

-ñKërkesë për propozimò, 6 procedura, me fondin limit në total prej 13,393,603 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 12,432,133.55 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 961,469.45 lekë pa Tvsh.

- ñTender i Hapurò, 3 procedura, me fondin limit në total prej 109,956,954 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura pa Tvsh në total prej 109,370,540.2 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej lekë 586,413.80 pa Tvsh ose në masën 0.5 % të fondit limit.

-ñBlerje me vlerë të vogëlò, 24 procedura, me fondin limit në total prej 11,722,825.10 lekë pa Tvsh, kontrata të lidhura në total prej 10,105,604.10 lekë pa Tvsh, duke kursyer shumën prej 1,617,221 lekë pa Tvsh;

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2020 ï 31.12.2020, nga subjekti bashkia Përmet, janë zhvilluar gjithsej 9 procedura prokurime me vlera të larta si vijon:

EMËRTIMI	**VLERA000/Lekë**	**Në % ndaj fondit**
Fonde të prokuruar gjithsej	147,085,668	99%
Nga të cilat		
- Në fushën e ndërtimit	123,672,646.70	85%
-Në fushën e shërbimeve/blerjeve	22,372,549	15%
Financime nga Bashkia/Grande	12,170,195	8%
Financim nga FZHR	133,069.932.80	91%
Financim me grande specifike		

3. *Auditim mbi saktësinë e realizimit të procedurave të prokurimit (vlerësimi i kritereve, fondi limit, vlerësimi i ofertave dhe shpallja e fituesit).*

Referuar të dhënave të regjistrit të realizimit të prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2018 ï 31.12.2020, konstatohet se janë kryer gjithsej 29 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit prej 431,833,959.20 lekë me Tvsh, duke lidhur kontratë për vlerën 414,820,178.86 lekë me Tvsh ose me një zbritje nga fondi limit prej 4 % e fondit të prokuruar.

Mbi bazën e të dhënave të materialitetit dhe riskut të llogaritur të fondeve të prokuruar për periudhën 01.01.2018 ï 31.12.2020 (llog. 602/231), grupi i auditimit janë audituar nga 4 procedura pasi një prokurim është anuluarme vlerë kontrate 91,218,363.418 lekë me Tvsh, ose 22 % e totalit të kontratave.

Në procedurat e zhvilluara kanë marrë pjesë 69 OE/BOE dhe janë skualifikuar 39 OE/BOE.

Nga auditimin i **4** procedurave me vlerë kontrate **91,218 mijë lekë me Tvsh**, u konstatua shkelje të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 2 ñ*Parimet e përzgjedhjes*ò shkronja (a), (b) dhe (c), dhe me nenet 46, 53 dhe 55, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, ku;

Nga auditimi i procedurave të prokurimit për periudhën objekt auditimi (01.01.2018 deri më datë 31.12.2020), janë konstatuar shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të LPP, të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si vijon:

a. Asnjë nga anëtarët pjesëmarrës në procedurën e prokurimit (Njësisa e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave) nuk kanë kryer

trajnime për zhvillimin e procedurave të prokurimit, në kundërshtim me pikën 2, neni 61 të VKM r. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò e ndryshuar.
b. Në të gjitha rastet e audituara, procesverbalet/raporti përmbledhës dhe DT, nuk janë Protokolluar në Protokollin e Bashkisë Përmet, veprime në kundërshtim me nenin 18, ñ*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*ò**;**
c. Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit; ñRikonstruksioni i shkollës 9 vjeçare Sami Frashëriò, rezulton se: DT dhe Shtojca për ndryshimet në DT nuk janë nënshkruar nga të tre anëtarët e Njësisë së Prokurimit.Veprime këto në kundërshtim me VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 61, pika 1, ñ*Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit*ò.
d. Në dy procedura prokurimi janë shpallur fitues e OE/BOE të cilat nuk plotësonin kriteret e DT, kualifikim në kundërshtim me kërkesat ligjore, me pasojë përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën e kontratës **82,406 mijë lekë me Tvsh**.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik",* neni 2, *neni 46, neni 53, neni 55,si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 58, neni 61, pika 2, neni 66, neni 67, neni 74.*
e. Nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Përmet në një rast nuk janë analizuar shkaqet e që kanë shkaktuar dështimin/anulimin e procedurës dhe nuk ka dokumentuar dhe korrigjuar mangësitë në mënyrë që të bëhej e mundur rritjen e konkurencës.
Veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 73, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò *Autoriteti kontraktor, përpara se të fillojë një procedurë të re, analizon shkaqet që shkaktuan dështimin e procedurës dhe, nëse është rasti, i korrigjon ato në mënyrë që të bëjë të mundur rritjen e konkurrencës. Ky proces dokumentohet në një procesverbal të mbajtur për këtë qëllim nga njësia e prokurimit".*
f. Në 3 procedura prokurimi, një pjesë e kritereve të veçanta të DT që lidhen me kapacitetin teknik, nuk janë të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese të vlerën dhe natyrën e kontratës, të shërbimeve dhe blerjes së mallrave, si dhe nuk janë argumentuar me procesverbal të veçantë, veprime të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve.ô
Veprime në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñ*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, të ndryshuar, neni 61, Kreun X ñ*Shqyrtimi i ankesave*ò, neni 78 ñ*Ankesat ne autoritetin kontraktor*ò; Nenet 45, 46 dhe 55 të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar; VKM nr. 42, datë 16.01.2008 *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi",* dhe ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, *"Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit"*, i ndryshuar, neni 6.

1/1. Tender i zhvilluar me objekt**: "*Rikonstruksion i Shkollës së mesme Naim Frashëri", Bashkia Përmet, me këto të dhëna:***
Fondi limit:72,310,465 *(shtatëdhjetë e dy milion e treqind e dhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa Tvsh;*
Burimi i Financimit:Vënë në dispozicion në zbatim të Vendimit të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve nr. 7, datë 11.05.2017, *"Për Shpërndarjen e Financimit për Projekte të Reja",* Thirrja I, për vitin 2018, financimit për projekte të grantit òArsimò, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve, dhe fondet e buxhetit të bashkisë Permet për vitet 2018 -2019 në masën 10% të vlerës së plotë të bashkëfinancimi të projektit .
Financimi eshte ndare ne dy vite 2018-2019 .

Vlera e financimit nga FZHR-ja për vitin **2018-2019** është 85,807,834 lekë me Tvsh
Vlera e financimit nga FZHR-ja për vitin 2018 është 30,890,820 lekë me Tvsh
Vlera e bashkëfinancimit nga NJQV-re për vitin **2018-2019** është 8,580,783 lekë me Tvsh
Vlera e bashkëfinancimit nga NJQV-re për vitin 2018 është 4,290,392 lekë me Tvsh
Buxheti i Shtetit & Buxheti i Bashkisë Përmet;
Numri i referencës së procedurës: REF-**92008-10-30-2**

<table>
<tr><td>Urdhër prokurimi: nr. 248, datë 30.10.2018</td><td rowspan="4">Njësia e hartimit të DT,
nr. 738 datë 28.03.2019
L. M. - Jurist
E. M. ï P/Zyre Uraban
B. Z.- Financiere</td><td rowspan="4">KVO Urdhër nr. 249 datë 30.10.2018
Ll. Th. Kryetar
F. L. ï Anëtar
Th. K.</td></tr>
<tr><td>Lloji i procedurës: E hapur</td></tr>
<tr><td>Fondi limit:72,310,465lekë (pa Tvsh)</td></tr>
<tr><td>Burimi i financimit të ardhurat: FZHR&Bashkia Përmet</td></tr>
<tr><td>Marrin pjesë OE:11</td><td rowspan="2">OE fitues: “A. K.” Shpk</td><td rowspan="2">Miratimi i procedurës nr.</td></tr>
<tr><td>S`kualifikuar OE: 7</td></tr>
<tr><td>Ankimime për DT: 3 në AK</td><td>Vlera e fituar 68,672,247.365lekë</td><td>Kontrata nr</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Data e hapjes se tenderit 26.12.2018</td><td rowspan="2">Diferenca nga fondi limit 4,638,217.635lekë pa Tvsh</td><td rowspan="2">Vlera e kontratës 68,672,247.365lekë pa Tvsh</td></tr>
<tr><td colspan="2">Ankimime për vlerësim ka</td></tr>
<tr><td colspan="2">Titullari i AK: N. Sh.</td><td colspan="2">Afati 8 muaj nga lidhja e kontratës</td></tr>
</table>

Përllogaritja e fondit limit: në shumën 72,310,465 lekë pa Tvsh.
- Me Urdhrin nr. 247, datë 30.10.2018 *“Për hartimin e preventivit të punimeve dhe përllogaritjen e fondit limit, sepcifikimet teknike”,* është ngarkuar Zyra Urbanistikës, konkretisht Ark. E. M.
Përllogaritja e fondit limit e shprehur sipas procesverbalit të NJP është e bazuar në preventivin e objektit, zërat e punimeve të cilat janë llogaritur duke përdorur çmimet e manualit teknik të miratuara me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 *“Për Miratimin e manuleve teknike te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”,*
Dokumentet e tenderit
- Njësia e Prokurimit ka hartuar *“Procesvebali i justifikimit të kritereve nga antarët e NjP”* në datë 30.10.2018, në zbatim të Urdhërit të Prokurimit, për realizimin e prokurimit me objekt*: “Rikonstruksion i shkollës së mesme Sami Frashëri”,* miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. N. Sh.
- Njoftimi i kontratës është publikuar në Buletinin e APP me nr 44, datë 05 Nëntor 2018 në faqet17-18/426.
Në DT janë kërkuar:
Nga Kordinimi APP (elektonikisht në SPE) në datë 31 10.2018, është njoftuar AK, bashkia Përmet: për problematikat e konstatuara nga APP, në kuadër të monitorimeve të kryera prej saj, lidhur me hartimin e kritereve të pranimit, në dokumentet e këtij tenderi në SPE ndër të tjera janë konstatuar se:
1. Në preventivin e punimeve, pjesë e dokumenteve te tenderit, në zërat e punimeve elektrike AK ka përdorur emërtim të markës"Gewis".
Është sjell në vëmendje të AK se në nenin 23/5 të LPP parashikohet që: ñ*Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekzistonnjë mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht qe fjalët.*
Për rrjedhim të sa më lart edhe të faktit se ekzistojnë mundësitë e përshkrimit/emërtimit të pajisjes/mallit, AK duhet të eleminojë përdorimin e markave ose ti shoqëroja ato me shprehjen "ose" ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime "ekuivalent”.

Gjithashtu nga një vështrim i përgjithshëm të kritereve për kualifikim, me qëllim zbatimin e parashikimeve të nenit 46 të LPP, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe legjislacioneve të zbatueshme për fushat ku procedura shtrin veprimin e saj, APP ka sjell në vëmendje nevojën për argumentim ose/dhe saktësim të kritereve.

Ankesa për DT:

- Formulari i ankesës për DT paraqitur te AK me nr. 2778 Prot., datë 05.11.2018, nga OE ñA. N.ò Shpk.
- Formulari i ankesës për DT paraqitur te AK me nr. 2777 Prot., datë 06.11.2018, nga OE ñP. V.ò Shpk.

-Me Vendimin nr. 258 e nr.2784 Prot., datë 06.11.2018 òPër pezullimin e procedurës së prokurimit dhe për shqyrtimin e ankesësò nga Titullari i AK z. N. Sh. është ngritur Komisioni për Shqyrtimin e Ankesës i përbër nga: z. Ll. Th., z. F. L. e z. Th. K.

- Në datë 12.11.2018, KSHA i ka drejtuar vendimet për shqyrtimin e ankesave të sipërcituar, të miratuara nga Titullari i AK, ku është shprehur se Titullari i Autoritetit Kontraktor duhet të pranojë vetëm rekomandimet e APP.

Titullari i Ak z. N. Sh. me nr. 2847 e nr. 2848 Prot., datë 12.11.2018 i ka kthyer përgjigje për ankesat respektivisht OE ñP. V.ò Shpk dhe OE ñA. N.ò Shpk.

Në datë 12.11.2018, NJP ka njoftuar: Modifikim dhe sqarime në DT me objekt:òRikonstruksion i shkollës së mesme òSami Frasheriò Përmet.

AK Bashkia Përmet, në mbështetje të nenit 42 pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñ*Për Prokurimin Publik"*i ndryshuar, neni 62 të VKM nr. 914, datë 29.12.*2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*i ndryshuar në bazë të rekomandimeve të APP të bëjë ndryshime në DT përmes hartimit të një shtojce e cila u është komunikuar të gjithë OE në rrugë elektronike duke u bërë e detyrueshme për to.

Te Kapaciteti Teknik	
Ishte:	**Bëhet:**
Pika 2.2.3 a. Operatori/ët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në licencën e shoqëris drejtuesit teknik si më poshtë: 1 (një) inxhinier ndërtimi; 1 (një) inxhinier topograf 1 (një) inxhinier hidroteknik; 1 (një) inxhinier mekanik; 1 (një) inxhinier elektrik; 1 (një) inxhinier mjedisi Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listepagesën e shoqërise për periudhën Janar 2018-Shtator 2018 . Për secilin duhet të paraqiten: Å Kontrate pune e noterizuar Å Diploma	Pika 2.2.3 a.Operatori/ët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në licencën e shoqëris drejtuesit teknik si më poshtë: 1 (një) inxhinier ndërtimi; 1 (një) inxhinier topograf 1 (një) inxhinier mekanik; 1 (një) inxhinier elektrik; 1 (një) inxhinier mjedisi Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në licensën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për periudhën Janar 2018-Shtator 2018 . Për secilin duhet të paraqiten: Å Kontratë pune e noterizuar Å Diploma
Ishte:	**Bëhet:**
Pika 2.2.3 e. Operatori/ët ekonomike duhet të kenë një punësim mesatar i të paktën 70 (shtatëdhjetë) personave për periudhën Janar 2018-Shtator 2018, të vërtetuar me: ÅVërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Janar 2018-Shtator 2018 ÅListë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2018-Shtator 2018.	Pika 2.2.3 e.Operatori/et ekonomike duhet te kenë një punësim mesatar i të paktën 50 (pesedhjete) personave per periudhen Janar 2018-Shtator 2018, të vërtetuar me: ÅVërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën Janar 2018-Shtator 2018 ÅListë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën Janar 2018-Shtator 2018.
Hapja e Ofertave Ishte:	**Hapja e Ofertave Bëhet:**

30.11.2018; ora 09:00	05.12.2018; ora 09:00

Nisur nga ky fakt NjP në mbështetje të nenit 42, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"* i *ndryshuar*, Kreu VII neni 62 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, vendos zgjatjen e afatit kohor të dorzimit të ofertave edhe me 5 (pesë) ditë kalendarike.

-Me Urdhrin nr. 264 e nr. 2854 Prot., datë 12.11.2018 *"Për heqjen e pezullimin të procedurës së prokurimit"* nga Titullari i AK z. N. Sh. pasi janë ngarkuar në SPE ndryshimet në DT. Për zbatimin e urdhërit është ngarkuar NjP.

Konstatohet që: Shtojca është nënshkruar vetëm nga z. L. M.

Në DT deri te Shtojca 16 janë nënshkruar nga tre anëtarët e NJP, nga shtojca 16 deri në Seksioni III Përshkrimi i Ankesës e vetëm nga një anëtar i NjP, në vijim nga asnjë anëtar i NJP DT nuk janë nënshkruar.

Titulli i Gjetjes 11:	Moszbatimi i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik, në zhvillimin/dokumentimin e procedurës së prokurimit
Situata:	Në të gjitha rastet e audituara, procesverbalet/raporti përmbledhës dhe DT, nuk janë Protokolluar në zyrtarisht në Bashkinë Përmet. DT dhe shtojca për ndryshimin e DT nuk janë nënshkruar nga anëtarët e NJP. Nga Autoriteti Kontraktor nuk janë nënshkruar/firmosur DT dhe Shtojca për ndryshimet në DT nga të gjithë anëtarët e NjP, dhe nuk është proktokolluar gjithë dokumentacioni që përshkruan pocedurën e prokurimit publik. Vendimin nr. 4, datë 19.6.2017 ñPër miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisëò, neni 18, ñ*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*ò;
Kriteri:	Veprime në kundërshtim me kuadrin ligjor për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik ligjore gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Vendimin nr. 4, datë 19.6.2017 ñPër miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisëò, neni 18, ñ*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*ò; Nga auditimi i dosjes fizike të procedurës së prokurimit rezulton se: DT dhe Shtojca për ndryshimet në DT nuk janë nënshkruar nga të tre anëtarët e Njësisë së Prokurimit.
Impakti:	Moszbatimi i zhvillimi i procedurave në përputhje me Vendimin nr. 4, datë 19.6.2017 ñPër miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisëò, neni 18, ñ*Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë*ò;
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit ligjor nga Titullarit i AK dhe anëtarëve të NJP.
Rëndësia:	**E lartë**
Rekomandim:	Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe Njësia e Prokurimit në çdo rast në zhvillimin e procedurave të prokurimit duhet të zbatojë kuadrin ligjor duke përshkruar procedurën e prokurimit publik në të gjithë fazat e realizimit.

Mbi observacionet e paraqitura nga Bashkia Përmet për Projekt Raportin

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 3561/1 prot., datë 21.12.2021 dërguar në e-mailin zyrtar ngaAnëtarët e Njësisë së Prokurimit: z. L. M., z. E. M. dhe znj. B. Z., për prokurimin me objekt: *"Rikonstruksion i shkollës së mesme "Sami Frashëri", Bashkia Përmet,* ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Grupi i auditimit ka konstatuar se:
Procesverbalet/raportet përmbledhëse dhe DT, nuk janë protokolluar zyrtarisht, në Bashkinë Përmet, DT dhe shtojca për ndryshimin e DT nuk janë nënshkruar nga antarët e NJP. Vendimi nr. 4 datë 19.06.2017 ñPër miratimin e rregullores së njesuar të punës me dokumentat në autrritetin publik të Republikës së Shqipërisëò neni 18."Normat teknike-profesionale dhe metodologike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë"

Lidhur me pretendimin e grupit të audituesve se procesverbalet, raportet përmbledhëse dhe DT nuk janë protokolluar zyrtarisht në Bashkine Përmet nuk jemi dakort me arsyetimin e mëproshtëm:
Në mbështetje të Ligit nr. 9154, datë 06.11.2003 ñPër akivatò, Vendimi nr. 4, datë 19.06.2017 ñPër miratimin e rregullores së njesuar të punës me dokumentat në autoritetin publik te Republikes së Shqipërisëò, ñNormat tekniki-profesionale dhe metodologike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisëò i gjithë dokumentacioni që ka qënë pjesë e prokurimit publik me objekt: ñ*Rikonstruksion i shkollës së mesme "Sami Frashëri*ò, është dorzuar në zyrën e protokollit të *Bashkia Përmet,* me flete inventari të dosjes dhe është arkivuar në përputhje me legjislaconin e sipërpermendur.
Vendimi nr. 4, datë 19.06.2017 ñPër miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentat në autoritetin publik të Republikës së Shqipdrisë" dhe ligi nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" nuk shprehen se procesverbalet, DT dhe raporti përmbledhës duhet të marrin numër protokolli.
Dokumentat e tenderit dhe shtojca për ndryshimin e DT nuk është firosur nga të giithë antarët e NJP,
Lidhur me pretendimin e grupit të auditimit nuk jemi dakort pasi dokumentat e tenderit janë firmosur nga tre antarët e NJP si dhe shtojca për ndryshimin e dokumentave të tenderit. Bashkëlidhur këtij obsevacioni do të gjeni dokumentacionin e mëposhtëm:
1- Inventarizimi i procedurës së prokurimit në zyrën e protokollit të Bashkisë Përmet.
2- Shtojcën për zbatimin e rekomandimeve të APP-së i firmosur nga të tre antardt e NJP

Qëndrimi i Audituesve të KLSH:
Në lidhje me pretendimet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:
Nga grupi i auditimit është evidentuar në Akt Konstatim, sqaruar edhe Projektraport mangësi në lidhje me ekstremitetet e shkresave zyrtare (gjurmë auditimi) në zhvillimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar, të konstatura gjatë auditimit të dosjes së prokurimit. Nuk është përmendur askund ñdosja e prokurimit është e pa arkivuarò.
Në observacionin e Aktkonstatimit jeni shprehur:
ñé é *.Përsa i përket faktit se DT nuk janë firmosur deri në fund nga antarët e njësisë se prokurimit por deri te shtojca 16 e tyre, ka qënë për faktin se DT kanë qenë shumë voluminoze por kjo nuk do të thote se ata nuk kanë qënë dakort për firmosjen e DT deri në fund të tyre. Bashkëlidhur këtij observacioni po ju dërgojmë edhe shtojcën për ndryshimet e kritereve të tenderit në bazë të rekomandimeve të APP-së, të firmosura nga të tre anëtarët e NJP."*
Grupi i auditimit disponon gjithë dokumentacionin (fotokopje) të dosjes së auditimit, të cilit i referohet. Për arsye volumi po ju paraqesim vetëm ñshtojcënò që ju keni paraqitur në observacion me nënshkrimin e tre anëtarëve të NjP.
Në asnjë rast grupi i auditimit nuk mund të shprehet për dokumentacion që nuk është paraqitur gjatë procesit të auditimit, ñ*shtojca për ndryshimet e kritereve të tenderit në bazë të rekomandimeve të APP-së",* që i është paraqitur grupit të auditimit është e nënshkruar vetëm nga z. L. M.
Pretendimet dhe komentet nuk merren në konsideratë .

Me shkresën nr. 3269 Prot., datë 24.12.2018, Titullari i AK z. N. Sh. u ka dërguar Drejtorive Rajonale Tatimore ñ*Kërkesë për informacion në lidhje me procedurën e prokurimit të AK Përmet"*
- Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, informacion për:
1. OE ñB. Bò Shpk *(nëse drejtuesi teknik, të licencës së kësaj shoqëri, për 5 pesë punonjës të listuar, të cilët figurojnë në listëpagesat e kësaj shoqëria, a figuron dhe në shoqëri të tjera, apo subjekt publik i punësuar?).*

2. OE ñK.ò Shpk *(nëse drejtuesi teknik, të licencës së kësaj shoqëri, për 2 dy punonjës të listuar, të cilët figurojnë në listëpagesat e kësaj shoqëria, a figuron dhe në shoqëri të tjera, apo subjekt publik i punësuar?).*
3. OE ñN.ò Shpk *(nëse drejtuesi teknik, të licencës së kësaj shoqëri, për 5 pesë punonjës të listuar, të cilët figurojnë në listëpagesat e kësaj shoqëria, a figuron dhe në shoqëri të tjera, apo subjekt publik i punësuar?).*
4. OE ñLl.ò Shpk *(nëse drejtuesi teknik, të licencës së kësaj shoqëri, për 5 pesë punonjës të listuar, të cilët figurojnë në listëpagesat e kësaj shoqëria, a figuron dhe në shoqëri të tjera, apo subjekt publik i punësuar?).*

DPT, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë me nr.91526/1/1 Prot., datë 26.12.2018 i ka përcjell përgjigjeBashkisë Përmet:
-OE ñK.ò Shpk, punonjesi Z.M. S. me ID:1..V për periudhën e fundit është siguruar në subjektin A. M. and E. M. C. dhe Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, punonjësi z. I. K. me ID:H..H për periudhën e fundit është siguruar në subjektin ñM.òdhe në subjektin ñG.ò
- OE ñB. Bò Shpk dhe ñN.ò Shpk janë në administrim të Drejtorisë së Tatimpagueve të Mëdhenj Tiranë, dhe subjekti ñLl.ò Shpk është në administrim të DRT Fier.
DPT, Sektori i Asistencës dhe ShërbimitTiranë, me nr. 12563/1 Prot., datë 27.12.2018 i ka përcjell përgjigjeBashkisë Përmet:
- Punonjësi E. Xh., me NID H..A, është i punësuar në shoqërinë ñB. Bò Shpknga data 22.04.2014 e në vazhdim si dhe në subjektin ñE. Xh.òme nga data 19.06.2016 e në vazhdim.
- Punonjësi N. H., me NID F..Kështë i punësuar në shoqërinë ñB. Bò Shpk nga data 23.10.2015 e në vazhdim.
- Punonjësi N. N., me NID 1..Tështë i punësuar në shoqërinë ñB.Bò Shpk nga data 23.10.2015 e në vazhdim.
- Punonjësi E. I., me NID E..Mështë i punësuar në shoqërinë ñB. Bò Shpk nga data 23.10.2015 e në vazhdim.Ka qenë i punësuar dhe në BashkiaRoskovec nga data13.04.2018-02.07.2018.
- Punonjësi Z. L., me NID E..Eështë i punësuar në shoqërinë ñN.ò Shpk nga data 06.06.2017 e në vazhdim.
- Punonjësi Z. M., me NID I..Pështë i punësuar në shoqërinë ñN.ò Shpknga data 29.01.2016 e në vazhdim.Figuron i punësuar në Bashkinë eTiranës nga data 10.05.2016-12.06.2018 si edhe nga data 06.12.2018 e në vazhdim.
- Punonjësi G. D., me NID F..Tështë i punësuar në shoqërinë ñN.ò Shpk nga data 21.01.2016 e në vazhdim si dhe në shoqërinë "Gj." Shpk nga data 26.01.2018 e në vazhdim.
- Punonjësi M. M., me NID G..M është i punësuar në shoqërinë ñN.ò Shpk nga data 01.01.2012 e në vazhdim si dhe në shoqërinë ñA." Shpk nga data 22.11.2018 e në vazhdim.Ka qenë i punësuar edhe nëshoqërinë "Z." Shpk në periudhën 20.01.2016-05.11.2018.
- Punonjësi P. H., me NID E..R është i punësuar në shoqërinë ñN.ò Shpk nga data 01.01.2012 e në vazhdim.
- Punonjësi Sh. L., me NID G..B është i punësuar në shoqërinë ñN.ò Shpk nga data 01.01.2012 e në vazhdim si dhe në shoqëritë: ñB.ò Shpk nga data 07.08.2018 e në vazhdim; ñZ.ò Shpk nga data 01.08.2018, ñK.ò Shpk nga data 02.02.2018; ñY.ò Shpk, ñD.ò Shpk nga data 21.11.2018 e në vazhdim; ñC.ò Shpk nga data11.10.2018; ñA.ò Shpk nga data 04.03.2016; ñK.ò Shpk nga data 09.06.2018; ñA.ò Shpk nga data 01.07.2015 si dhe ñG. M. M.ò Shpk nga data 08.08.2018.
Hapja e Ofertave: (datë 05.12.2018)
Zhvillimi i procedurës së prokurimit: Procedura është hapur me procesverbalin e datës 09.01.2019. *"Për shtyrje të mëtejshme të afatit për vlerësimin e ofertave të procedurës së*

prokurimit….”, kanë marrë pjesë 11 (njëmbëdhjetë) Operatorë Ekonomik. KVO pasi ka shkarkuar dokumentacionin nga SPE, ka vendosur shtyrjen e procedurës së prokurimit, për vlerësim, kualifikim dhe klasifikim të ofertave deri më datë 23.01.2019.
KVO ka arsyetuar se duhen kryer verifikime të mëtejshme për shoqëritë pjesëmarrëse në këtë procedurë, pranë institucioneve përkatëse për të vërtetuar vërtetësinë e dokumentacionit për punonjësit, drejtuesit teknik të këtyre shoqërive.
-Nuk ka asnjë gjurmë auditimi që të justifikojë veprimtarinë e KVO nga data 05.12.2018 më datë 09.01.2019.
Pas përfundimit të procedurës së shqytimit dhe vlerësimit të oferatave të sipërshënuara, KVO-ja ka vlerësuar se nuk kualifikohet asnjë ofertë e paraqitur pasi nuk përmbushin kërkesat e AK në DT dhe njoftimin e kontratës për këtë procedurë prokurimi.
Për këtë vendimmarrje është njoftuar Njësia e Prokurimit për të përfunduar fazën e vlerësimit në sistem dhe për të vijuar sipas hapave që përcakton LPP e RRPP.
Proces Verbali, pasi është formuluar është nënshkruar nga anëtarët e KVO në çdo faqe.
Kanë marr pjesë në procedurë këtë 11 ofertues me vlerat ekonomike përkatëse të ofruara:
1. OE “A. K.” Shpk (me Nipt J..R) me vlerë ekonomike të ofertës **68,672,247.365***(gjashtëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e dyzetë e shtatë pikë treqin e gjashtëdhjetë e pesë)* **lekë pa Tvsh** dhe 81,490,378.838 lekë me Tvsh.
2. BOE “K.” Shpk & A. K.” Shpk(me Nipt-e respektive: K..A dhe K..F)me vlerë ekonomike të ofertës **59,506,436.83** *(peëdhjetë e nëntë million e pesëqind e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë e gjashtë pikë tetëdhjetë e tre)* **lekë pa Tvsh** dhe 71,407,724.20 lekë pa Tvsh.
3. BOE “B. B” Shpk & P. V.” Shpk (me Nipt-e respektive: K..H dhe L..C)me vlerë ekonomike të ofertës **59,748,245** *(pesëdhjetë e nëntë million e shtatëëqind e dyzetë e tetë mijë e dyqind dyzetë e pesë)* **lekë pa Tvsh** dhe 71,121.747 lekë me Tvsh.
4. BOE “S.” Shpk& “E. C. C.” Shpk, (me Nipt-e respektive: J..M dhe K82230002K) me vlerë ekonomike të ofertës **49,504,319** *(dyzetë e nëntë million e pesëqind e katër mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë)* **lekë pa Tvsh** dhe 67,672,782 lekë me Tvsh.
5. OE“Sh.” Shpk (me Nipt K07924803N) me vlerë ekonomike të ofertës **65,652,952** *(gjashtëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy)* **lekë pa Tvsh** dhe 77,111,342 lekë me Tvsh.
6. BOE “N.” Shpk & “R.’ Shpk (me Nipt-e respektive: K31329048I dhe J69102223E) me vlerë ekonomike të ofertës **68,694,945** *(gjashtëdhjetë e tetë milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e dyzetë e pesë)* **lekë pa Tvsh** dhe 81,473,493 lekë me Tvsh.
7. BOE “Ll.” Shpk& “A.” Shpk (me Nipt-e respektive: K24218401K dhe K33222403Ë) me vlerë ekonomike të ofertës **45,381,156** *(dyzetë e pesë million e treqind e tetëdhjetë e njëmijë e treqind e nëntëmbëdhjetë)* **lekë pa Tvsh** dhe 58,461,000 lekë me Tvsh.
8. OE “B.” Shpk (me Nipt K71412003A) me vlerë ekonomike të ofertës **62,044,409** *(gjashtëdhjetë e dy milion e dyzetë ekatër mijë e katërqind e nëntë)* **lekë pa Tvsh** dhe 73,309,351 lekë me Tvsh.
9. OE “E.” Shpk (me NIPT K67106202Ë) pa vlerë ekonomike të ofertës.
10.OE ”R.” Shpk (me NIPT K29222201G) pa vlerë ekonomike të ofertës.
11.OE “K. C.” Shpk (me NIPT K71401004Ë) pa vlerë ekonomike të ofertës.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1. BOE “K.” Shpk & “A. K.” Shpk

a) BOE nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga AK në DT konkretisht pikën 2.3.5, gërma ñfò të kapacitetit teknik, në lidhje me fabrikën e prodhimit të betonit e cila duhet të jetë jo më larg se 35 km nga sheshi ndërtimit.
b) Drejtuesi teknik Ing. Mjedisit M. S. është në kushtet e papajtueshmërisë me këtë detyrë siç përcaktohet në VKM nr.42, datë 16.01.2018 ñ*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi"*, i ndryshuar,pasi nga verifikimet e kryera nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë, ing. M. S. rezulton i punësuar si pranë një institucioni public, siç është Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, ashtu edhe në një kompani private që ushtron veprimtari në fushën e ndërtimeve.
c) U konstatua se ndërmjet formularit të ofertës dhe preventivit të dorëzuar në sistem ka mospërputhje ku shuma e të gjitha gabimeve është më e madhe se 2%.

2. BOE "B. B" Shpk & "P. V." Shpk

a) BOE nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga AK në DT konkretisht pikën 2.3.5, gërma ñfò të kapacitetit teknik, në lidhje me fabrikën e prodhimit të betonit e cila duhet të jetë jo më larg se 35 km nga sheshi ndërtimit.
b) BOE nuk përmbush pikën 2.3.5, Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund tõi vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, konkretisht për mjetin autopompë betoni dokumentacioni i paraqitur është me mangësi.
c) BOE nuk përmbush pikën 2.3.3 gërma g, ku është kërkuar në DT një saldator që të jetë i certifikuar dhe i kualifikuar për punime në lartësi.
d) BOE nuk dëshmojnë se përbushin pikën 2.3.3 gërma f të DT.

3. OE "Sh." Shpk

a) **OE "Sh." Shpk** nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga AK në DT konkretisht pikën 2.3.5, gërma ñfò të kapacitetit teknik, në lidhje me fabrikën e prodhimit të betonit e cila duhet të jetë jo më larg se 35 km nga sheshi ndërtimit.

4. BOE "N." Shpk & "R." Shpk.

a) **OE "N.**ò Shpk kanë parregullsi në lidhje me drejtuesit teknike të shoqërisë dhe konkretisht:
Drejtuesi teknik i ñN.ò Shpk z. Z. M., figuron njëkohësisht i punësuar në Bashkinë Tiranë(institucion publiki qeverisjes vendore).
Sipas VKM nr. 42, datë 16/1/2008 *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi",* Kreu IV, pika 2, përcaktohet qartësisht se: *"Papajtueshmëri të me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit"*
- Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike.
- Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit.
Kur personat që pranojnë të kryejnë detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë për zbatim disponojnë licencë profesionale mbikëqyrjeje e kolaudim punimesh zbatimi, ata kanë detyrimin për evidentimin e këtij fakti në dokumentacionin e paraqitur për aplikim, si dhe dorëzimin e kopjes origjinale të këtyre licencave pranë arkivës së sektorit përgjegjës për licencimin, përpara ose në çastin kur shoqëria në fjalë merr licencën.
Licencat profesionale për mbikëqyrje e kolaudim punimesh zbatimi, i kthehet personit sapo ai shkëput marrëdhëniet si drejtues teknik me shoqërinë."
Rasti i OE ñN.ò Shpk, për drejtuesin teknik z. M., të sipërshënuar, bie në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 42, datë16.01.2008 *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe*

procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", gjë e cila përbën shkak për skualifikim të ofertës së këtij BOE "N.ò Shpk& ñR.ò Shpk.

5. BOE "S." Shpk & "E. C. C."Shpk.

BOE."S.ò Shpk&ñE. C. C." Shpk, nga një anëtar i këtij BOE dhe konkretisht "S." Shpk është depozituar pranë AK Bashkia Përmet kërkesa për tërheqje nga procedura e prokuriomit me objekt; ñRikonstruksion i Shkollës së mesme "Sami Frashëri"ò Përmet me nr. 13 Prot., datë 21.01.2019. kërkesë qëështë protokolluar me nr. 154, datë 21.01.2019. Pas kësaj kërkesë të njërit prej antarëve të BOEñS.ò Shpk & ñE. C." Shpk ndërpret procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të mëtejshëm për këtë ofertues.

Referuar Ligjit nr.44/2015 *"Kodi i Procedurës Administrative i Republikës të Shqiperisë",* neni 94. *"Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës"*, pika 1 *"Si rregull në procedurë administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin pa një vendim përfundimtar për çështjen nëse pala që ka paraqitur kërkesë e terheq atë".* Përsa më sipër, KVO, bazuar në LPP e RRPP, ndërpret vlerësimin dhe e quan të skualifikikuar ofertën e BOE "S.ò Shpk & ñE. C." Shpk, pasi ky ofertues u tërhoq nga konkurimi në këtë procedurë prokurimi.

6. BOE "Ll." Shpk &"A." Shpk

a) BOEñLl.ò Shpk & ñA.ò Shpk ka paraqitur gabime në preventivin e ofertës së tyre që kalojne mbi 2% të vlerës së ofertës së paraqitur prej këtij.

b) BOE të mësipërm, nuk ka pasqyruar rregullisht në listpagesat e paraqitura personelin, drejtues teknik dhe punonjës të specializuar duke mos i përfshirë në lispagesa ose me më pak se 22 ditë pune në muaj siç kërkohet nga ligji.

Konkretisht: OE ñLl.ò Shpk ka deklaruar si Drejtues Teknik inxhinierin mekanik D. M. Ky punonjës figuron i punësuar part time në listpagesat e shoqërisë duke plotësuar vetëm 11 ditë në muaj nga 22 ditë që duhet të plotësohen me orar të plotë. OE ñLl.ò Shpk,ka deklaruar si drejtues Teknik inxhinierin e mjedisit A. A.. Ky punonjës figuron i punësuar part time në listpagesat e shoqërisë duke plotësuar vetëm 10 ditë në muaj nga 22 ditë që duhet të plotësohen me orar të plotë.

c) Inxhinieri elektronik i derklaruar nga OE ñLl.ò Shpk, A. Gj. nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për periudhën Janar-Korrik 2018. Në DT është kërkuar që inxhinieri elektronik të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën nga muaji Janar 2018 deri në Shtator 2018.Inxhinieri i ndërtimit i OE ñLl.ò Shpk, K. M. nuk figuron në listpagesat e shoqërisë për periudhën Janar-Qershor 2018.

d) Një antar i BOE konkretisht "A." Shpk, nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerje të detyrimeve vendore në Bashkinë Korçë ku ka deklaruar punë të ngjashme, aktivitet, në territorin e kësaj bashkie, për kontratën me EKB në këtë Bashki. Mungesa e këtij vërtetimi bie ndesh me kërkesën e AK në pikën 2.2.3, ku është kërkuar shlyerja në taksave dhe tarifave vendore në çdo vend ku zhvillon aktivitet biznese operatori ekonomik, referuar ligjit përkatës. Pagesa e taksave vendore për çdo vend biznesi përcaktohet në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò, i ndryshuar.

dh) BOE.ò Ll.ò Shpk & ñA.ò Shpk nuk plotëson kërkesën e AK, për distancën e fabrikës së betonit dhe inerteve.Ky BOE ka paraqitur dokumentacion për nyjen e prodhimit të inerteve dhe betonit me adresë në fshatin Bishqethem Lushnje, ku largësia nga kantieri i zbatimit të kësaj kontrate te Bashkia Përmet është mbi 140 km, kur kërkesa e AK në DT,pika 2.3.5, gërma f është: të jetë jo më larg se 35 km.

7. OE "B.-I." Shpk

a) OE ñB.-I.ò Shpk, nuk nuk ka arritur të plotësojë kërkesën e AK sipas pikes 2.3.5, gërma ñfò, për distancën e fabrikës së betonit, e cila, sipas kësaj kërkese të AK nuk duhet të jetë më larg se 35 km nga kantieri i zbatimit të punimeve të kontratës.

ÅFabrika e betonit në pronësi të ñR.&A.ò Shpk, me të cilën OE ñB.-I.ò Shpk ka bërë një kontratë furnizimi e ka vendodhjen në fshatin Harizaj, në Komunën Lekaj të Rrethit Kavajë. Distanca nga fabrika e betonit deri në kantierin e ndërtimit sipas intervaleve të rrjetit rrugor tëpublikuar në faqen zyrtare të ARRSH është 174 km, pra më shumë se 35 km. Kjo fabrikë betoni disponon leje mjedisore nga QKL të kodit III.1.A dhe jo III.1.B siç kërkohet në DT.
ÅFabrika e betonit në pronësi të ñA. N.ò Shpk, me të cilën OE ñB.-I.ò Shpk, ka bërë një kontratë furnizimi e ka vendodhjen në fshatin Kordhoce në komunën Lazarat të Rrethit Gjirokastër. Distanca nga fabrika e betonit deri në kantierin e ndërtimit sipas intervaleve të rrjetit rrugor të publikuar në faqen zyrtare të ARRSH është 63 km, pra më shumë se 35km.
ÅFabrika e betonit në pronësi të shoqërisë ñA. K.ò Shpk, me të cilën OE ñB.-I.ò Shpk, ka bërë një kontratë furnizimi e ka vendodhjen në komunën Farkë të Rrethit Tiranë. Distanca nga fabrika e betonit deri ne kantierin e ndërtimit sipas intervaleve të rrjetit rrugor të publikuar në faqen zyrtare të ARRSH është 237 km, pra më shumë se 35km.
ÅPërsa i përket deklaratës për impjantin e fabrikës së betonit të cilin e ka marrë me qera ngañAlb Buildingò Shpk, nuk mjafton vetëm që të jetë immobile (i lëvizshëm), pasi ky impjant ose fabrikë nuk disponon as leje mjedisore nga QKL të kodit III.1.B, as nuk ka një planvendosje ose planimetri dhe për më tepër nuk kanë përcaktuar se ku do ushtrohet aktiviteti duke mos marrë parasysh lejet që duhen për ta ushtruar një veprimtari të tillë. Ligji nr. 10488, datë 14.07.2011 *"Për lejet e mjedisit*ò i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij parashikojnë një procedurë kohore e cila zgjat në më shumë se 30 ditë kalendarike (referuar edhe VKM nr. 538, datë 26.5.2009 *"Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta"*. Të ndodhur në këto kushte, AK nuk garantohet nga ofertuesi, OE ñB.-I.ò Shpk, në zbatimin e kontratës për vetë afatin kohor të parashikuar ligji i mësipërm i cili kërkon edhe marrjen e miratimit të Lejes Mjedisore për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit të betonit sipas vendodhjes së kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit. Gjithashtu, OE në asnjë rast nuk ka deklaruar vendodhjen e saktë të instalimit të fabrikës së betonit (impiantit) të lëvizshëm në rast të fitimit të kontratës brenda hapësirës gjeografike në një distancë prej 35 km nga objekti i prokurimit. Për të dëshmuar plotësimin e kriterit të distancës nga kantieri, përveç detyrimit për pajisjen me licencë të impiantit të lëvizësh të fabrikës së betonit, duhej të dorëzohej edhe dokumentacion i posaçëm për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri, si psh kontratë pronësie trualli, kontratë përdorimi, ose kontratë qeraje me persona fizike ose me autoritete vendore për truallin/sipërfaqen e truallit ku do të vendosej ky impiant brenda rrezes prej 35 km nga kantieri i dërtimit. Pra deklarata e OE ñB.-I.ò Shpk për fabrikën e betonit nuk garanton plotësimin e kërkesës 2.3.5, gërma f të AK dhe kriteret e DT, kusht që përbën arsye për skualifikim të ofertës.
b) Nga kontrolli i preventivit të ñB.-I.ò Shpk u vune re këto gabime:
1. Gabim në volum.
ÅTe zëri B-4.3.8 është venë re një gabim në volum. Ky volum është bërë 680 m^2 ndërkohë që duhet të ishte 68 m^2 për rrjedhojë ky gabim në volum çon edhe në gabim në vlerën totale të preventivit e cila është në vlerën 1,530,000 lekë, vlerë kjo e cila çon në një gabim 2.47% prej vlerës totale të ofertës së paraqitur.
Në bazë të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* indryshuar neni 66 ñShqyrtimi i ofertaveò *"Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se ± 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar"* Duke qenë se shuma e gabimit matematikor është më shumë se 2% atëhere oferta e operatorit ñB.-I.ò Shpk refuzohet. Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, është informuar OE ñA. K.ò Shpk se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 81,490,378.838 *(tetëdhjetë e një milion e*

katërqind e nëntëdhjetë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë pikë tetëqind e tridhjetë e tetë) lekë me Tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.
Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Permet për sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 18.02.2019.
Ankesa për vlerësimin e ofertave:
1-Me nr.201, datë 25.01.2019, pranë AK Bashkisë Përmet është Protokolluar ankesa e OE ñK.ò Shpk.
Në datën 31.01.2019 OE ñK.ò Shpk i është kthyer përgjigje nga AK Bashkisë Përmet me shkresën nr.201 Prot., datë 31.01.2019, duke mos e pranuar ankesën.
2- Me nr. 241, datë 29.01.2019 pranë Bashkisë Permet është Protokolluar ankesa e BOE ñB. Bò Shpk & ñP. V.ò Shpk. (Për dijeni KPP dhe APP)
Në datën 31.01.2019 BOE ñB. Bò Shpk & ñP. V.ò Shpk i është kthyer përgjigje nga AK Bashkisë Përmet me shkresën nr. 236/1 Prot., datë 03.02.2019, duke mos e pranuar ankesën.
3- Me nr. 250, datë 30.01.2019 pranë Bashkisë Përmet është Protokolluar ankesa e OE ñA. K.ò Shpk.
Në datën 14.02.2019 OE ka ma përgjigje ku AK e ka pranuar ankesën.
Titullari i AK Bashkia Përmet më datë 25.01.2019 ka lidhur: ñKontratë pune si ekspert i jashtëmò me z. A. T., për të qenë pjesë e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për procedurën e prokurimit me objekt*: "Rikonstruksion i shkollës së mesme Sami Frashëri",* Bashkia Përmet.
Me Urdhrin nr. 37 e nr,408 Prot., datë 15.02.2019 *"Për delegim kompetencash"* Titullari i AK z. Niko Shupuli i ka deleguar zv/Kryetares së Bashkisë Përmet znj. E. K. për procedurën e prokurimit me objekt*: "Rikonstruksion i shkollës së mesme Sami Frashëri",* për nënshkrimin e urdhërit të prokurimit me objekt: *"Heqja e procedurës nga pezullimi dhe rivlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit"*
Me Urdhrin nr. 37 e nr, 407 Prot., datë 15.02.2019*"Urdhër për heqje e nga pezullimi dhe rivlerësimin të procedurës së prokurimit"* nënshkruar nga znj. E. K. është ngarkuar NjP dhe KVO për; Rivlerësimin e procedurës së prokurimit në përputhje me vendimet e mara dhe procesverbalet e hartuara nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave dhe ato të pasqyrohen në SEP për OE pjesëmarës
a. KSHA më datë 30.01.2019 ka formuluar nënshkruar Proces Verbalin, për shqyrtimin e ankesës me nr. 201 Prot., datë 25.01.2019 nga BOE ñK.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk, përfaqësuar nga ñK.ò Shpk.
KSHA pasi ka shqyrtuar ankesës ka vendosur: Argumentet dhe pretendimet e paraqituar në ankesë nuk janë të mbështetura në aktet ligjore për prokurimin publik. Në këto kushte ankesa e paraqitur nga **BOE** ñK.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk nuk duhet pranuar.
b. KSHA më datë 30.01.2019 ka formuluar nënshkruar Proces Verbalin, për shqyrtimin e ankesës me nr. 236 Prot., datë 28.01.2019 nga BOE ñB. Bò Shpk. & ñP.V.ò Shpk, përfaqësuar nga ñB. Bò Shpk.
KSHA pasi ka shqyrtuar ankesën ka vendosur: Argumentet dhe pretendimet e paraqituar në ankesë nuk janë të mbështetura në aktet ligjore për prokurimin publik. Në këto kushte ankesa e paraqitur nga BOEñB. Bò Shpk. & ñP. V.ò Shpk, përfaqësuar nga ñB. Bò Shpk, duhet të pranohet pjesërisht vetëm për njërën nga pretendimet e ngritura (pikën 2.2.3 të Kapacitetit ekonomik të DT- Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave vendore për vitet 2016-2017-2018). Kurse pretendimet e tjera janë të pabazuara në RRPP.
c. KSHA më datë 14.02.2019 ka formuluar nënshkruar Proces Verbalin, për shqyrtimin e ankesës me nr. 253 Prot., datë 30.01.2019 nga OE ñA. K.ò Shpk
KSHA pasi ka shqyrtuar ankesës ka vendosur: KVO duke cituar në vlerësimin e ofertës se ofertuesi ñA. K.ò Shpk.

Sipas KSHA ofertuesi ñA. K.ò Shpk, ka përmbushur detyrimin e saj ligjor për aplikimin për ndryshime në licence. Ky fakt konfirmohet zyrtarisht edhe nga vetë Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, përmes komunikimit elektronik, dhe konkretisht e-mail i koordinatores për të drejtën e informimit pranë MIE, (që gjendet bashkëlidhur ankesës) sipas të cilit:OE ñA. K.ò Shpk, me nr. licence në zbatim NZ.0709/16, ka aplikuar pranë MIE më datë 03.12.2018, Protokolluar në MIE me nr. 2016, datë 03.12.2018, me objek: ñPër ndryshim të drejtuesit ligjor nga z. Xh. I. në z. A. K., rritje të kategorisë së punimeve dhe shtim të drejtuesve teknikë, aplikim i cili është trajtuar nga sekretaria teknike me datë 18.12.2018. Në respektim të afateve dhe procedurave ligjore dhe plotësimit të dokumentacionit, dosja do të dërgohet për shqyrtim pranë komisionit të posacëm të dhënies se licencave.

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka vendosur që pretendimet e paraqitura nëankesën e ofertuesi OE ñA. K.ò Shpk. të pranohen si bazuara në legjislacionin në fuqi dhe si rrejdhojë të ndyshojë statusin.

Formulari i njoftimit të fituesit nr, 497 Prot., datë 26.02.2019 për OE óóA. K. ñShpk, botuar në Buletini nr.9, datë 04. Mars 2019 në faqet 270- 275/620.

Kontrata me nr. 547 Prot., datë 01.03.2019 me objekt: *"Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Sami Frashëri"*, e lidhur ndërmjet Bashkisë Përmet përfaqsuar nga Kryetari z. N. Sh. dhe Operatorit Ekonomik ñA. K.ò Shpk përfaqësuar nga administrator z. A. K. Vlera totale e kontratës (në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës) është **68,672,247.365** *(gjashtdhjetë e tetë milion e gjashtëdhjetë e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e dyzetë e shtatë pikë treqind e gjashtëdhjetë e pesë)* lekë pa Tvsh dhe 81,490,378.838 lekë me Tvsh. Operatori ekonomik do të kryejë punimet e sipërcituar duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratë për 8 muaj.

Auditimi i dokumentacionit të ofertës fituese të OE "A. K." Shpk

1-Dokumentacioni i paraqitur nga OE ñA. K.ò Shpk, për të dëshmuar plotësimin e pikës 2.3.2 të kritereve të veçanta për kualifikim, për licencën e shoqërisë, krahasuar me dokumentacionin, për të dëshmuar plotësimin e pikës 1, të kritereve të përgjithshme për kualifikim, ekstraktin e QKB-së, paraqet të dhëna të pasakta dhe në kundërshtim me ligjin Konkretisht;

OE ñA. K.ò Shpk, ka paraqitur Ekstraktin e QKB, ku dëshmohet që administrator i shoqërisë është z. A. K., nga data 12.02.2018 deri në datë 06.02.2020, (dhe zoti E. I. nga data 10.07.2018 deri në datë 10.07.2020) pasi z. Xh. I., drejtues ligjor i mëparshëm,sipas ekstraktit historik të QKB-se, ka dhënë dorëheqjen.Konkretisht:

- Sipas licensës së shoqërisë me NZ 0709/16, datë 22.12.2016, rezulton se drejtues ligjor është z. Xh. I.
- Sipas Ekstraktit të QKB-së, drejtues ligjor është z. A. K. dhe z. E. I.

Në kreun III ñKategorizimi dhe klasifikimi i licencës, elementët e saj, kushtet, kriteret dhe kufizimetò, pika 2 dhe pika3 gërma "a", paragrafi 2 të VKM nr. 42, datë 16.1.2008 *"Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi",* parashikohet se:

Në kreun I "*Qëllimi, fusha e veprimit të regullores dhe përkufizime*" pika 2, paragrafi *"Drejtues ligjor"-personi fizik apo personat fizikë (administrator për sh.p.k., drejtor, presidenti për sh.a., personi fizik) të përcaktuar si të tillë nga Vendimi i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit/ ose në gjykatë.*

Kreu II, pika 5, gërma a ku thuhet: ñ*Brenda 30 ditëve, çdo subjekt i licencuar në zbatim ka detyrimin të depozitojë aplikimin për përditësimin e të dhënave që nuk sjellin ndryshim në klasifikim. I njëjti afat,me përjashtim të rastit kur përcaktohen afate të posaçme sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëmdhe për aplikime të cilat sjellin ndryshime në klasifikimin*

e lejes.Aplikimet që nuk sjellin ndryshime në klasifikim së bashku me dokumentacionin provues shqyrtohen dhe miratohen nga sektori i licencimit".

Në zbatim të VKM nr. 42, datë 16.1.2008 , OE ñA. K.ò Shpk detyrohej, që brenda 30 ditëve, duhet të kishte bërë zvendësimin e drejtuesit ligjor të shoqërise, në licencë, me personin e emëruar administrator sipas regjistrimit në Ekstraktin e QKB-së.

Sa më sipër O.E ñA. K.ò Shpk, nuk plotëson detyrimet e VKM nr. 42, datë 16.1.2008

- Rregullat e prokurimit përcaktojnë se, është detyrë e OE të dorëzojnë ofertën në përputhje me DT dhe kërkesat e AK. Referuar nenit 48 pika 4 gërma ñbò të LPP-së ofertat dorëzohen në formë elektronike përmes SPE si edhe pikës 1 të VKM nr. 918, datë 29.12.2014 *"Për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike"* në të cilën parashikohet se *"Të gjitha procedurat e prokurimit zhvillohen me mjete elektronike".*
- Gjatë shqyrtimit të ofertave, nga ana e KVO nuk mund të kërkohet, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme pasi AK, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 LP.

Mosrepsektimi i ketij detyrimi ligjor nga OE ka sjellë që vetëm për shkakun e tij licenca të jetë e parregullt, sipas përcaktimeve të VKM nr. 42, datë 16.1.2008.

Në zbatim të nenin 82, pika I të ligjit 44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative i RSH",* barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga AK, bie mbi OE, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.

Mos plotësimi i kërkesave të sipërshënuara të AK, nga ana e OE ñA. K.ò Shpk, janë shkak për të skualifikim ofertën e OE.

Në këto kushte OE duhej të ishte skualifikuar dhe kjo procedurë duhej të ishte anuluar**,** veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ñ*Për prokurimin publik*ò, *(i ndryshuar)*, ku thuhet;

Neni 24 "Anulimi i një procedure prokurimi"
Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit vetëm:ç) nëse asnjë nga ofertat e paraqitura nuk përputhet me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit.
Neni 53/3 *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertëtë vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*
Neni 53/5 *Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë: a)kur ofertuesi nuk është i kualifikuar;c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji;*

Kualifikimi dhe shpallja fitues e operatorit ekonomik i cili nuk plotëson kriteret e DT, është në kundërshtim me kërkesat ligjore, me pasojë përdorim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet në vlerën e kontratës **68,672,247.365 lekë pa Tvsh**. Tenderi duhej anuluar në kushtet kur në garë nuk mbetet asnjë ofertë e vlefshme dhe duhej zhvilluar proçedurë e re.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, *"Për prokurimin publik", neni 24, neni 53, neni 55,* VKM nr. 42, datë 16.1.2008 *"Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensav profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi" OE ka patur detyrimin ligjor si dhe ka patur në dispozicion kohën e mjaftueshme për të aplikuar brenda afatit kohor prej 30 ditëve. si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 58, neni 61, pika 2, neni 66, neni 67, neni 74.*

Mbi observacionet e paraqitura nga subjektipër Projekt Raportin e Auditimit

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 3561/5 prot., datë 21.12.2021 dërguar në e-mailin zyrtar nga *Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave z. A. T., Znj. A. Q. dhe z. A. Zh. në lidhje me* procedurën e prokurimit me objekt: ñRikonstruksion i shkollës mesme Naim Frashëri Përmetò

Pretendimet e subjektit:
Pasi jemi njohur pjesërisht me Projekt Raportin e grupit Auditimit të KLSH-së në pikën që trajton vlerësimin e KSHA -së, Iidhur me ankesën e operatorit ñA. K.ò Shpk për procedurën e prokurimit ñRikonstruksion i shkollës mesme Naim Frashëri Përmetò, Bashkia Përmet si dhe rekomandimin e faqes 119 për ngritjen e një grupi pune që shqyrtimin e përgjejgjësisë se KSHA-së'. Duke mos qënë dakort me konstatimin e audituesve, po ju përcjellim për shqyrtim këtëobservacion ku përshkruajmë kundërshtimet tona, lidhur me konstatimin e audituesve.
1. Audituesit arsyetojnë se OE ñA. K.ò Shpk duhet të skualifikohej sepse;
....Në rregullat e prokurimit përcaktohet se; operatorët ekonomike janë të detyruar të përgatisin oferta, në pëputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi si dhe kriteret e kualifikimit të vendosura nga autoriteti kontraktor.
Pikërisht legjislacionin në fuqi të aplikueshëm në rastin korrkret ka zbatuar dhe i është referuar KSHA ja duke pranuar ankesën e ñA. K.ò Shpk.
Konkretisht
Kriteri për kualifikirn i vendosur nga AK e për për të cilin Auditët konsiderojnë se *"A. K." Shpk, duhet të skualifikohej është pika 2.3.2* ***e kritereve të veçantanta për kualifikim.***
Në këte pikë thuhet:
é é .
Për përmbushjen e kriterit të kërkuar në DT operatori ekonomik ka paraqitur licensën NZ 07091/6 datë 22.12.2016, të lëshuar nga MIE.
Si kriter për kualifikirn AK ka kërkuar disponimin e; ***Licenca profesionale e shoqërisë.... sipas modelit të lëshuar nga institucione e autorizuara.***
Pra, në kriterin e mësipërm për kualifikim, thjesht kërkohet disponimi i licencës profesionale ***sipas modelit të lëshuar nga institucionet e autorizuara dhe këtë operatori e ka përmbushur*** Në kriterin e mësipërm nuk ka ndonjë formulim apo përcaktim për përputhjen e emrit të drejtuesit ligjor në licencë me atë të QKB-së.

2. Lidhur me vlefshmërinë e licencës për shkak të mospërputhjes ***së emrit të drejtuesit ligjor në licencë me atë të QKB-së.***
KVO-ja kishte konstatuar se nuk përputhej emri i drejtuesit ligjor License - QKB dhe kishte vendosur skualifikimin e këtij operatori me arsyetimin se kjo mospërputhje e bënte licensën të pavlefshme.
Edhe audituesit i qëndrojnë këtij vlerësimi duke iu referuar përcaktimeve të VKM 42/2008. *Në Projekt Raport nuk kundërshtohet ky arsyetim i bërë nga ana jonë dhe audituesit nuk shprehen nëse licenca e paraqitur nga OE është e vlefshme apo jo dhe nëse KSHA-ja ka tagër të shpallë të pavlefshme një akt të një organi i cili në hierarkinë administrative qëndron më lart se KSHA-ja .*
Për këtë arsye po e përsëritim arsyetirnin për vlefshmërinë e licencës së ankimuesit:
Duke qëne se, qoftë arsyeja e skualifikimit e dhenë nga KVO-ja por edhe ankesa i referoheshin vlefshmërisë se licencës se operatorit ankues, për të bërë një vlerësim të drejtë, konform dispozitave ligjore nëfuqi , Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vendosi ti kërkonte Ministrisë të Energjitikës dhe Infrastrukturës (institucioni që sipas VKM 42/2008 është institucioni kompetentpër lëshimin e licencave në zbatirm punimesh në ndërtim) për tu shprehur nëse licenca NZ 0709/16, datë 22.12.2016 e shoqërisë ñA. K.ò Shpk konsiderohej e vlefshme apo jo.
é é é
Qëndrimi i Audituesve të KLSH:
Në lidhje me komentet e ribëra nga KSHA, sqarojmë se Interpretimi i grupit të auditimit të KLSH, (përputhet me arsyetimin/vendimin e KVO) dhe i referohet në VKM nr. 42, datë 16.1.2008*"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjektevë juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi".*
Në Kreu II të VKM nr. 42 shprehet: *"Organizimidhefunksionimiistrukturëspërgjegjësepërdhënien,*

ndryshimin apo revokimin e licencave profesionale"
Pika 5/a: "*Përgjegjësitë, procedurat dhe afatet për përditësimin e të dhënave në regjistër që nuk sjellin ndryshime në klasifikim për subjektet juridike".* ku citohet:
"Brenda 30 ditëve, çdo subjekt i licencuar në zbatim ka detyrimin të depozitojë aplikimin për përditësimin e të dhënave që nuk sjellin ndryshim në klasifikim. I njëjti afat,me përjashtim të rastit kur përcaktohen afate të posaçme sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëmdhe për aplikime të cilat sjellin ndryshime në klasifikimin e lejes. Aplikimet që nuk sjellin ndryshime në klasifikim së bashku me dokumentacionin provues shqyrtohen dhe miratohen nga sektori i licencimit.
I. Ndryshim apo shtesë të drejtuesit/ve ligjor të shoqërisë; dhe në vijim
Kreu VII përcakton se "Shoqëria kryen veprimtari pa drejtues teknik ose shkel afatet e njoftimit të caktuara në këtë rregullore. Në këtë rast komisioni heq licencën për shoqèrinë/drejtuesit për një periudhë 3 vjet.
Në zbatim të VKM së sipërcituar, OE "A. K." Shpk, detyrohej që brenda 30 dítëve, duhet të kishte bërë zëvendësimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë, në licencë, me personin e emëruar administrator sipas regjistrimit të bërë në Ekstraktin e QKB-së, ky veprim nuk është realizuar nga OE për më shumë se 9 (nëntë) muaj kalendarik.
Për sa më sipër OE ñA. Ko.ò Shpk, ka shkelur VKM nr. 42, datë 16.01.2008 *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zhatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi",* i ndryshuar.
Në rregullat e prokurimit përcaktohet se; *operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi si edhe kriteret e kualifilkimit të vendosur nga autoriteti kontraktor.*

Pretendimet e subjektit:
Lidhur me këtë rekomandim ju paraqesim këtë kundërshtim;
1. Audituesit nuk citojnë bazën ligjore të cilës i referohen në dhënien e këtij rekomandimi.
2. Baza ligjore e aplikueshme në fuqi për rastin e procedurave të prokurimit ka përcaktuar në mënyrë shteruese cilat janë organet që mund të shqyrtojnë vendimarrjen e KVO-së apo KSHA-së si dhe cilat janë kompetencat e tyre në rastin e shqyrtimit të vendirnarrjes së KVO-së.
Të tilla organe janë KSHA-ja, që vihet në lëvizje vetëm mbi, bazën e ankesave të operatorëve, KPP për vendimarrjet e KVO-se apo KSHA-së, APP-ja dhe auditimi i KLSH-së. Mbi çfbazë ligjore do të ngrihet ky grup pune e kush mund të japë tagrat e përcaktojë rregullat e funksionimit të tyre që do të shqyrtojne vendimarrjen e KVO-së apo KSH-së përderisa nuk ka parashikim ligjor?
3. Audituesit shprehen, për një grup pune me specialistë të fushës, por nuk përcaktojne të cilës fushë duhet të jenë këta specialist, çfarë dokumenti, certificate, diplome duhet të disponojnë këta specialistë të fushës dhe cili është institucioni apo organi që certifkon njohuritë e tyre
4. Pa e paragjykuar këtë grup pune në cilësitë, aftesitë profesionale e integritetin moral, si do certifikohen ata se janë më të aftë se anetarët e KVO-së apo KSHA-së, vendimet e të cilëve ata do të vlerësojnë?
Kush do ta normojë e rregullojë punën e tyre në kuptimin e bazës ligjore mbi të cilën do të veprojë dhe produktit që do të nxjerrin? Çfvlerë ligjore do të ketë akti i tyre dhe kujt do ti kundërdrejtohet? Cila do të jetë procedura e shqyrtimit administrativqë do të ndjekin, cilit dokumentacion do ti referohen?
A do të kenë detyriminti drejtohen subjekteve që do të auditojnë për ti vënë në dijeni për çka po kryejnë dhe për tfju dhënë atyre mundësinë proceduriale të dëgjimit vetë apo nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar siç parashikon K. Pr. A, e të paraqitjes së provave e argumentave të tyre me gojë apo me shkrim.
Qëndrimi i Audituesve të KLSH:
Qëllimi i rekomadimeve nga grupit i auditimit të KLSH, nuk është realizimi i auditit të auditit, por përmirësimi apo zvogëlimi i parregullsive në procedurat e prokurimit që do të zhvillohen në vijimësi në istutucionin e bashkisë Përmet. Menaxhimi financiar dhe kontrolli, nuk ndalon asnjë institucion të monitorojë veprimtarinë e vet ekonomiko - financiar, pamvarsisht pikëpyetjeve që ngrini ju si KSHA.
Nga grupi i auditimit nuk është kërkuar të paraqesni: opinione, aludime, inerpretime, vlerësime apo paragjykime por kundërshtime të bazuara në fakte dhe dokumentacion ligjor.
Pamvarësisht se ndajmë opinion të ndryshëm mbi argumentat e sipërcituar, nisur nga teknaliteti i shprehur në observacion, formulimi i rekomandimit të përmendur do të reflektohet ne Raportin

Përfundimtar të Auditimit. ***Pretendimet tuaja merren pjesërisht në konsideratë nga grupi i auditimitdhe do tëtrajtohen në materialin e auditimit.***

Titulli i Gjetjes 12:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt: ñ*Rikonstruksion i Shkollës së mesme Naim Frashëri", Bashkia Përmet.*
Situata:	Kualifikimi i OE ñA. K.ò Shpk, nga KSHA është në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zhatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi",* i ndryshuar. OE ñA. K.ò Shpk, detyrohej.që brenda 30 ditëve, të kishte bërë zëvendësimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë, në licencë, me personin e emëruar administrator sipas regjistrimit të bërë në Ekstraktin e QKB-së, ky veprim nuk është realizuar nga OE për më shumë se 9 (nëntë) muaj kalendarik. Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e OE ñA. K.ò Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DT.
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik
Impakti:	Përdorim të fondeve publike në paligjshmëri me legjislacionin e Prokurimit Publik, në vlerën 81,490,378.838 **lekë me Tvsh.**
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator nga KVO
Rëndësia:	**E lartë**
Rekomandim:	Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masa për eleminimin e praktikavetë shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret emiratuara në DT.

2. Tender i zhvilluar me objekt**:"*Rikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Kutal, Verçisht dhe Zhepe"*, Bashkia Përmet.**

- **Fondi limit**: 3,166,666 *(tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë)*lekë pa Tvsh.

- Burimi i Financimit: Të ardhurat e Buxhetit të Bashkise të miratuara me VKB nr. 04, datë 18.01.2018 ñ*Për miratimin e buxhetit të bashkisë për vitin 2018 dhe përcaktimin e numrit të punonjësve, institucioneve dhe NJA ne varësi"*

- **Numri i referencës së procedurës**:65132-04-25-2018

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion e ndërtime te urave në Fshatrat Kutal, Verçisht dhe Zhepe"* Bashkia Përmet.		
1. Urdhër Prokurimi nr.67 datë 11.04.2018	**3. Njësia e Prokurimit** Urdhër nr.73 datë 25.04.2018	**4. KVO** Urdhër nr. 74, datë 25.04.2018
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim	L. M. E. M. B. Z.	Ll. Th. F. L. Th. K.
5. Fondi Limit (pa tvsh) 3,166,666	**6. Oferta fituese (pa tvsh)** 3,166,658	**7. Diferenca me fondin limit** 8
8. Data e hapjes së tenderit 07.05.2018	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Bashkise Permet	**10. Operatorë Ekonomike 2** ñH.ò Shpk
11. Ankimime AK:nuk ka	**12.Përgjigje Ankesës nga AK -**	**13. Përgjigje** KPP -
b. Kontrata nr. 1363 Prot		
14. Lidhja e kontratës datë 04.06.2018	**15. Vlera e kontratës (me tvsh) 3.799,989.60**	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Kjo procedurë prokurimi është mbështetur në projektin dhe preventivin e hartuar nga Zyra e Urbanistikës e Bashkisë Përmet, ark.E. M. miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. N. Sh. me vlerën 3,166,666 lekë pa Tvsh.

Nga auditimi i kësaj praktike rezultoi se:
Zërat e preventivit përgjithësisht janë hartuar referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, datë 15.07.2015 i ndryshuar
Në relacionin teknik të formuluar nga Zyra e Urbanistikës *(Pa datë e pa numër Protokolli)* citohet: *Për shkak të rreshjeve të dendura të ndodhura në muajin Dhjetor 2017- Janar 2018 me, prurjet e lumit Vjosë shkaktuan dëmtime të pasarelave në fshatrat Kutal dhe Zhepe ku situata është tepër e rënduar pasarelat pothuajse kanë dalë jashtë funksionit dhe përbëjnë një problem të madh për kalimin e lumit të Vjosës për banorët që jetojnë në këto fshatra.*
Pasarelat e Zhepes dhe Kutalit janë në gjendje kritike sepse prurjet e lumit patën një impakt të rëndë në dëmtimin e urave, duke bërë të pa mundur kalimin e banorëve në këto ura. Mungesa e këtyrej urave e ka komplikuar së tepërmi jetën e banorëve në këto fshatra për shkak të largësisë me rrugën nacionale për shkak të mungesës së urave ndaj lind e neveojshme rikonstruksioni i sa më shpejtë i këtyre urave për të bërë të mundur kalimin e banorëve në këtë ura duke u lehtësuar atyre zhvillimin e punëve të përditshme që lidhen me këto urë.
Në dosjene prokurimit gjenden:
-. Urdhëri nr. 67, datë 11.08.2018 i Titullarit të AK *"Për hartimin e fondit limit, specifikimetteknike"*
-. Preventivi me çmime i hartuar nga Zyra e Urbanistikes.
-. Specifikimet teknike,
-. Relacion teknik
- Grafiku i punimeve,
- Urdhëri nr. 73, datë 25.04.2018, i Titullarit të AK ñ*Për krijimin e Njësise së Prokurimit"*, e përbërë: z. L. M. (Jurist), z. E. M. (Arkitekt) e znj. B. Z. (Ekonomiste). Bashkangjitur: Deklaratat nga antarët e Njësisë së Prokurimit që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interest.
- Urdhëri nr. 64, datë 25.04.2018 i Titullarit të AK ñPër krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Bashkangjitur: Deklaratat nga antarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të ineresit.
Dokumentet e tenderit
- Procesverbali i datës 24.04.2018 nga NJP, për justifikimin e kritereve të vendosura në DT, miratuar nga Titullari i AK z. N. Sh.
Mungesa e argumentimit të kritereve të veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, në kundërshtim me nenin 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 26 dhe neni 61, ñHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2, paragrafi 2, si:
ñPër hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 ñPër rregullat e Prokurimit Publikò sipas të cilit

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës."

Titulli i Gjetjes 13:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara. në tenderin e zhvilluar me objekt:ñ*Rikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Kutal, Verçisht dhe Zhepe"*, Bashkia Përmet.
Situata:	Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtëprokurimit, nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit në zbatim të nenit 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 26 dhe neni

	61, ñHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2, paragrafi 2. Nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së OE të ftuar për pjesëmarrje
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik
Impakti:	Hartimi igabuar i kërkesave për kualifikim
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator nga NJP.
Rëndësia:	**E lartë**
Rekomandim:	Nga ana e Bashkisë Përmet, të merren masa për përcaktimin e DTnë përputhje me përcaktimet ligjore dhe për eliminimin e këtyre praktikave. Të argumentohen arsyet e përzgjedhjes së OE të ftuar për pjesëmarrje në prokurimin publik.

Në DT janë kërkuar: Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: Pika 2.2.4.Në rast se operatori ekonomik ofertues rezulton debitor ndaj Bashkisë Përmet do të përbëj shkak për skualifikim, për këtë duhet të paraqesi deklaratë me shkrim se nuk është debitor ndaj AK Bashkia Përmet.
Kërkesa është në kundërshtim me nenin 46, pika 1, e LPP ku përcaktohet se ñ*1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese"*, për rrjedhojë legjislacioni i prokurimit publik kërkon që kriteret e kualifikimit duhet të jenë të qarta dhe të mirë përcaktuara nga AK, me qëllim që të jenë sa më të mirkuptueshme jo vetëm nga OE por edhe në funksion të procesit të vlerësimit. AK ka informacionin e nevojshëm në lidhje me detyrimet që OE mund të kenë në Bashki.Në këtë kuptim kërkesa e AK për paraqitjen e kësaj deklarate konsiderohet e panevojshme për ofertuesit pjesëmarrës në këtë procedurë.

Për mangësitë e konstatuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NHJDT të përbërë nga z. L. M., z. E. M. e znj. B. Z.

Formulari i Njoftimit të Fituesit më date 17.05.2018, Botuar në Buletini nr. 17, datë 30 Prill2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:
1. BOE "T." Shpk &"C." Shpk (me Nipt-e respektive K32522629L dhe J74818825K) me vlerë ekonomike të ofertës **2,799,650** *(dy milion e shtatëqind e nëtëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë)* **lekë pa Tvsh.**
2. OE "H." Shpk (me Nipt J69102206O) me vlerë ekonomike të ofertës **3,166,658 lekë pa Tvsh.**
Ankesa: nuk ka patur në lidhje me vlerësimin e KVO-së.
Komisionit i Vlerësimit të Ofertave, më datë 22.05.2018 ka formuluar/nënshkruar Raportin Përmbledhës, miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. Niko Shupuli.për procedurën e prokurimit me objekt:*"Rikonstruksion i ndërtimit të urave ëe fshatrat Kutal, Verçisht dhe Zhepe",* Bashkia Përmet.
Oferta të skualifikuara:
1. BOE: "T." Shpk & "C."Shpk
Nga shqyrtimi i dokumentave ligjore, administrative, teknike e financiare, kualifikuese të ofertës paraqitur për këtë porocedurë prokurimi, KVO vlerëson se dokumentacioni i paraqitur për këtë procedurë prokurimi nga ky ofertues nuk është në përputhje me LPP e RRPP, sipas kërkesave të AK në njoftimin e kontratësdhe DT.
Dokumentacioni i paraqitur nga BOE nuk plotëson pikën 2.3 Kapaciteti teknik të kriteret e veçantatë kualikimit, **Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

a. *Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet, të realizuar gjatë tri viteve të fundit.*
b. Punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.
BOE "T." Shpk & ñC.ò Shpk, nuk ka dëshmuar qe zotërojnë pervojë të mëparëshme për punë të ngjashme, sipas objektit të kontratës së AK, kërkuar në kushtet e veçanta të kualifikimit, pika 1, gërma ñaò, dhe ñbò.
Dokumentacioni i dorëzuar prej tyre në sistem, nuk përputhet me objektin e prokurimit. Zërat e preventivit të kërkuara nga AK për kontratën që prokurohet nuk kanë përputhje me situacionet e paraqitura nga ky BOE, gjë që nuk plotëson kërkesën e AK lidhur me punimet e ngjashme.
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
Nga shqyrtimi i dokumentave ligjore, administrative, teknike e financiare, kualifikuese të ofertës të OE **"H." Shpk**, KVO ka vlerësuar se dokumentacioni i paraqitur për këtë procedurë prokurimi nga ky ofertues është në përputhje me LPP e RRPP, sipas kërkesave të AK në njoftimin e kontratës dhe DT,
Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, është informuarñH.ò Shpk, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **3,166,658** *(tre milion e njeqind e gjashtedhjete e gjashte mije e gjashteqind e pesedhjete e tete)* **lekë pa Tvsh** është identifikuar si oferta e suksesshme.
Oferta të kualifikuara:
1. OE "H. Shpk
Nga shqyrtimi i dokumentave ligjore, administrative, teknike e financiare, kualifikuese të ofertës KVO ka vlerëson se dokumentacioni i paraqitur për këtë procedurë prokurimi nga ky ofertues është në përputhje me LPP e RRPP, sipas kërkesave të AK në njoftimin e kontratës dhe DT,
KVO, bazuar në LPP e RRPP ka vendosur: Të kualifikjë si ofertë të vlefshme, ofertën e OE :"H." Shpk, me vlerë të ofertës 3,166,658 *(tre milion e njëqind egjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë)* lekë pa Tvsh.
Në datë 24.07.2019 është arkivura dosja e procedurës së prokurimit publik, në zbatim të Ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 *"Për Arkivat";* Vendimit nr. 4, datë 19.06.2017 ñ*Për miratimin e rregullores së njesuar të punës me dokumente në autoritetet publik të Republikës së Shqipërisë"; si dhe të normave tekniko-profesionale dhe medologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë.*

Kontrata nr. 136 Prot., datë 04.06.2018, me objekt: ***"Rikonstruksion i ndërtimit të urave në fshatrat Kutal, Vereçisht dhe Zhepe"****, Bashkia Përmet*, e lidhur ndërmjet palëve: Bashkisë Përmet përfaqsuar nga z. N. Sh. dhe OE ñH.ò Shpk përfaqësuar nga administratori z. A. H. Vlera totale e kontratës *(në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës)* është **3,166,658** *(tre milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tetë)* lekë pa Tvsh. 3.799,989.60 (*tre milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëtë qind e nëntëdhjetë e tetë pikë gjashtëdhjetë)* lekë me Tvsh**.** OE do të kryejë punimet e sipërcituar duke filluar nga data 04.06.2018.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: Titullari i Autoritetit Kontraktor z. N. Sh.; Njësia e Prokurimit Publik: z. L. M., z. E. M. e znj. B. Z.;

3. Tender i zhvilluar me objekt:*"Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunite të pafavorizuara" Bashkia Përmet*

-.Numri i referencës së procedurës: REF-81663-08-01-2018

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara" Bashkia Përmet.*		
1. Urdhër Prokurimi nr. 159, datë 01.08.2018	**3. Njësia e Prokurimit** 1. L. M. -Jurist 2. E. M. - Arkitekt 3. B. Z. -Ekonomiste	**4. KVO Urdhër** nr. 160 datë 01.08.2018 1. Ll. Th. 2. F. L. 3. Th. K.
2. Lloji i Procedurës: ñKërkesë për propozimò,		
5. Fondi Limit (pa tvsh) 5,028,293 lekë	**6**. Oferta fituese (pa tvsh) BOE ñA. K.ò Shpk & ñE.ò Shpk 4,939,996 lekë	**7. Diferenca me fondin limit** 88,297 lekë pa Tvsh.
8. Data e hapjes së tenderit 09.12.2019	**9. Burimi Financimit** Buxheti i Shtetit	**10. Operatorë Ekonomike 4:** **1**. OE ñE. A.ò Shpk **2**. BOE ñA. K.ò Shpk & ñE.ò Shpk **3**. OE ñM.ò Shpk **4**. OE ñA.ò Shpk
11. Ankimime AK	12. Përgjigje Ankesës nga AK	**13. Përgjigje** KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës nr. 2316, datë 24.09.2018	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** 5,927,995 lekë	**16.** Titullari i AK: N. Sh.

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditimi në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Në dosjen e prokurimit gjendet shkresa me nr. 13526 Prot., datë 13.07.2018 (me nr. 1750 Prot., datë 17.07.2018 në Bashkinë Përmet) nga Ministria e Financave *"Për trasferim fondesh për Njësitë e Vetqeverisjes Vendore", në paragrafin e fundit citohet: "Afati i fundit për lidhjen e kontratës është data 1 Tetor 2018. Në rast se brenda kësaj date nuk është lidhur kontrata, fondet do të rialokohen dhe Bashkia humbet të drejtën e përfitimit të fondeve për vitin 2018."*

Përllogaritja e fondit limit në shumën5,028,293lekë pa Tvsh.

Kjo procedurë prokurimi është mbështetur në projektin dhe preventivin e hartuar nga Zyra e Urbanistikës e Bashkisë Përmet, ark.E. M. miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. N. Sh. me vlerën **5,028,293** lekë pa Tvsh.

Preventivi përmbldhës:

Nr.	Emër Mbiemër	Vlera
1	M. B.	486,877
2	D. R.	197,720
3	D. J.	489,387
4	S. F.	496,297
5	V. F.	463,017
6	A. F.	481,100
7	V. F.	445,648
8	Rr. R.	456,260
9	F. R.	467,176
10	I. F.	460,741
11	N. L.	485,477
	Shuma II	**4,929,700**
	Fondi rezervë 2%	98,594
	Shuma II	**5,028,294**
	Tvsh 20%	**1,005,659**
	TOTALI	**6,033,952**

Nga auditimi i kësaj praktike rezultoi se:

Zërat e preventivit përgjithësisht janë hartuar referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, që përdoren në përcaktimin e fondit limit të objekteve në ndërtim, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, datë 15.07.2015 i ndryshuar

Në Relacionin teknik të formuluar nga Zyra e Urbanistikës *(Pa datë e pa numër Protokolli)* Ky projekt parashikon rikonstruksionin e pjesshëm të banesave të komuniteteve të pafavorizuara, të shperndara në teritorin e Bashkisë Përmet në Njësinë Administrative Piskovë. Për Pjesên më të madhe të këtyre banesave nevoja për financim për rikonstruksionin e tyre është më e madhe se fondi i percaktuar dhe nisur nga kjo (në bashkerendim edhe me banorët) projekti ynë parashikon kryerjen e punimeve që banorët nuk mund ti realizojnë vetë, siç është ndërtimi i çative të reja, përforcimi i muraturave të gurit, vendosje dyer dritare.
Në përgjithësi ndërhyrjet parashikojnë
-Rehabilitim/përforcim i banesave ekzistuese të cilat paraqesin
a) Rrezik shëmbje të çative e tavanëve.
b) Banesa të cilave u mungojnë dyert e dritaret ose janë tepër të amortizuara.
Të dhëna të gjëndjes aktuale
Banesat ku jeton komuniteti egjiptian në Përmet janë godina të vjetra. Janë godina një katëshe (ndonjëhere kolektive) të amortizuara. Ndërtesat janë të ndërtuara në përgjithësi me mure guri me gjerësi 50-60 cm. Çatitë janë me kapriata druri të mbuluara me materiale të ndryshme si eternit, tjegulla, letër katrama etj. Shtresat e dyshemeve janë me llustër çimento, ose tokë e fortë, Dyert dhe dritaret janë prej druri. Suvatimet në disa banesa mungojnë, në disa të tjera kanë humbur funksionin për shkak të lagështisësë theksuar.Të gjithë elementët e çatisë dhe tavanet janë tejet të amortizuara dhe kanë nevojë emergjente për ndërhyrje.
Nëpërmjet këtij projekti realizohet rikonstruksioni i 11 banesave/apartamenteve, duke u siguruar banorëve kushte më të mira jetese. Realizimi i këtij financimi u jep mundësi banorëve që në të ardhmen të kryejnë pjesë pjesë, punimet e tjera të nevojshme, duke bërë kështu që banesa të jetë në funksion të plotë.
Nga grupi i auditimit u kërkua procedura e përzgjedhjes së familjeve që përfitonin nga zbatimi i nga projektit, nga ana e Bashkisë Përmet nuk u paraqit asnjë dokumentacion që të provonte mënyrën dhe procedurën e sipërshënuar.
Në dosjen e prokurimit gjenden:
-. Urdhëri nr.158 e nr. 1907 Prot., datë 01.08.2018 i Titullarit të AK *"Për hartimin e fondit limit, specifikimetteknike"*
-. Preventivi me çmime i hartuar nga Zyra e Urbanistikës dhe planimetrit e shtëpive që do rikonstruktohen,
-. Specifikimet teknike,
-. Relacion teknik
- Grafiku i punimeve,
- Urdhëri nr. 159 e nr. 1908 Prot., datë 01.08.2018, i Titullarit të AK ñ*Për krijimin e Njësisë së Prokurimit"*, e përbërë: z. L. M. (Jurist), z. E. M. (Arkitekt) e znj. B. Z. (Ekonomiste). Bashkangjitur: Deklaratat nga antarët e Njësisë së Prokurimit që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interest.
- Urdhëri nr.160, e nr.1909 Prot., datë 01.08.2018 i Titullarit të AK ñPër krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertaveò. Bashkangjitur: Deklaratat nga antarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave që nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të ineresit.
Dokumentet e tenderit.
-. Procesverbali i datës 01.08.2018 nga NJP, për justifikimin e kritereve të vendosura në DT, miratuar nga Titullari i AK z. Niko Shupuli.
Mungesa e argumentimit të kritereve të veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk janë në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, në kundërshtim me nenin 46 të LPP si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 26 dhe neni 61, ñHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2, paragrafi 2, si:

ñPër hartimin e kërkesave për kualifikim jo në përputhje me nenin 26, pika 5 të VKM nr. 914, datë 24.12.2014 ñPër rregullat e Prokurimit Publikò sipas të cilit

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës."

Në DT janë kërkuar: Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë: Pika 2.2.4
Në rast se operatori ekonomik ofertues rezulton debitor ndaj Bashkisë Përmet do të përbëj shkak për skualifikim, për këtë duhet të paraqesi deklaratë me shkrim se nuk është debitor ndaj AK Bashkia Përmet.*(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomike ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit).*
Kërkesa është në kundërshtim me nenin 46, pika 1, e LPP ku përcaktohet se ñ*1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jo diskriminuese"*, për rrjedhojë legjislacioni i prokurimit publik kërkon që kriteret e kualifikimit duhet të jenë të qarta dhe të mirë përcaktuara nga AK, me qëllim që të jenë sa më të mirkuptueshme jo vetëm nga OE por edhe në funksion të procesit të vlerësimit. AK ka informacionin e nevojshëm në lidhje me detyrimet që OE mund të kenë në Bashki.Në këtë kuptim kërkesa e AK për paraqitjen e kësaj deklarate konsiderohet e panevojshme për ofertuesit pjesëmarrës në këtë procedurë.
- Procesverbal i datës 01.08.2018 *"Për përcaktimin e operatorëve ekonomik që do të ftohen në procedurën eprokurimit",* nga NP ku ju është dërguar ftesë për pjesëmarrje OE: 1. ñH.ò Shpk; 2. ñE.ò Shpk; 3. ñR.ò Shpk; 4. ñM.ò Shpk e 5. ñA.ò Shpk.
Bashkangjitur *"Njoftimi i operatorëve ekonomik nga faqja e APP".*
Në dosjen e prokurimit gjendej: E-mail i ardhur nga kordinatori i APP të personi autorizues i NJP, të Bashkisë Përmet në datën 8 Gusht ora 3:13 përndryshim të dokumentave të tenderit,
Modifikim dhe sqarime në dokumentat e tenderit me objekt: *"Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara".*
Nga monitorimi që ka kryer APP në sistemin elektronik, ka rekomanduar të bëhen ndryshime në DT përmes hartimit të një shtojce e cila u është komunikuar të OE në SEP.
APP ka sjell në vëmendje të të AK që të mbahen në konsideratë parashikimet e nenit 46 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014,ku çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Vendosja e çdo kriteri të veçantë, duhet të jetë e mirëargumentuar dhe e dokumentuar, konform parashikimeve ligjore.

Te Kapaciteti Ekonomik	
Ishte:	**Bëhet:**
2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitet (2016-2017-2018), në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij, (Sipas ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatori ekonomik lëshuar nga QKB).*(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit).*	**2.2.3** Vërtetim për shlyerjen e taksave ,tarifave dhe detyrimeve vendore për vitet (2015-2016-2017), në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tij, (Sipas ekstraktit të thjeshtë dhe historik të operatori ekonomik lëshuar nga QKB).*(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit).*
Te Kapaciteti Teknik	
Ishte:	**Bëhet:**
2.3.7 Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën	2.3.7 Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve ne pronesi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën
Emri i mjetit | Njesi | Sasi	Emri i mjetit | Njesi | Sasi

Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri ne 10 ton)	cope	2	Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri ne 10 ton)	cope	2
Kamioncine	cope	1	Kamioncine	cope	1
Autovinç	cope	1	Autovinç	cope	1
Betoniere	cope	3	Betoniere	cope	3
Gjenerator	cope	1	Gjenerator	cope	1
Skela	m²	200	Skela	m²	200

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: - Kokore minimumi 10 (dhjetë) copë - Jelekë minimumi 10 (dhjetë) copë - Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 2 (dy) copë - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 2 (dy) copë - Karroca dore minimumi 3 (tre) copë	Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: - Kokore minimumi 20 (njëzet) copë - Jelekë minimumi 20 (njëzet) copë - Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 2 (dy) copë - Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 2 (dy) copë - Karroca dore minimumi 3 (tre) copë
Ishte:	**Bëhet:**
2.3.5 Operatori/ët ekonomike duhet të kenë një punësim mesatar i të paktën 20 (njëzetë) personave për periudhën **Qershor 2017-Qershor 2018**, të vërtetuar me: ÅVërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Qershor 2017-Qershor 2018** . ÅListë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Qershor 2017-Qershor 2018**, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.	**2.3.5 Operatori/ët ekonomike** duhet të kenë një punësim mesatar i të paktën 20 (njëzetë) personave për periudhën **Qershor 2017-Qershor 2018**, të vërtetuar me: ÅVërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën **Qershor 2017-Qershor 2018** . ÅListë pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Qershor 2017-Qershor 2018**.
Ishte:	**Bëhet:**
2.4.1 Operatori/ët ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001 ñ*Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë*ò, i ndryshuar me VKM Nr. 742, datë 6.11.2003 "Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë" Për të cilin të paraqiten: Kontrate pune e vlefshme Diplomë CV Librezë pune Urdher Mjeku Të figurojnë në listëpagesën e shoqerise për periudhën **Qershor 2017-Qershor 2018**.	**2.4.1** Operatori/et ekonomike ofertues duhet të ketë në stafin e tij 1 (një) mjek në bazë të paragrafit 12/2 të VKM nr. 692, datë 13.12.2001 *"Për Masat e Vecanta të Sigurimit dhe Mbrojtjes së Shëndetit në Punë"*, i ndryshuar me VKM nr. 742, datë 6.11.2003 "*Për masat e veçanta të sigurimit dhe të mbrojtjes së shëndetit në punë"* Për të cilin të paraqiten: Kontrate pune e vlefshme Diplomë Urdhër Mjeku Të figurojnë në listëpagesën e shoqerise për periudhën **Qershor 2017-Qershor 2018**.
Hapja e Ofertave Ishte:	**Hapja e Ofertave Bëhet:**
Data 13.08.2018; Ora 09:00	Data 17.08.2018; Ora 09:00

Në dokumentet e këtij tenderi në sistemin elektronik AK nuk ka zbatuar rekomandim e APP ï së për pikën 1:ndër të tjera janë konstatuar se:

Në shtojcën 10 të DT, AK ka kërkuar: *Operatori ekonomiknuk është fitues dhe/apo kanë proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP-së, i cili në çastin e hapjessë ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës.*

Nuk është marrës në konsidederatë dhe nuk është pasqyruar në ndryshimet e DT, se kjo kërkesë është shfuqizuar me VKM nr. 80, datë 14.02.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, të ndryshuar dhe është shtuar: *Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës*

periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponokandidati, sipas licencés profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim tëpërcaktimit të mësipërm, fjala "periudhë" nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

Për mangësitë e konstatuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e NHJDT të përbërë nga z. L. M., z. E. M. e znj. B. Z.

Mbi observacionet e paraqitura nga Bashkia Përmet përProjekt Raportin e Auditimit

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 3561/2 prot., datë 21.12.2021 dërguar në e-mailin zyrtar nga, *anëtarët e Njësisë së Prokurimit:z. L. M., z. E. M. e znj. B. Z. në lidhje me Projekt Raportin* e Auditimt të KLSH-së

Pretendimet e subjektit:

<u>Së pari:</u>…… Lidhur me pretendimin e grupit të audituesve se kërkesa për nënshkrimin e deklaratës se nuk është debitor nga Bashkia Përmet përbën pengesë dhe frenon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike nuk qëndron për këto arsye:

<u>Së pari vendosja i këtij kriteri</u>, në këtë procedurë prokurimi, është terësisht i ligjshëm dhe i mbështetur në Rregullat e Prokurimit Publik.

Aplikimi i këtij kriteri është i mbështetur ligjërisht për shkak se i jep mundësinë KVO të skualifikojë operatorët që mund të jenë debitorë të natyrave të ndryshme pranë AK.

Nëse nuk do aplikohej ky kriter atëherë çdo operatori qoftë edhe debitor i lind e drejta të paraqesë ankim për skualifikim të paligjshëm për shkak se KVO-ja do të përdorte një kriter i cili nuk është përcaktuar në DT.

Qëndrimi i Audituesit të KLSH:*Në lidhje me pretendimet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:* Grupi i auditimit nuk është shprehur kundër vendosjes së kushtit: *<u>"debitor- apo mos pagimi i taksave dhe tarifave vendore është kusht për skualifikim "</u>* jemi shprehur për ñ..deklaratën me shkrim se nuk është debitor...ò.

Ju i referoheni DST, por APP si organ legjitim i botimit të Dokumenteve Standarte të Tenderit (DST), në asnjë rast nuk ka përdorur një kërkesë si kjo që ju keni përdorur në Dokumentat e Tenderit (DT) të sipërcituar.

Kërkesa për pagesat e taksave dhe tarifave vendore, në çdo vend ku ushtron OE ushtron aktivitet nuk e përjashkton bashkinë Përmet, nuk e pengon as aktivitetin e KVO-së.

Kërkesa në pikën 2.2.3 Te Kapaciteti Ekonomik: ñVërtetim për shlyerjen e taksave, tarifave dhe detyrimeve vendore për vitet (2016-2017-2018), në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ka selinë dhe ku ka zhvilluar apo zhvillon veprimtarinë e tijò është e mjaftueshme në opinionin e grupit te auditimit..

Në lidhje me kundërshtit e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se, argumentimi juaj për këtë pjesë të obsevacionit nuk qëndrojë e pasqyrohen në Projektraportin e auditimit.

Pretendimet e subjektit:

<u>Së dyti</u> audituesit janë shprehur se NjP nuk ka zbatuar rekomandimet e APP-së për pikën 1 ndër të tjera janë konstatura se:

Në shtojcën l0 të DT, AK ka kërkuar: *"Operatori ekonomik nuk është fitues dhe/apo ka në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP-së, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës.* Nuk është marrë në konsideratë dhe nuk është pasqyruar në DT, se kjo kërkerkesë është shfuqizuar me VKM nr. 80, datë 14.02.2018 ñ*Për disa shtesa dhe ndryshime të VKM nr. 9l4, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"* i ndryshuar dhe është shtuar ñVetdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me

vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % të kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të leshuar nga autoriteti kompetent.
Lidhur me pretendimin e grupit të audituesve së NJP nuk ka reflektuar të gjitha rekomandimet e APP-së nuk jemi dakort.Shtojca 10 nuk ka qenë pjesë e kritereve të përgjithshme të kualifikimit apo e kritereve të veçanta të kulifikimit duke ju referuar dokumentave standarte të tenderit që është hartuar nga AK Bashkia Përmet. ***Kjo shtojcë nuk ka qën kriter për tu plotësuar nga operatorët ekonomik dhe për tu kualifikuar në këtë procedurë prokurimi publik.***

Qëndrimi i Audituesve të KLSH:*Në lidhje me pretendimet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:Shtojca 10 e DT është pjesë e Dokumentave të Tenderit. Arsyetimi i grupit të auditimit nuk ka lidhje thjeshtë dhe vetëm me rekomandimine APP-së, por kemi të bëjmë me një kërkesë (siç shpreheni në observacion) që është e shfuqizuar me VKM nr.80.*
Pretendimet tuaja të përsëritura merren pjesërisht në konsideratë nga grupi i auditimit, dhe trajtohen në materialin e auditimit.

Formulari i Njoftimit të Fituesit më date 18.09.2018, Botuar në Buletini nr. 38, datë 24 Shtator 2018 Agjencia e Prokurimit Publik faqet 240-241/546
Kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:
1. OE "E. A." Shpk, (me Nipt,K66613407HV), me vlerë ekonomike të ofertës: **4,774,744 lekë pa Tvsh**, dhe 5,729,693 lekë me Tvsh.
2. BOE "A. K." Shpk & "E." Shpk, (me Nipt-e respektive K02017003I dhe J99016203O), me vlerë ekonomike të ofertës: **4,939,996 lekë pa Tvsh**, dhe 5,927,995 lekë me Tvsh.
3. OE "M." Shpk ,(me NIPT J66702413V), me vlerë ekonomike të ofertës **4,355,461** lekë pa Tvsh dhe 5 226 553 leke me tvsh.
4. OE "A." Shpk, (me NIPT J66703306O), me vlerë ekonomike të ofertës **4,069,428 lekë pa Tvsh** dhe 4 883 314 lekë me Tvsh.
Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1. OE "M." Shpk (me Nipt J66702413V), me vlerë ekonomike të ofertës **4,355,461** *(katër milion e treqind pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e gjashtëdhjeyë e një)* **lekë pa Tvsh** gjatë vlerësimit të ofertave ështe tërhequr nga procedura me anë të një kërkesës me nr. 2173, datë 07.09.2018, drejtuar AK Bashkia Për këtë arsye KVO ka ndërprer vlerësimin për këtë ofertues duke e skualifikuar.
2. OE "A." Shpk (me Nipt J66703306O), me vlerë ekonomike të ofertës **4,069,428** *(katër milion e e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e njëzetë e tetë)* **lekë pa Tvsh** gjatë vlerësimit të ofertave është tërhequr nga procedura e prokurimit me anë të kërkesës me nr. 2193, datë 07.09.2018 drejtuar AK Bashkia Përmet. Për këtë arsye KVO ka ndërprer vlerësimin për këtë ofertues duke e skualifikuar.
3. OE "E. A." Shpk (me Nipt J66613407H) me vlerë ekonomike të ofertës **4,774,744** *(katër milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e karër mijë e katërqind e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër)* **lekë pa Tvsh**, gjatë vlerësimit të ofertave është tërhequr nga procedura e prokurimit me anë të kërkesës nr. 2194/1, datë 10.09.2018, drejtuar AK Bashkia Përmet. Për këtë arsye KVO ka ndërprer vlerësimin për këtë ofertues duke e skualifikuar.
Oferta të kualifikuara:
1. BOE "A. K." Shpk & "E." Shpk, (me Nipt-e respektive K.I dhe J.O), me vlerë ekonomike të ofertës; **4,939,996 lekë pa Tvsh.**
Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i dokumentacionit të ofertës së këtij BOE të paraqitur për këtë procedurë prokurimi KVO vlerëson se plotësohen këresat e AK te kritereve të përgjithëshme, adminsitrative, ligjore teknike ekonomike e financiare nga ky BOE dhe bazuar në nenin 53 pika 3. të LPP, KVO e kualifikon këte ofertë, si një ofertë që plotëson kërkesat e AK për këtë kontrate.

Nga KVO më datë 18.09.2018 është formuluar/nënshkruar; Raporti Përmbledhëspër procedurën e prokurimit me objekt:"*Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara"*
Në datën 17.08.2018, ora 09.00 e përcaktuar në DT, si afati fundit i pranimit të ofertave, KVO, pasi u njoftua nga NJP për përfundimin eafatit të dorëzimit të ofertave, ka filluar procedurën e hapjes dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave përprocedurën e prokurimit.
Bazuar në Udhëzimin nr.3, datë 09.05.2017 "*Për shqyrtimin dhe vlerësimine ofertave në sistemin e prokurimit elektronik"* të APP, anëtarët e KVO punuanindividualisht në sistem për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të paraqitura.
Në përfundim: Pas tërheqjes nga procedura të ofertave të tyre nga OE 1- ñM.ò Shpk; 2- ñA.ò Shpkdhe 3-ñE.ò Shpk, KVO, vijon me kualifikimin e ofertës së mbetur,bazuar në nenin 46, pika 1 e Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për prokurimin publik",* i ndryshuar, kuparashikohet shprehimisht:*"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenëpërmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë nëpërpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese"*; si dhenë nenin 53/3 të LPP-së, ku parashikohet se: *"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtijneni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimete përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentate tenderit.."*
Bazuar në nenin 56 të LPP dhe Udhëzimin nr.3, datë 09.05.2017 *"Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në sistemin e prokurimit elektronik"* të APP, KVO, bëri kontrollin për gabime matematikore të ofertave të kualifikuara si më sipër, ku konstatoi se nuk gjeti gabime në asnjë ofertë të kualifikuar si dhe nuk janë ofertaanomalisht të ulëta.
Bazuar në nenin 55 të LPP pika e parë *"Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese"*
Oferta fituese duhet të jetë:*a) oferta që, në bazë të kërkesave dhe kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit, plotëson kërkesat eobjektit të prokurimit me çmimin më të ulët.*
Në zbatim, sa më sipër KVO-ja përcaktoi renditjen përfundimtare të ofertave të kualifikuara si me poshtë:
Në vend të parë KVO klasifikon BOE ñE.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës; 4,959,996 lekë pa Tvsh dhe 5,927,995 lekë me Tvsh, si ofertë fituese, pasi ajo është në përputhje me tëgjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në DT, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 53 të këtij ligji.
Pas këtij procesi antarët e KVO-së, përfunduan në sistem procedurën e vlerësimit me statusin ñe përfunduarò dhe ka njoftuar Njësinë Prokurimit për të vijuar procedurën e fazave të tjera për këtë procedurë.
Pas gjenerimit të klasifikimit në sistem dhe përfundimit të afatit të ankimimit KVO, ka hartuar Raportin Përmbledhës me anën e të cilit ka vendosur:
Të pranojë ofertën e BOE ñE.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk, me vlerë ekonomike të ofertës:4,939,996 lekë pa Tvsh dhe 5,927,995 lekë me Tvsh, e renditur në vend të parë fituese te B.O E.
2. Ti rekomandojë Titullarit të AK miratimin e ofertës të BOE ñE.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk.
Në datë 29.07.2019 është arkivura dosja e procedurës së prokurimit publik me objekt: *"Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara",* në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 *"Për Arkivat";* Vendimit nr.4, datë 19.06.2017 ñ*Për miratimin e rregullores së njesuar të punës me dokumente në autoritetet publik tëRepublikës së Shqipërisë"; si dhe të normave tekniko-profesionale dhe medologjike të shërbimit arkivornë Republikën e Shqipërisë.*
Kontrata nr. 2316 Prot., datë 24.09.2018, me objekt: **"***Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitete të pafavorizuara", Bashkia Përmet*, e lidhur ndërmjet palëve: Bashkisë Përmet përfaqsuar nga z. N. Sh. dhe BOE ñE.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk përfaqësuar nga administratori i ñE.ò Shpk z. A. J.. Vlera totale e kontratës *(në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës)* është **4,939,996** (*katër million e nëtë qind e*

tridhjetë e nëntë mijë e nëtë qind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë pa Tvsh dhe 5,927,995 lekë me Tvsh**.** BOE do të kryejë punimet e sipërcituar duke filluar nga data 24.09.2018

Auditimi i ofertës fituese të BOE: ñE.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk

Nga auditimi rezulton se ky BOE ka lidhur kontratë bashkëpunimi të përkohëshme. Në këtë kontratë me nr.7091 Rep., e nr. 2832 kol., datë 03.08.2018, ka përcaktuar përqindjen e punimeve:

- 29 % për OE A. K.ò Shpk
- 71 % për OEñE.ò Shpk

OE A. K.ò Shpk me prokurën e posçme nr. 7092 rep., nr. 2833 Kol, datë 03.08.2018, ka autorizuar OEñE.ò Shpk si përfaqësues në objektin e prokuruar.

<u>OE "E." Shpk ka mangësi në dokumentacioni e paraqitur në SPE:</u>

a. Liçenca profesionale e OE ñE.ò Shpk me nr. NZ 3374/6, datë 06.04.2019, me Drejtues Ligjor: B. M., Drejtues Teknik: L. L., nuk përmbush pikën 2.3.2 të Kapcitetit Teknik.

Liçenca profesionale e shoqërisë lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës te kategorive dhe niveleve:

Punime të përgjithshme ndërtimi

3.NPï 12 A Punime të Inxhinierisë së Mjedisit

Punime speciale ndërtimi

3. NS-14 A Impiante të brendeshme,elektrike,telefoni, radiotelefoni TV etj. *(sipas modelit të lëshuar nga MPPT/MTI)*

b. Në pikën 2.3.të Kapcitetit Teknik është kërkuar:

2.3.3 Operatori ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin drejtues teknik minimumi

1 (një) inxhinier ndërtimi; *<u>OE 'E." Shpk, plotëson vetëm këtë kërkesë ing. ndërtimi</u>*)

1(një) inxhinier elektrik

1 (një) inxhinier mjedisi

Inxhinierët e sipërcituar duhet të figurojnë si drejtues teknik në liçencën e operatorit ekonomik ofertues dhe në listëpagesën e shoqërisë për periudhën **Qershor 2017-Qershor 2018** .

Për secilin duhet të paraqiten: *<u>(nga OE janë paraqitur dokomentacioni vetëm për Lindita Lamçe</u>*

- Å Kontratë pune e noterizuar
- Å Diploma
- Å CV-të
- Å Librezë pune

c. Në pikën 2.3.6 të Kapcitetit Teknik është kërkuar:

2.3.6 .Operatori/ët ekonomike duhet të kenë në stafin e punonjësve të pasqyruar në list pagesat e shoqërisë për periudhen Qershor 2017-Qershor 2018 të pakten (trembëdhjetë) punonjes të kualifikuar me Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga ISHTI, ose nga një trup çertefikuese e akredituar në RSH-së, nga të cilët të jenë:

Elektricist	(2 persona)
Hidraulik	(1 person)
Bojaxhi	(2 persona)
Shtrues pllakash	(1 person
Suvatues	(1 person
Karpentier	(2 persona
Vinçier	(1 person

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë pune e vlefshme (përkatëse)
- Dëshmi Kualifikimi të Sigurimit Teknik e lëshuar nga një trup çertefikuese e akredituar në RSH-së.
- Librezë pune

Për manovratorin vinçier të paraqitet edhe dëshmia e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë e lëshuar nga DPSHTRR dhe leja e drejtimit ku të disponohet minimumi kategoria C

d. Në pikën 2.3.7 të Kapcitetit Teknik është kërkuar:

2.3.7 Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund tâi vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën

1. Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës deri ne 10 ton) - 2 copë

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Në këto kushte, KVO duhet ti kishte propozuar Titullarit të AK, anulimin e kësaj procedure prokurimi. Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e BOE ñE.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DT ka shkaktuar paligjshmëri në përdorimin e fondeve publike, në vlerën **5,927,995 lekë me Tvsh** dhe ngarkon me përgjegjësi KVO e përbërë nga: **z. Ll. Th., z. F. L. e z. Th. K.**

Titulli i Gjetjes 14:	Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik në shpalljen e ofertës fituese, në tenderin e zhvilluar me objekt: *"Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara"* Bashkia Përmet
Situata:	Mungesa e argumentimit të kritereve të veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk janë në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit. Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, neni 46, pika 1 dhe kërkesat e VKM-së 914, datë 24.12.2014 ñPër rregullat e Prokurimit Publikòneni 26, pika 5. Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik, dhe shpallja fitues e BOE ñE.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DT.
Kriteri:	Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik
Impakti:	Ndikim negativ në buxhetin e bashkisë Përmet në përdorimin e fondeve publike, në vlerën 5,927,995 lekë me Tvsh.
Shkaku:	Mos njohja dhe mos zbatimi i kuadrit rregullator nga KVO
Rëndësia:	**E lartë**
Rekomandime:	Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masa për përcaktimin e DTnë përputhje me përcaktimet ligjore dhe për eliminimin e këtyre praktikavetë shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret emiratuara në DT.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: Titullari i Autoritetit Kontraktor z. N. Sh.; Njësia e Prokurimit Publik: z. L. M., z. E. M. e znj. B. Z.; Komisioni i Vlerësimit të Ofertave: z.Ll. Th., z. F. L. e z. Th. K.

<u>Konkluzioni</u>: Kualifikimi i BOE ñE.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk**,** nuk është në kushtet e plotësimit tëdispozitave ligjore/nënligjore të LPP, pasi OEñE.ò Shpk nuk plotëson disa nga kriteret e DT. Në kushtet kur nuk ka OE të tjetër pjesëmarrës në garë, KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë të re, duke analizuar shkaqet e dështimit të procedurës dhe përmisimin e kritereve, kritere të cilat kanë çuar në uljen e numrit të pjesëmarrësve, për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondit në vlerën **5,927,995 lekë me Tvsh**.

4. Auditim mbi zbatimin e punimeve, deri në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve dhe zbatimi i kontratave të punëve publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim.

1.*"Rikonstruksion i shkollës së mesme "Sami Frashëri" Përmet"*

Kontratat.
- Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 547 Prot., datë 01.03.2019, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Përmet, të përfaqësuar nga Titullari z. N. Sh.dhe OE ñA. K.ò Shpk përfaqësohet me prokurë të posaçme nga administratori z. A. K., me licencë NZ. 0709/16. Vlera e kontratës është 81,490,378.838 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 8 mujore, nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit për objektin: ñ*Rikonstruksion i shkollës së mesme Sami Frashëri Përmet"*, është lidhur kontrata me nr. 931 Prot., datë 19.04.2019me OE ñM. S.ò Shpk, përfaqësuar nga z. T. S.me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1811/7, date 19.12.2017. Pagesa për mbikëqyrjen e punimeve është përcaktuar në shumën 744,264 lekë me Tvsh.
- Për shërbimin e kolaudimit të punimeve të ndërtimit për objektet*"Rikonstruksion i shkollës së mesme Sami Frashëri Përmet"*, është lidhur kontrata me nr. 115 Prot., datë 15.01.2020 me subjektin fizik L. Th., përfaqësuar nga Ing. L. Th. nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.0255, datë 05.04.2010. Pagesa për kolaudimin e punimeve është përcaktuar në shumën 0 lekë me TVSH.

Projektpreventivi
- Projekti i zbatimit është hartuar nga zyra e Urbanistikes në muaj janar. Viti 2018 dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë.
Në dosje administrohet leja e ndërtimit nr.1, datë 19.04.2019, Protokolluar me datë 19.04.2019.

Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet për objektin: ñ*Rikonstruksion i shkollës së mesme Sami Frashëri Përmet*ò, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 19.04.2019 dhe kanë përfunduar me datë 16.12.2019.
Aktdorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë bërë më datë 19.04.2019
-Me shkresën datë 19.04.2019 sipërmarrësi i punimeve ñA. K.ò Shpk dhe mbikëqyrësi i punimeve shoqëria ñM. S.ò Shpk dhe kanë formuluar ñProcesverbalin për ndryshimin e volumit të punimeveò për dijeni Investitorit Bashkisë Përmet me një këkesë mbi disa ndryshime (Relacion Teknik date 19.04.2019) në projektin e objektit: ñ*Rikonstruksion i shkollës së mesme Sami Frashëri Përmet", , Bashkia Përmet*.
Me Urdhrin nr. 6 Prot., datë 08.01.2020 të Titullarit të Autoriteti Kontraktor znj. A. H. është ngritur Komisioni i Marrjes në Dorëzim të Objektit:
Me procesverbalin nr. 114, datë 14.01.2020 është marr në dorëzim nga investitori Bashkia Përmet nga zbatuesi i punimeve ñA. K.ò Shpk, mbikqyrësi ñM. S.ò Shpk, kolaudatori z. L. Th.
- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit, preventivit bazë dhe të ndryshuar, Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, Ditarit të punimeve, etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

1. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion i shkollës së mesme "Sami Frashëri", Bashkia Përmet.

14.Lidhja e kontratës nr.547 Prot datë 01.03.2019	**15.Vlera e kontratës** 81,490,378.838 lekë me TvshOE fitues ñAlb Konstruksionò Shpk		**16.Likuiduar:** paraqitur hollësisht në aneksin e Raportit të Auditimit.	
17- Situacioni Përfundimtar -Vlera 29,731,269.95**lekë me tvsh**	**18.Afati i kontratës:** Parashikuar 8 muaj. Fillimi punimeve: 19.04.2019 Përfundimi punimeve sipas faktit: 19.12.2019 Përfundimi punimeve sipas kontratës: 16.12.2019		**19. Zgjatja e kontratës** Sôka	
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** OE ñM. S.ò Shpk	Licenca Nr: MK. 1811/7	Kontrata nr.931 Prot, datë 19.04.2019		
21. **Kolaudatori i punimeve** Ing. L. Th.	Licenca Nr: MK 0255	Kontrata me nr. 115Prot., datë 15.01.2020		
22.Akt Kolaudimi Datë 04.11.2020	**23.Akt i marrjes në dorëzim** dt 14.01.2020			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **338,321.77 lekë pa Tvsh.**

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësi	Çmimi ofertës	Situacio përfund	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
A-4	**Punime tarace**							
A-4.7	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingateØ100mm	nl	658	64.90	64.90	56.90	8.11	5,336.38
A.4.9	Kasetë shkarkimi me llamarinë xingato	copë	991	8	8	7	1	991
A.9	**Punime të ndryshme**							
A.9.1	F.V. Parmakë davancale mermeri cilësor t = 3cmm me pikore mga jashtë	m^2	5,835	104.45	104.45	t=2cm		203,164.39
B	**PUNIME PËR SISTEMIMME TË JASHTME: Sheshi para shollës**							
B.1.9	F.V.bordura betoni 15x30cm (në perimetrin e shkollës përreth sheshit)	ml	991	160	160	30	130	128,830
	Total							**338,321.77**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

- Zëri i Punimeve A.4 "Punime tarace", Nënzër i punimeve A-4.7 "Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingate Ø=100mm".

Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 64.90 ml **"**Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingate Ø=100mmò.me çmim 658 lekë/ml. Libreza e masave pasqyron 64.9 ml ñUlluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingate Ø100mmò. Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi është realizuar 56.90 ml. Sa më sipër, librezimi i zërit në sasinë 8.11 ml, është librezuar tepër,

- Zëri i Punimeve A.4 "Punime tarace", Nënzër i punimeve A-4.9 "Kasetë shkarkimi me llamarine xingat"

Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 8 copë kaseta me çmim 991 lekë/copa. Libreza e masave pasqyron 8 copë/kaseta. Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi është realizuar 7 copë. Sa më sipër, librezimi i zërit në sasinë 1 copë kaseta, është librezuar tepër, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.

-Zëri A.9 "Punime të ndryshme" Nënzëri A.9.1"F.V. Parmakë davancale mermeri cilësor t=3cmm me pikore mga jashtë"

Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 104.45m^2. **"**F.V. Parmakë davancale mermeri cilësor t=3cmm me pikore mga jashtëòme çmim 5,835 lekë/ m^2. Libreza e masave pasqyron 104.45 m^2., trajtuar në mënyrë analitike.Nga auditimi në objekt konstatohet

se, ky zë punimi është realizuar me metme me t=2cm. Sa më sipër, librezimi i zërit pa u kryer në fakt sipas përshkrimit në preventiv, është librezuar tepër për t=1cm, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në sipërfaqja e mermerit 104.45 m^2 me t=1cm, pra 1/3 e volumit të mermerit të situacionuar.

- ZëriB "Punime për Sistemimme të Jashtme: Sheshi para shkollës" Nënzëri B.1.9. ñF.V.bordura betoni 15x30cm (në perimetrin e shkollës përeth sheshit)ò

Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 160 ml ñF.V.bordura betoni 15x30cmòme çmim 991 lekë/ml. Libreza e masave pasqyron 160 mlñF.V.bordura betoni 15x30cmò, trajtuar në mënyrë analitike: Nga auditimi në objekt si dhe i pasqyrimit të këtij zëri në librezën e masave konstatohet se llogarotja është bërë gabim, sepse punë e realizuar në fakt rezulton 30 ml dhe jo 160 ml siç është situacionuar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve.

Sa më sipër trajtuar, diferenca prej 130 ml, në fakt, është librezuar tepër, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.

- ZëriB "Punime për Sistemimme të Jashtme: Sheshi para shkollës" Nënzëri B.1.4 "Pusetë shkarkimi b/a shiu 80x80 cm; h=150 cm"

Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 4 copë ñPusetë shkarkimi b/a shiu 80x80 me çmim 34,744 lekë/copë. Libreza e masave pasqyron 4 Puseta shkarkimi b/a shiu 80x80. Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi nuk është realizuarvetëm 1 copë. Sa më sipër, librezimi i zërit në sasinë 4 copë kapuç ajrimi, është librezuar 3 copë mëtepër, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, shoqërisë "M. S." Shpk, përfaqësuar nga ing. T. S.nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."*

- UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: ñ*Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*ò, në kundërshtim me kushtet e kontratës, ku citon se: ñ*Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit si dhe destinacionin e objektit. Ai është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit*ò. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 931Prot, datë 19.04.2019.

2. Nga ana e kolaudatorit të punimeve ing. L. Th., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, *ku përcaktohet se:"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"*

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *ku përcaktohet se:*
Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeveme nr. 115 Prot., datë 15.11.2020.

Vlera prej* 338,321.77 lekë pa Tvsh, *e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Përmet.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:* Z. T. S.,** me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes dhe **Z. L. Th.**, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.

2.*"Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkise Përmet dhe të Njësive Administrative", Bashkia Përmet.*

Kontratat.
- Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike menr. 3270 Prot, datë 24.12.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Përmet, të përfaqësuar nga Titullari z. N. Sh.dhe BOE: ñH.ò shpk përfaqësohet me prokurë të posaçme nga administratori A. H., me licencë NZ. 1246/9 dhe ñR.ò Shpk përfaqësohet me prokurë të posaçme nga administratori D. Ç., me licencë NZ. 0389/23 Vlera e kontratës është 94.712.204,00 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 mujore, nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit për objektin: ñ*Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkise Përmet dhe të Njësive Administrative"*, është lidhur kontrata me nr. 3270/1 Prot, datë 24.12.2018 me personin fizik Kostandin Isufi, përfaqësuar nga z. Kostandin Isufime nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0545/2, date 11/09/2018. Pagesa për mbikëqyrjen e punimeve është përcaktuar në shumën **0** lekë me Tvsh.
- Për shërbimin e kolaudimit të punimeve të ndërtimit për objektet*"Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkise Përmet dhe të Njësive Administrative"*, është lidhur kontrata me nr. 1951 Prot, 30.07.2019 me personin fizik L. Th., përfaqësuar nga Ing. L. Th. nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.0255/1, datë 05.04.2010. Pagesa për kolaudimin e punimeve është përcaktuar në shumën 0 lekë.

Projektpreventivi
- Projekti i zbatimit është hartuar nga shoqëria/zyra e Urbanistikës, Bashkia Përmet përfqësuar nga Ark. Elvjon Musaj në muajn Gusht viti 2018 dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë.
Në dosje administrohet leja e ndërtimit nr.8, datë 19.12.2018, Protokolluar me, datë 19.12.2018.

Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet për objektin: ñ*Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkise Përmet dhe të Njësive Administrative*ò, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 25.12.2018 dhe kanë përfunduar me datë 30.09.2019. Vonesa ne

zbatimin e punimeve me kerkese te supervizorit date 10.01.2019 nga data 24.12.2018-30.09.2019 ï 89 ditë, amendim kontrate Nr.266/1 Prot date 31.01.2019
Aktdorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë bërë më datë 25.12.2018.
-Me shkresën datë 27.05.2019, sipërmarrësi i punimeve BOE ñH.ò dhe ñR.ò shpk dhe mbikëqyrësi i punimeve shoqëris mbikqyrësi Ing K. I. kanë formuluar ñProcesverbalin për ndryshimin e volumit të punimeveò për dijeni Investitorit Bashkisë Përmet me një këkesë mbi disa ndryshime (kërkesë për miratimin e ndryshimeve në projekt preventiv) në projektin e objektit: ñ*Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkise Përmet dhe të Njësive Administrative, Bashkia Përmet*.

Me Urdhrin nr. 357 Prot., datë 16.10.2019 të Titullarit të autoriteti Kontraktor znj. A. H. është ngritur Komisioni i marrjes në dorëzim të objektit:
Me procesverbalin nr. 3703 Prot., datë 16.10.2019, është marr në dorëzim nga Investitori Bashkia Përmet E. M., A. T., L. B., zbatusi i punimeve ñH.ò Shpk, dhe ñR.ò Shpk, mbikqyrësi Ing. K. I., kolaudatori ing. L. Th.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë: Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekt i zbatimit fillestar dhe të ndryshuar, preventivit bazë dhe të ndryshuar, Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar, Libreza e masave, Ditarit të punimeve, etj.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

2. Zbatimi i Kontratës së Punimeve *"Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkise Përmet dhe të Njësive Administrative*				
14.Lidhja e kontratës Nr. 3270 Prot datë 24.12.2018	**15.Vlera e kontratës** 94.712.204,00 lekë me tvsh BOE fitues ñH.ò Shpk & R.ò		**16.Likuiduar:** Janë paraqitur hollësisht në paraqitur hollësisht në aneksin e Raportit të Auditimit.	
17- Situacioni Përfundimtar 58.175.990 lekë me tvsh	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 6 mujore. Fillimi punimeve: 25.12.2018 Përfundimi punimeve sipas DT		**19. Zgjatja e kontratës** 89 ditë deri me datë 22.02.2018.	
20. Mbikëqyrësi i punimeve Ing. K. I.	Licenca nr: MK. 0545/2	Kontrata nr.3270/1 Prot, datë 24.12.2018		
21. Kolaudatori i punimeve Ing. L. Th.	Licenca nr: MK 0255/1	Kontrata me nr.1951 Prot., datë 30.07.2019		
22.Akt Kolaudimi Datë .2019	**23.Akt i marrjes në dorëzim** dt 16.10.2019			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **182,542.84lekë pa Tvsh**.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmim oferte	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
	Punime Fshati Kosinë							
E	**Mure Pritës**							
An9	Mbushje me çakëll/ose zhavor lumi pas murit	m^3	1086	110	110	0	110	119,460
	Ndërtim mur betoni m-200	m^3	10170	93.562	93,562	87.3205	6,2415	63,082.84
							Total	**182,542.84**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Punime Fshati Kosinë
Zëri i punimeve E:Mure Pritës; Nënzëri An 9 "Mbushje me çakëll/ose zhavor lumi pas murit"
Preventivi i ndryshuar pasqyron 110m^{3}ñMbushje me çakëll/ose zhavor lumi pas muritò (96 m^3 sipas preventivit ofertues + 14m^3 volum i shtuar në preventivin e rishikuar). Situacioni përfundimtar, pasqyron 110m^{3}ñMbushje me çakëll/ose zhavor lumi pas murit, me çmim 1,086 lekë/m^3. Libreza e masave pasqyron 110 m^3 « Mbushje me çakëll ».
Në fakt, nga verifikimi në terren ky zë nuk është realizuar në objekt.

Zëri i punimeve E:Mure Pritës; Nënzëri 2.111/2 "Ndërtim mur betoni m-200"
Preventivi i ndryshuar pasqyron 93.562 m^{3}ñNdërtim mur betoni m-200ò(96 m^3 sipas preventivit ofertues- 14m^3 volum i hequr në preventivin e rishikuar). Situacioni përfundimtar, pasqyron 93.562m^3 ñNdërtim mur betoni m-200ò, me çmim 1,086 lekë/m^3. Libreza e masave pasqyron 93.562 m^3 ñNdërtim mur betoni m-200ò
Në fakt, sasia e përllogaritur është:

Sipas Libresës së masave		Nga matjet në terren	
39 mlx0.6m x 0,5m	11.7m^3	39 mlx0.28m x 0,5m	5.46 m^3
39ml x 0.25mx1.35	13.1625m^3	39ml x 0.25mx1.35	13.1625 m^3
37mlx0.5mx0.5m	9.25 m^3	37mlx0.5mx0.5m	9.25 m^3
37mlx0.25mx1.4m	12.95m^3	37mlx0.25mx1.4m	12.95 m^3
77.5mlx0.5mx0.5m	19.375 m^3	77.5mlx0.5mx0.5m	19.3755 m^3
77.5mlx2.5mx0.5m	27.123m^3	77.5mlx2.5mx0.5m	27.123 m^3
Shuma	**93.562**		**84.3205**
Diferenca			**6.2415**

Sa më sipër trajtuar, sipërmarrësi i punimeve BOEñH.ò Shpk& ñR.òShpk ka përfituar në mënyrë të pa drejtë **182,542.84lekë pa Tvsh.**

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 182,542.84lekë pa Tvsh**sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore dhe duhet të zhdëmtohet nga përfituesi, sipërmarrësi i punimeve.
Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:
1. Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, BOE Ing. K. I., nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."*
- UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: ñ*Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*ò, në kundërshtim me kushtet e kontratës, ku citon se: ñ*Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit si dhe destinacionin e objektit. Ai është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit*ò. - Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve nr. 37/1, datë 13.03.2017.

Vlera prej* 182,542.84*lekë pa Tvsh, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Përmet.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:* Z. K.I.,** me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes.

Mbi observacionet e paraqitura nga Bashkia Përmet për Projekt Raportin e Auditimit

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raporti Përfundimtar të Auditmit në e-mailin zyrtar në datë 20.12.2021, është dërguar observacion nga z. Konstandin Isufi, mbikqyrësi i punimeve në lidhje me zbatimin e punimeve me objekt: ñ*Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkise Përmet dhe të Njësive Administrative",* ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:
Zëri An 9 Mbushje me çakëll/ose zhavor lumi pas murit nuk është realizuar.
Konstatim i mësiperm ngelet për tu gjykuar na ana juaj.
Ky zëështë kreyr nga ana jonë treguar edhe nga fotot bashkangjitur, por duke qënë një punim i maskuar ngelet për tu gjykuar nga ana juaj.
Qëndrimi i Audituesve të KLSH: *Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:* Grupi i auditimit i është referuar auditimit në terren, e në praninë tuaj e ka shprehur gjykimin në lidhje me këtë zë punimesh.

Pretendimet e subjektit:
Nga auditet konstatohet se:Zëri 2.112 Ndërtim mur betoni m-200 ka një diferencë prej 39.26 m^3.
Konstatimii mësipërm nuk qëndron.
Sipas librezës së Masave Matjet në terren nga ana juaj

Sipas Libresës së masave		Nga matjet në terren	
39 mlx0.6m x 0,5m	11.7m^3	39 mlx0.28 x 0,5m	5.46 m^3
39ml x 0.25mx1.35	13.1625m^3	39ml x 0.25mx1.35	13.1625 m^3
37mlx0.5mx0.5m	9.25 m^3	37mlx0.5mx0.5m	9.25 m^3
37mlx0.25mx1.4m	12.95m^3	37mlx0.25mx1.4m	12.95 m^3
77.5mlx0.5mx0.5m	19.375 m^3	77.5mlx0.5mx0.5m	19.3755 m^3
77.5mlx2.5mx0.5m	27.123m^3	77.5mlx1.4mx0.5m	27.123 m^3
Shuma	**93.562**		**84.3205**
Diferenca			**6.2415**

Konstatimi juaj qëndron pasi nga rrillogaritja e matjeve volumet dalin me një diferencë prej6.2415 m^3.
Qëndrimi i Audituesve të KLSH:*Në lidhje me pretendimet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:*Nga grupi i auditimit është bërë një lapsus në lllogaritje, e cila reflektohet në raportin përfundimtar të auditimit. Më hollësisht në tabelën e sipërcituar.
Përsa më sipër observacioni juaj për Projekt Raportin e Auditimit me objekt: ñ*Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkise Përmet dhe të Njësive Administrative" merret parasysh pjesërishtdhe trajtohen në materialin e auditimit.*

3 *"Rikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht" Bashkia Përmet*

Kontratat.
- Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr. 1363 Prot., datë 04.06.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Përmet, të përfaqësuar nga Titullari z. N. Sh.dhe OE: ñH.ò Shpk përfaqësohet me prokurë të posaçme nga administratori A. H.ò, me licencë NZ. 1246/9. Vlera e kontratës është 3,799,989.60 lekë me Tvsh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 2 mujore, nga data e nënshkrimit të kontratës.
- Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit për objektin: ñ*Rikonstruksion e ndertime te urave ne fshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht"*, është lidhur kontrata me nr. 1388 Prot, datë 05.06.2018

me personin fizik K. I., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0545/2, date 11/09/2018. Pagesa për mbikëqyrjen e punimeve është përcaktuar në shumën **0** lekë.
- Për shërbimin e kolaudimit të punimeve të ndërtimit për objektet *"Rikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht""*, është lidhur kontrata me nr. 1388/1 Prot., datë 05.08.2018, me ing. D. Sh., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK.0910/2, datë 14.05.2018. Pagesa për kolaudimin e punimeve është përcaktuar në shumën 0 lekë.

Projektpreventivi
- Projekti i zbatimit është hartuar nga Zyra e Urbanistikës përfaqesuar nga Ark. E. M. në muajn Prill. Viti 2018 dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë.
Në dosje administrohet leja e ndërtimit nr. 5, datë 05.06.2018, Protokolluar me datë 05.06.2018.

Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet për objektin: ñ*Rikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht*ò, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 05.06.2018 kanë përfunduar me datë 05.08.2018.
Aktdorëzimi i sheshit të ndërtimit dhe njoftimi i fillimit të punimeve janë bërë më datë 05.06.2018
-Me shkresën datë 20.06.2018 sipërmarrësi i punimeve ñH.ò Shpk, dhe mbikëqyrësi i punimeve z. Kostandin Isufi kanë formuluar ñProcesverbalin për ndryshimin e volumit të punimeveò për dijeni Investitorit Bashkisë Përmet me një këkesë mbi disa ndryshime (kerkese per miratim ndryshimesh ne projekt preventiv) në projektin e objektit: ñ*Rikonstruksion e ndërtime tëurave nëfshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht*ò, *Bashkia Përmet*.

Me Urdhrin nr. 1388/2 Prot., datë 06.08.2018 të Titullarit të Autoriteti Kontraktor z. N. Sh. është ngritur Komisioni i marrjes në dorëzim të objektit:
Me procesverbalin nr.1388/3 Datë10.08.2018është marr në dorëzim nga Investitori Bashkia Permet (E. M., L. B., B. V., R. B., P. S. zbatuesi i punimeve ñH.ò Shpk, mbikqyrësi K. I. dhe kolaudatori Ing. D. Sh.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

3. Zbatimi i Kontratës së Punimeve *""Rikonstruksion e ndërtime të urave në fshatrat Zhepe, Kutal, Verçisht",*Bashkia Përmet.				
14.Lidhja e kontratës nr. 1363 Prot datë 04.06.2018	**e kontratës**3,799,989.60lekë me Tvsh OE fitues ñH.ò Shpk		**16.Likuiduar:** paraqitur hollësisht në aneksin e Raportit të Auditimit.	
17- Situacioni Përfundimtar **-Vlera** 29,731,269.95 **lekë me tvsh**	**18.Afati i kontratës në dite** Parashikuar 2muaj. Fillimi punimeve: 05.06.2018 Përfundimi punimeve sipas faktit 05.08.2018 Përfundimi punimeve sipas kontratës 05.08.2018:		**19. Zgjatja e kontratës** Sôka	
20. **Mbikëqyrësi i punimeve** K. I.	Licenca Nr: MK 0545/2/7	Kontrata nr.1388 Prot, datë 05.06.2019		
21. **Kolaudatori i punimeve** Ing. D. Sh.	Licenca Nr: MK 0910/2	Kontrata me nr. 1388/1 Prot., datë 05.08.2018		
22.Akt Kolaudimi Datë 04.11.2020	**23**.**Akt i marrjes në dorëzim** dt 10.08.2020			

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti

Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **285,960 lekë pa Tvsh**.

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmim ofertë	Situacio përfund	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
I	**Ura Pasarel Zhepe**							
1.An	Përgatitje e montim litarë çeliku d=14mm	Kg	270	144	144	-	144	38,880
3.An	F.V Morseta	Copë	450	72	72	-	72	32,400
4.An	F.V Tiranda d=1mm	Kg	200	173	173	-	173	34,600
5. An	F.V. Kavallota	Kg	350	173	173	-	173	60,550
II	**Ura Pasarel Kutal**							166,430
1.An	Përgatitje e montim litarë çeliku d=14mm	Kg	270	144	144	-	144	38,880
3.An	F.V Morseta	Copë	450	72	72	-	72	32,400
4.An	F.V Tiranda	Kg	200	173	173	-	173	34,600
5. An	F.V. Kavallota	Kg	350	39	39	-	39	13,650
								119,530
	Total							**285,960**

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

Zëri I "Ura Pasarel Zhepe" Nënzëri 1.An "Përgatitje e montim litarë çeliku d=14mm"Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 144 kgpërgatitje e montim litarë çeliku,me çmim 270 lekë/kg. Libreza e masave pasqyron 144 kgpërgatitje e montim litarë çeliku.Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi nuk është realizuar fare. Sa më sipër, librezimi i zërit në sasinë 144 kg, është librezuar tepër, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri I "Ura Pasarel Zhepe" Nënzëri 3.An "F.V Morseta"Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 72 copëF.V Morseta,me çmim 270 lekë/kg. Libreza e masave pasqyron 72 copë F.V Morseta Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi nuk është realizuar fare. Sa më sipër, librezimi i zërit në sasinë 72 copë morseta, është librezuar tepër, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri I "Ura Pasarel Zhepe" Nënzëri 4.An "F.V Tiranda d=14mm"Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 173 kgF.V Tiranda,me çmim 200 lekë/kg. Libreza e masave pasqyron 173 kgTiranda.Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi nuk është realizuar fare. Sa më sipër, librezimi i zërit në sasinë 173 kg tiranda, është librezuar tepër, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri I "Ura Pasarel Zhepe" Nënzëri 5.An "F.V. Kavallota"

Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 173 kgF.V. Kavallota,me çmim 350 lekë/kg. Libreza e masave pasqyron 173 kgpërgatitje e montim litarë çeliku.Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi nuk është realizuar fare. Sa më sipër, librezimi i zërit kavallota në sasinë 173 kg, është librezuar tepër, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri II "Ura Pasarel Kutal" Nënzëri 1.An "Përgatitje e montim litarë çeliku d=14mm"Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 144 kgpërgatitje e montim litarë çeliku,me çmim 270 lekë/kg. Libreza e masave pasqyron 144 kgpërgatitje e montim litarë çeliku.Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi nuk është realizuar fare. Sa më sipër, librezimi i zërit në sasinë 144 kg, është librezuar tepër, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.

Zëri II "Ura Pasarel Kutal" Nënzëri 3.An "F.V Morseta"Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 72 copëF.V Morseta,me çmim 270 lekë/kg. Libreza e masave pasqyron 72 copë F.V Morseta Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi nuk është realizuar fare. Sa më sipër, librezimi i zërit në sasinë 72 copë morseta, është

librezuar tepër, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.
Zëri II "Ura Pasarel Kutal" Nënzëri 4.An "F.V Tiranda d=14mm" Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 173 kgF.V Tiranda,me çmim 200 lekë/kg. Libreza e masave pasqyron 173 kgTiranda. Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi nuk është realizuar fare. Sa më sipër, librezimi i zërit në sasinë 173 kg tiranda, është librezuar tepër, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.
Zëri II "Ura Pasarel Kutal" Nënzëri 5.An "F.V. Kavallota"
Preventivi i ndryshuar dhe situacioni përfundimtar pasqyrojnë 39 kg ñF.V. Kavallotaò, me çmim 350 lekë/kg. Libreza e masave pasqyron 39 kg përgatitje e montim litarë çeliku. Nga auditimi në objekt konstatohet se, ky zë punimi nuk është realizuar fare. Sa më sipër, librezimi i zërit kavallota në sasinë 39 kg, është librezuar tepër, dhe është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve.

Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve, ing. K. I.nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, *ku përcaktohet se:"Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit."*
- UKM Nr. 3, datë 15.2.2001 ñPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitò të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: ñ*Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit*ò, në kundërshtim me kushtet e kontratës, ku citon se: ñ*Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit si dhe destinacionin e objektit. Ai është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit*ò.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1188 Prot., datë 04.06.2018.
2. Nga ana e kolaudatorit të punimeve Ing.**D.Sh.**, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuare të bëra në:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *"Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi"*, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, *ku përcaktohet se:"Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve"*
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *"Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *ku përcaktohet se:*
Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:
a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.
b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.
c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.
ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve me nr. 1388/1 Prot., datë 05.08.2018.

Vlera prej* 285,960lekë pa Tvsh*, e cila përfaqëson likuidimin e punimeve të pakryera në fakt, konsiderohet si dëm ekonomik shkaktuar Buxhetit të Bashkisë Përmet.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:* Z. K. I.,** me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes dhe **Znj. D. Sh.**, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara.

Mbi observacionet e paraqitura nga Bashkia Përmet për Projekt Raportin e Auditimit

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit në e-mailin zyrtar në datë 20.12.2021, është dërguar observacion nga z. K. I., mbikqyrësi i punimeve për në lidhje zbatimin e punimeve me objekt: ñ*Sistemim asfaltim i rrugëve të Bashkisë Përmet dhe të Njësive Administrative* ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:
Zëri An ñPërgatitje e montim litare çeliku Ø =14 mmò nuk është realizuar
Zëri An ñF.V Morsetaò nuk është realizuar
Konstatimi i mësipërm nuk qëndron sepseUra në fshatin Zhepe është dëmtuar nga era e fortë duke u përdredhur dhe prishur. Në këtë urëjanë vendosur litarë çeliku me peshë 272 kg (4 litarë x 68 kg/litar çeliku), të cilët janë kapur memorseta që ura të fiksohet dhe të mos lëkundet pasi këta nuk janë litarët mbajtës të urës por litarëqë e mbajnë urën në pozicion fiks gjatë erërave të forta. Duke sqaruar se një litar është kapurme 9 morseta nga secili krah (18 morseta një litar), janë litarë të vendosur me 18 copë morsetapër litar, në total 77 morseta.
Qëndrimi i Audituesve të KLSH:*Në lidhje me pretendimet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:* Nga grupi i auditimit janë konstauar mangësi nga inventari fizik në objektin e sipërcituar. Pretendimet tuaja nuk janë të dokumentuara dhe komentet nuk merren në konsideratë dhe do të trajtohen në materialin e auditimit.
Pretendimet e subjektit:
Nga auditet konstatohet se:
Zëri An ñF.V Tiranda Ø=14 mm nuk është realizuarò.
Konstatimi i mësipërm nuk qëndron sepse**:**
Janë vendosur tiranda Ø=14 mm me gjatësi mesatare 2.2 m. Tirandat janë vendosur 36 copë në secilin krah me peshë 1,208 kg/ml të cilat shërbejnë për të mbajtur kavot lidhëse.
Konstatimi i mësipërm mbetet per tû gjykuar nga ana juaj.
Roli i kavallotave është lujatur nga hekuri i kthyer i cili ka mbajtur binarët mbajtës duke mos cënuar anënfunksionale të objektit për këtë arsye nuk janë vendosur kavallota të mirëfillta.
Qëndrimi i Audituesve të KLSH: *Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se: Pretendimet tuaja nuk qëndrojnë ligjërisht, teknikisht dhe as teorikisht, për këtë arsye nuk merren në konsideratë dhe trajtohen në materialin e auditimit.*

2.4 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

Nga auditimi mbi nivelin e zbatimin të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit në Bashkinë Përmet rezulton se:
Auditimi i fundit në Bashkinë Përmet është kryer në vitin 2018 për periudhën 01.01.2016-31.12.2017, Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën nr. 683/6 Prot., datë 10.09.2018. Kontrolli i Lartë i Shtetit në zbatim të programit të auditimit nr. 683/1 Prot., datë 20.07.2018 ka ushtruar auditimin e rregullshmërisë financiare dhe zbatimin e rekomandimeve të auditit pararendës.
Me shkresën nr. 6836/6 Prot., datë 11.09.2018 është dërguar nga KLSH Raporti Përfundimtar mbi zbatimin e rekomandimeve nga Bashkia Përmet.

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej: **20** masa organizative, **7** masa shpërblim dëmi me vlerë **5,355,513 lekë**.

-Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të KLSH dërguara në Bashkinë Përmet me shkresën nr. 683/6 Prot., datë 11.09.2018.
Gjatë auditimit rezultoi se pavarësisht nga puna e bërë, për disa nga masat e mësipërme dërguar në Bashkinë Përmet, bashkia është mjaftuar vetëm me nxjerrjen e urdhave për kryerjen e ndalesave, pa u shoqëruar në të gjitha rastet me padi gjyqësore për arktimin e vlerave të rekomanduara, për pasojë ndaj personave shkaktarë nuk ka filluar kryerja e ndalesave, duke u bërë përgjegjës për kalimin e afateve ligjore të kërkimit të dëmit, përcaktur në nenin 115 të ñKodit Civil në R.SHò dhe nenit 203 të ñKodit Punës në R.SHò. (prej 3 viteve) apo të parashkrimit të vendimeve (vlerave) të gjobave përcaktuar në nenin 46 të ligji *"Për kundëtvajtjet Administrative*" (brenda 2 vjetësh), sipas vendimeve administrative të dënimit me gjobë.

-Rezultatet e realizimit të rekomandimeve në mënyrë të detajuar paraqitet si më poshtë:
1- Hartimi i programit (Plan veprimit) dhe respekimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuan në nenin 15, gërma "j", të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2914 "Për organizinin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit".
Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Përmet rekomandimet e auditimit me shkresën nr. 683/6 prot., datë 11.01.2019, ndërsa nga Bashkia Përmet për zbatim e rekomandimeve të KLSH ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 2242/1 prot.,datë 02.10.2018.
Pra përgjigija e Bashkisë për zbatimine rekomandimve të KLSH është bërë brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes. Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nga Bashkia Përmet është hartuar Plan veprimi për për zbatimin e rekomandimeve, por nuk janë ngarkuar personat përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
Nga Bashkia Përmet është përgatitur dhe dërguar pranë KLSH, Raport me shkrim "Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit Përfundimtar të Auditimit të KLSH", e Protokolluar me shkresën nr. 683/10, datë 5.03.2019, ku është raportuar brenda afatit.

3- Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit tërekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 –Auditimii jashtëm, pika 5, të Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".
Nga verifikimi rezulton se Bashkia Përmet ka hartuar planin veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 683/6 prot., datë 11.09.2018, ndërkohë ka raportuar në Këshillin e Njësisë (Këshillin Bashkiak), ku ka paraqitur: *"Relacion për Këshillin Bashkiak"*, Protokolluar me shkresën nr. 2672, datë 26.10.2018, bazuar në Ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "*Për financat e vetëqeverisjes vendore",* Neni 50- ñAuditimi i jashtëmò: ku përcaktohet se: ñ*5 Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo audites të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqevetisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.*

<u>4. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Përmet</u>

Kontrolli i Lartë i Shtetit në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 154/*2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",* neni 31, pika 3, kryen auditimin e zbatimit të rekomandimeve në funksion të hartimit të raportit vjetor të aktivitetit. Përkatësisht në zbatim të këtij detyrimi KLSH ka zhvilluar në Bashkinë Përmet auditimin mbi zbatimin e rekomandimeve si për Bashkinë Përmet ashtu edhe për ish komunat (tani Njësitë Administrative) në bazë të programit të auditimit nr. 390 prot., datë 28.05.2019. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Përmetka rezultuar si më poshtë:
Në lidhje me zbatimin e rekomandmeve të lëna dërguar me shkresën nr. 683/6 prot., datë 11.09.2018, Bashkia Purmet ka hartuar një Plan Veprimi për zbatimin e tyre dhe situate aktuale paraqitet si më poshtë:
a) Nga 9 Masa organizative të rekomanuara janë zbatuar 3 masa janë në proces zbatimi 4 masa dhe aktualisht janë të pazbatuar 2 masa dhe më konkretisht:
Rekomandimi nr 5/9.1: Nga ana e Zyrës së Taksave në Bashkinë Përmet, të meren masa për arkëtimin e detyrimeve debitore të palikujduara deri në datën 31.12.2014 për të tre llojet e taksave të popullatës në vlerë **4,476,705 lekë**.
Rekomandimi nr.7/15.1: Bashkja Përmet të marrë masa dhe të rishqyrtojë ligjshmërinëdhe rregullshmërinë e 5 lejeve zhvillimore të miratuara më parë në përmbushje të kriterevedhe detyrimeve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014.
b) Realizimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit nga 9 masa të rekomanduara nga KLSH është në proces zbatimi 1 masë, nuk ka masa të zbatuara sidhe rezultojnë deri në datën e verifikimit 8 masa shþërblim dëmi të pa zbatuara.
Në lidhje me masat disiplinore të rekomanduara me Urdhrin nr. 2 datë 05.01.2017 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Komisioni Disiplinor për shqyrtimin e tre rasteve.Komisioni i ngritur nuk ka ndërmarë masa disiplinore për punonjësit e mësipërm kjo sipas Vendimeve nr. 66,66/1 dhe 66/2.

5. Niveli i zbatimit të rekomandimeve në Bashkinë Përmet të përcjella me shkresën nr. 390/6 Prot., datë 22.10.2019.
Titulli i gjetjes 15: *Niveli i zbatimit të rekomandimeve për masa shpërblim dëmi.*
Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga strukturat e Bashkisë Përmet dhe analizimit nga grupi i auditimit, rezulton si më poshtë:
Me shkresën nr. 390/6 Prot., datë 22.10.2019 është dërguar nga KLSH ñ*Raporti Përfundimtar i auditimit"* dhe *"Kërkesë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, në auditimin e fundit në Bashkinë miratuar në Vendimin e Kryetarit të KLSH"* nr. 125, datë 10.10.2019.
Në mënyrë të detajuar realizimi i masave paraqitet si më poshtë:

MASA ORGANIZATIVE:
Nga KLSH i janë rekomanduar Bashkisë Përmet 20 masa organizative, nga të cilat janë pranuar 20, prej tyre janë zbatuar plotësisht 11 masa, janë në proces zbatimi 7 masa dhe 2 masa organizative nuk janë zbatuar, respektivisht rekomandimet nr. 15 dhe 20. Në mënyrë të detajuar realizimi i masave organizative paraqitet si më poshtë:

15. Gjetje nga auditimi: Bashkia Përmet nëpërmjet tenderit sipas faturës tatimore nr. 39, date 13.10.2017 me numër serial 34648240 dhe akt marrjes në dorëzim datë 27.09.2017, ka blerë ngashoqëria ñG.ò Shpk, 2 mjete të cilët janë dokumentuar sipas Fletë hyrjes së magazinës nr. 92, datë 13.10.2017, respektivisht, Tip Fadromë me vlerë 3,000,000 lekë dhe Kamion vetëshkarkues me vinç me vlerë 1,992,000 lekë, ndërkohë për këto 2 mjete nuk është hartuar kontratë shitje para noterit publik dhe për pasojë 2 mjetet ende nuk figurojnë në pronësi të Bashkisë Përmet, por në pronësi të shitësit, në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994*"Kodi Civil i R.SH"* me ndryshime, respektivisht neni 710 ñDetyrimet e shitësit në

shitjen e pasurisë së luajtshmeò, pika 2dhe Neni 747 *"Kalimi i pronësise"....Kur objekti i shitjes janë sende të paluajtshme ose sende të luajtshme të regjistruara, zbatohen dispozitat mbi regjistrimin."*

15.1. Rekomandimi: Bashkia Përmet të marë masa që për 2 mjetet e blera të hartohet kontrata e shitjes para noterit publik, sipas fletë hyrjes së magazinës nr. 92, datë 13.10.2017, respektivisht, Tip Fadromë me vlerë 3,000,000 lekë dhe Kamion vetëshkarkues me vinç me vlerë 1,992,000 lekë, me qëllim që mjetet të regjistrohen në pronësi të Bashkisë Përmet, sikurse përcaktohet në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 *"Kodi Civil i R. SH"* me ndryshime, respektivisht neni 710 *"Detyrimet e shitësit ne shitjen e pasurisë së luajtshme",* pika 2, dhe neni 747 ñ*Kalimi i pronësisë","..Kur objekti i shitjes janë sende të paluajtshme ose sende të luajtshme të regjistruara, zbatohen dispozitat mbi regjistrimin."*

Nga verifikimi rezultoi se: Në zbatim të këtij rekomandimi me shkresën nr. 2408, datë 02.10.2018 është njoftuat subjekti ñG.ò Shpk për t'u paraqitur menjëherë për hartimin e kontratës së shitjes përpara noterit. Gjatë kësaj periudhe subjekti nuk është paraqitur.

20. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi rezulton se KLSH ka dërguar në Bashkinë Përmet rekomandimet e auditimit me shkresën e saj nr. 390/6 Prot., datë 22.10.2019, meqenëse rekomandimet e KLSH janë pranuar nga Bashkia Përmet, por nuk janë zbatuar plotësisht sidomos rekomandimet për masa shpërblim dëmi.
Nga 9 Masa organizative të rekomanduara janë zbatuar 3 masa janë në proces zbatimi 4 masa dhe aktualisht janë të pazbatuar 2 masa dhe më konkretisht:

Rekomandimi nr. 5/9.1. Nga ana e Zyrës së Taksave në Bashkinë Përmet, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve debitorë të pa likuiduara deri në datën 31.12.2014 për të tre llojet e taksave të popullatës në vlerën **4,476,705** lekë.

Rekomandimi nr. 7/15.1. Bashkia Përmet të marrë masa dhe të rishqyrtoj ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e 5 lejeve zhvillimore të miratuara më parë në përmbushje të kritereve dhe detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014.
Realizimi i rekomandimeve për shpërblimin e dëmit nga 9 masa të rekomanduara nga KLSH është në proces zbatimi 1 masë, ndonëse kanë dalë urdhrat e ekzekutimit dhe janë kryer regjistrimet në kontabilitet, ndërkohë deri në datën e verifikimit 20.07.2018, për 8 masa shpërblim dëmi nuk ka filluar arkëtimi në vlerën **11,026,618 lekë**

MASA ADMINISTRATVE
Me Vendimin nr. 90, datë 17.10.2016, APP ka vendosur dënim me gjobë për të 6 anëtarët e KVO **në vlerën 480,000 lekë.** Me vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nr.Vendimi 80-20116-5547, datë 22.11.2016, është vendosur *"Rrëzimi i kërkesë padisë i pa bazuar në ligj dhe prova".*Bazuar në nenin 45, të ligjit nr.49/2012 ñ*Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative",* është i pa ankimueshëm.Aktualisht në marrëdhënie pune pranë Bashkisë Përmet është vetëm znj. M. F. (H.), për të cilën nuk ka filluar mbajtja e vlerës së gjobës.
Nga ana e Drejtorisë Juridike nuk janë marrë masa për arkëtimin e 6 gjobave të vendosura me Vendimin eAPP nr. 90, datë 17.10.2016 të APP për dënim me gjobë për 6 anëtarët KVO në vlerën **480,000 lekë**, ku sipas vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nr. Vendimi 80-2016-5547 datë 22.11.2016 dhe nenin 45, të ligjit nr.49/2012 ñ*Për*

Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative", vendimi është i paankimueshëm.

Rekomandimi: Bazuar në ligjin nr. 10279,datë 20.05.2010 *"Për kundërvajtjet administrative",* neni 30-arkëtimi i të ardhurave pika 1 shkronja b- vendimet e gjykatës ka marrë formën e prerë, ndaj tyre, sipas pikës 3 duhet te paguhet 2 përqind kamat vonesë në muaj të masës gjobës.

MASA SHPËRBLIM DËMI:
KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Përmet, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrativedhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit.

Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 5,355,513 lekë.**
*Për **shperblim dëmi** janë rekomanduar 7 masa me vlerë **5,355,513 lekë**, është pranuar dhe kontabilizuarvlera 2,488,687 lekë, ndërsa vlera 2,866,826 lekë është kontabilizuar në ditar ekstra. Deri më datë 01.06.2019, janë arkëtuar 644,319 lekë, ndërsa shuma prej **4,711,194** lekë nuk është arkëtuar.*

Nga verifikimi rezultoi se nga vlera e rekomanduar nga KLSH prej	**5,355,513 lekë**
Deri më datën 31.12.2020, është arkëtuar	**837,438 lekë**
Janë kryer punimet sipas akt kolaudimeve në 2 objekte në vlerën	**267,300 lekë**
Është kryer pagesa për rekomandimin 4.1, BOE "E." dhe "A. K."	**51,180 lekë**
Kanë mbetur pa u arkëtuar vlera prej	**4,199,595lekë**

Nga të cilat:

Në proces arkëtimi 1 rekomandim në vlerën	**2,029,388** lekë
-Janë nisur njoftimet për 3 rekomandime por nuk kanë filluar arkëtime	2,170,207 lekë
Është kryer pagesa për rekomandimin 4.1 ,BOEò E.ò dhe ñA. K.ò	51,180 lekë
Janë kryer punimet sipas akt kolaudimeve në 2 objekte në vlerën	267,300 lekë

2.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Përmet, që t'i kërkojë BOE ñR.ò Shpk & ñV. H.ò Shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **1,060,822 lekë pa Tvsh**, të përfituar tepër për punime të pakryera në zbatimin e kontratës me objekt: ñ*T. T. K., E. Gj., V. P.".*

3.1 Rekomandimi: Të merren masa nga Bashkia Përmet, që t'i kërkojë OE ñM.òShpk duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e giykimitarkëtimin e shumës **491,785 lekë pa Tvsh**, të përfituar tepër për punime të pakryera nëzbatimine kontratës me objekt: *"Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit dhe rrugëve të brendshme tëfshatit Piskove".*

5.1 Rekomandimi: Bakhkia Përmet të marrë masa dhe t'i kërkojë **hartuesit të preventivit**: **Ing. D.M.**, duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimin e shumës **617,600 lekë pa Tvsh**, pasi është preventivuar dhe ritur më tepër fondi limit, për objektin: ñKanali ujitës i Çarshovës", si pasojë e rritjes të çmimeve jo në përputhje me manualin teknik të çmimeve të miratuara me VKM nr. 568, datë 27.06.2013,

"Për miratimin e manualeve teknikë të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre", i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2914 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetitò, neni 15, gërma ñjò dhe neni 30 pika 2.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit të kryer në Bashkinë Përmet ka sjellë mungesë të ardhurash nga mos shpërblimi i dëmit në vlerën **4,199,595**lekë.

Shkaku: Bashkia Përmet nuk ka ndjekur të gjitha hapat e duhura për të zbatuar rekomandimet e lëna nga KLSH..

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë me strukturat e bashkisë si dhe në Këshillin Bashkiak mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të KLSH të dërguara me shkresat nr. 390/61 prot., datë 22.10.2019 përkatës dhe hartimin e planeve specifike të punës për:

- Zbatimin rekomandimeve për shpërblim dëmi në vlerën **4,518,075**lekë;
- Zbatimin e 5 rekomandimeve organizative që janë nxjerrë urdhrat përkatës por rezultojnë ende në proces zbatimi;
- Zbatimin e 2 rekomandimeve organizative që ende nuk janë zbatuar.

Mbi observacionet e paraqitura nga Bashkia Përmet për Projekt Raportin e Auditimit:

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacion në e-mail zyrtar në datë 20.12.2021, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së për auditimin pararendës,në emër të Kryetares së Bashkisë Përmet znj. A. H. (Konceptuar nga znj. E. K.)

Pretendimet e subjektit:

1. Respektimi i afatit prej 20 ditësh për kthimin e përgjigjes.

Me shkresën nr. 2242/1 Prot., datë 02.10.2018, janë dërguar masat e marra mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së pra afati i kthimit të përgjigjes është kryer sipas nenit 15 shkronja ñaòligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë tëShtetitò

2. Respektimi afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marries së njoftimit të RaportitPërfundimtar të auditimit.

Me shkresën nr. 598/1 Prot., datë 08.03.2019 është dërguar pranë KLSh-së raportimi për zbatimin erekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar pra raportimi është kryer brenda 6 muajve nëzbatim të plotë të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër organizimin dhe funksionimine Kontrollit të Lartë të Shtetitò.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH: ***Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:*** Argumentimet tuaja qëndrojnë e merren në konsideratë nga grupi i auditimit, dhe reflektohen në këtë raport përfundimtar të auditimit.

Pas këtyre raportimeve me anë të shkresës nr. 390/6 ñAutorizim mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeveò, KLSh bën me dije institucionin Bashkia Përmet se brenda afatit 30.06.2019 - 26.07 .2079 do të auditojnë zbatimin e rekomandimeve të lëna. Me anë të shkesës nr. 390/61 datë 22.10.2019 protokolluar me tonën nr. 3771, datë 23.10.2019 është dërguar ñRaporti final i auditimit dhe kërkesë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit në Bashkinë Përmet, miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 125, datë 10.10.2019ò.

Sipas së cilit nga KLSH janë rekomanduar Bashkisë Përmet 20 masa organizative, të cilat janë pranuar të gjitha, janë zbatuar plotësisht 11 masa, janë në proces zbatimi 7 masa dhe nuk janë zbatuar 2 masa organizative, për të cilat u rikërkua edhe njëherë zbatimi i plotë i të dy masave organizative.

Bashkia Përmet me anë të shkresës nr. 1281/2, datë 33.07.2020 ka kthyer përgjigje për Kontrollin e Lartë të Shtetit sipas kërkesave të shkesës nr.430, datë 11.05.2020.

Sipas raporteve të sipërcituar janë kyer të gjitha kontabilizimet (bashkëlidhur bilanci i viti 2016 në të cilin vlera e kontabilizuar pasqyrohet në llogarinë 468 (debitore të ndryshëm) dhe lista me debitorët e

lënë nga KLSH për vitin 2015.
Bilanci i vitit 2018, kontabilizimi është kryer në llogarinë 468 (debitorë të ndryshëm) dhe lista me debitorët e lënë nga KLSH në vitin 2018. (Bashkëlidhur Raporti) Gjatë periudhës në vijim janë arkëtuar:
1. Taksa e ndikimit në infrastrukturdë(ALUIZNI) 837,438 lekë (përfshirë vlerën në raportimin e fundit prej 644,319 lekë) Pasqyruar në bilancin e vitit 2020.
2. Paguar masa për shpdrblim dëmi në vlerën 51,180 lekë për rekomandimin nr .4.1 të raportit të KlSh të dërguar me shkresën nr.390/61, datë, 22.10.2019 protokolluar me tonën me nr. 3771, datë 23.10.2019. (bashkëlidhur pagesa).
Qëndrimi i Audituesve të KLSH: ***Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se:*** Argumentimet tuaja qëndrojnë e merren në konsideratë nga grupi i auditimit, dhe reflektohen në këtë raport përfundimtar të auditimit.

2.5 Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

1. Mjedisi i kontrollit

1.1 Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues

Bashkia Përmet funksionon në përputhje me Ligjin nr. 152/ 2013, ñPër nëpunësin civilò i ndryshuar dhe Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Përmet.

- Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Përmet për vitin 2018, është miratuar me Vendimin nr. 173, datë 09.08.2017
- Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Përmet për vitin 2019 dhe 2020, është miratuar me Vendimin nr. 154, datë 03.06.2019

Bashkia Përmet ka miratuar Kodin Etik me Vendim nr. 38, datë 08.01.2018, bazuar në Ligjin nr. 9131 datë 08.09.2003 ñPër Rregullat e Etikës në Administratën Publikeò, Ligjin nr. 10296, Kreu III, neni 20 ñMjedisi i kontrollitò, pika 2/a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 ñMjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)ò.

1.2 Politika menaxheriale dhe stili i punës

Emërtimi	Viti	Plan	Fakt
Aparati-Bashkia Përmet	**2018**	132	132
	Maj 2019	136	136
	Dhjetor 2019	119	112
	2020	118	113
Institucione në varësi	2018	188	187
	Maj 2019	188	188
	Dhjetor 2019	180	167
	2020	201	196

Në tabelën e mësipërme është pasqyruar planifikimi i punonjësve në Aparatin e Bashkisë Përmet dhe në institucionet në varësi të saj dhe sa kanë qenë të punësuar gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020. Numri i të punësuarve në Bashkinë Përmet ka qënë më i vogël ose i barabartë me planifikimin.

Pasqyrimi i emërimeve dhe largimeve në Bashkinë Përmet për vitet 2018, 2019 e 2020, është si më poshtë:

	2018		2019		2020	
	Emërime	Largime	Emërime	Largime	Emërime	Largime
Nr. i punonjësve	74	18	114	101	110	54

Siç vihet re edhe në tabelën e paraqitur më lart emërimet në numër më të lartë i ka patur në vitin 2019, po ashtu edhe largimet në numër më të lartë në vitin 2019. Diferenca në periudhën 2018- 2020 midis emërimeve dhe largimeve është 125 punonjës të larguar.

1.3 Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit

Struktura organizative e Bashkisë Përmet, e ndërmarrjeve dhe institucioneve në varësi për vitin 2018 është miratuar me Urdhër nr. 34, datë 21.02.2018 dhe ka në përbërje të saj 320 punonjës, për vitin 2019 është miratuar me Urdhër nr. 38, datë 19.02.2019 dhe ka në përbërje të saj 324 punonjës dhe për vitin 2020 është miratuar me Urdhër nr. 28, datë 24.01.2020 dhe ka në përbërje të saj 315 punonjës.

Vendet vakante, mbartin risqe të cenimit të performancës së aktivitetit të institucionit. Në strukturën e aparatit të Bashkisë Përmet deri në 31 dhjetor 2020 ka 6 vende vakante.

1.4 Aftësitë profesionale të punonjësve

Emërimet janë kryer në zbatim të Ligjit 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, nenet 22 dhe 25, si dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, ñPër pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutiveò , kreu II, III dhe VII.

- Nuk është hartuar ñHarta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzoreò, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve
- Në informacionin e sjellë nga Burimet Njerëzore në vitin 2018 janë kryer vetëm 40 trajnime dhe për vitin 2019 vetëm 46 trajnime për punonjësit. Në vitin 2020 janë kryer trajnime nëpërmjet Zoom (online). Burimet Njerëzore nuk kanë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera për periudhën e auditimit.
- Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.
- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).

2. Menaxhimi i riskut

Në këtë proces identifikohen situatat e mundshme që mund të kenë efekt të dëmshëm në veprimtarinë e institucionin, të cilat mund të jenë risqe të brendshme apo të jashtme. Bashkia Përmet nuk ka miratuar ñStrategjinë e Menaxhimit të Riskutò, e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK- së dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeò, pikën 5.3. Koordinatori i riskut, duhet të jetë Nëpunësi Autorizues (ose kjo detyrë të delegohet), në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, nenit 11, ñPërgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisëò, pika 2, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 ñMenaxhimi i Riskutò, si dhe nenit 10 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010.

Grupit të auditimit ju vunë në dispozicion shkresat **për caktimin e Nëpunësit të Autorizuar dhe Nëpunësit Zbatues**, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nëpunësi i Autorizuar NA dhe Nëpunësi Zbatues NZ

Nëpunës Autorizues (NA)	*Autorizimi për kryerjen e detyrave si:*	*Periudha*
Niko Shupuli	Konfirmim i NA nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar, për dijeni të Degës së Thesarit Përmet dt. 10/08/2015, me nr. 11458/1 Prot.	10.08.2015
Alma Hoxha	Kërkesë për konfirmim e NA dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar dt. 31/07/2019, me nr. 1963 Prot. Shkresë mbi caktimin e NA, konfirmim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar për dijeni të Degës së Thesarit Përmet me nr. Prot. 14637/1, datë 13.08.2019	13.08.2019
Florand Hasani	Kërkesë për konfirmim e NA (firmë e dytë) dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar dt. 19/09/2019, me nr. 3426 Prot. Shkresë mbi caktimin e NA, konfirmim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar për dijeni të Degës së Thesarit	27.09.2019

	Përmet me nr. Prot. 16914/1, datë 27.09.2019	
Nëpunës Zbatues (NZ)	*Autorizimi për kryerjen e detyrave si:*	*Periudha*
Etleva Myftari	Konfirmim i NZ nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar, për dijeni të Degës së Thesarit Përmet dt. 10/08/2015, me nr. 11458/1 Prot.	10.08.2015
Etleva Kreci	Kërkesë për konfirmim e NZ dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar dt. 01/11/2019, me nr. 3990 Prot. Shkresë mbi caktimin e NA, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar për dijeni të Degës së Thesarit Përmet me nr. Prot. 19930/1, datë 08.11.2019	08.11.2019

Procesi i Menaxhimit të Riskut për periudhën e auditimit rezulton të mos jetë realizuar dhe dokumentuar me vendimet përkatëse në mos zbatim të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010, Kreu III dhe nenit 10, Kreu II, ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015 si dhe Udhëzimit nr. 16 datë20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK dhe koordinatorit të riskut njësitë publikeò. Në mbështetje të Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò neni 27, në zbatim të Udhëzimit nr. 16 datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publikeò pika 2/2,4, nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Përmet nuk ka miratuar Plan Pune Vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjikò.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk punon me sistem HRMIS, por me hedhje manualisht në programin Microsoft Office Excel. Hedhja, pasqyrimi i të dhënave personale dhe profesionale të çdo punonjësi të punësuar kryhen nëpërmjet excel- it apo word- it.

Në Bashkinë Përmet, po ashtu drejtoria e financave përdor programin Excel. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave dhe kjo kryhet nga drejtoria e financave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë.

Në vijim të analizës së auditimit, grupi i auditimit konstaton se janë të nevojshme për institucionin implementimi i programeve për burimet njerëzore, për financën dhe për drejtoritë që mbledhin taksat duke garantuar kështu shmangien e keqpërdorimit apo të abuzimit dhe cenimit të cilësisë.

3. Aktivitetet e kontrollit

Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, politikat dhe procedurat që vendosen, si parandaluese apo zbuluese në adresimin e risqeve sjellin arritjen e objektivave të institucionit. Bashkia Përmet nuk ka patur në strukturën e saj Auditin e Brendshëm, e cila sjell mungesën e vlerësimeve specifike për sistemet e kontrollit të brendshëm. Në 04.05.2018 Bashkia Përmet i ka dërguar Ministrisë së Financave një kërkesë për miratim të një marrëveshje për realizimin e shërbimit të Auditimit të Brendshëm dhe pas kësaj Bashkia Përmet dhe Bashkia Këlcyrë kanë lidhur një kontratë me afat deri më 30.06.2019 me Bashkinë Memaliaj, kontratë e cila nuk është vënë në zbatim.

Burimet njerëzore në Bashkinë Përmet në vitin 2020, kanë kryer 2 shpallje për 1 punonjës në pozicionin si specialist në auditin e brendshëm pavarësisht kësaj nuk ka pasur aplikime. Nuk kemi ngritje të drejtorisë së auditit të brendshëm. Në Bashkinë Përmet nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò neni 13. Si rrjedhojë, nuk ka takime të dokumentuara midis Komitetit të Auditimit dhe drejtuesve të NJAB-së, në kundërshtim me kërkesat ligjore të cilat kanë si detyrim mbledhjen minimalisht 4 herë në vit. Ky institucion ka qenë pjesë e programit

të auditit të jashtëm, si pasojë e saj ka patur mbikëqyrje nga ana e titullarit për zbatime të rekomandimeve mbi fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

4. **Informimi dhe komunikimi**

Bashkia Përmet disponon faqen e saj zyrtare në web, ku pasqyrohet aktiviteti i saj. Komunikimi realizohet elektronikisht, verbalisht dhe në formë shkresore. Me subjektet komunikimi kryhet nëpërmjet telefonit, postës zyrtare apo elektronike. Grupi auditues konstaton se nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email-it zyrtar të institucionit duke qënë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Në Bashkinë Përmet punonjësit punojnë me këto sisteme informatike Word dhe Excel. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë elektronike.

5. **Monitorimi**

Bashkia Përmet i dërgon Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë, për periudhat Janar- Prill, Janar- Gusht dhe Janar- Dhjetor, në total tre raporte vjetore për ecurinë dhe realizimin e produkteve, masën e realizimit të shpenzimeve. Ky Raportim monitorimi për periudhën Janar- Prill është dërguar në MFE: për vitin 2018 me komunikim me email në datën 07.09.2018 për vitin 2019 me shkresën përcjellëse nr. 1295 datë 27.05.2019; për vitin 2020 mungon shkresa përcjellëse. Për periudhën Janar- Gusht është dërguar në MFE: për vitin 2018 me shkresën përcjellëse nr. 2491 datë 09.10.2018 për vitin 2019 me komunikim me email në datën 27.09.2019; për vitin 2020 me komunikim me email në datën 17.09.2020. Për periudhën Janar- Dhjetor është dërguar në MFE: për vitin 2018 me shkresën përcjellëse nr. 1106 datë 28.02.2019 për vitin 2019 me shkresën përcjellëse nr. 604 datë 25.02.2020; për vitin 2020 me komunikim me email në datën 25.02.2021. (nisja e tyre është kryer brenda afatit të përcaktuar në pikën 48, të Urdhrit nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendoreò, 3.2, duke përjashtuar 4 mujorin e parë dhe të dytë të vitit 2018 të cilat janë jashtë afatit, po ashtu theksojmë se disa janë dërguar vetëm elektronikisht nëpërmjet email-it). Pyetësori i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Raporti për Funksionimin e Cilësisë së Kontrollit të Brendshëm dhe Planin e Veprimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si dhe në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin 2018: nr. 475 Prot., datë 08.03.2019, për vitin 2019: nr. 605 Prot., datë 26.02.2020, për vitin 2020: nr. 514 Prot., datë 25.02.2021 (nisja e tyre është kryer brenda afatit të përcaktuar në manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, pika 2.2.3, të miratuar me Urdhër nr. 108, datë 17.11.2016.

Raportimi mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë, përmban informacione dhe evidenca të ndryshme, ku bazohet dhe Raporti vjetor i monitorimit i cili i dërgohet Ministrisë së Financave. Monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Bashkia Përmet e kryen bazuar në Rregulloren e Brendshme, dokumentin e PBA- ve si dhe raporteve të monitorimit.

Titulli i gjetjes nr. 16:	**Zbatim jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit**
Situata:	Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se: Në Bashkinë Përmet nuk është hartuar ñHarta e proçesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzoreò, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve. Në vitin 2018 janë kryer vetëm 40 trajnime dhe për vitin 2019 vetëm 46 trajnime për punonjësit. Në vitin 2020 janë kryer trajnime nëpërmjet Zoom (online). Burimet Njerëzore nuk kanë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet

	e kryera për periudhën e auditimit. Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut. Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n). Bashkia Përmet nuk ka patur në strukturën e saj Auditin e Brendshëm, e cila sjell mungesën e vlerësimeve specifike për sistemet e kontrollit të brendshëm. Bashkia Përmet nuk ka miratuar ñStrategjinë e Menaxhimit të Riskutñ si dhe nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Përmet nuk ka miratuar Plan Pune Vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjikò. Nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email-it zyrtar të institucionit duke qenë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i. Bashkia nuk implementuar programe për burimet njerëzore, për financën dhe për drejtoritë që mbledhin taksat.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016
Ndikimi/Efekti:	Mosndjekja e trajnimeve cenon cilësinë e zhvillimit profesional të punonjësve. Zbatimi jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm.
Shkaku:	Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor për MFK
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masa për zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së: Të hartohet një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, ñHarta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzoreò Burimet Njerëzore të përpilojnë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera nga ana e tyre si dhe të njoftojë punonjësit të ndjekin trajnime me qëllim zhvillimin e tyre profesional Të kryejnë trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut <u>Grupi i Menaxhimit Strategjik të kryej trajnime mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin</u> Të ngrihet në strukturën e Bashkisë Përmet auditi i brendshëm ose të miratojë një marrëveshje me bashki të tjera për realizimin e shërbimit të Auditimit të Brendshëm. Bashkia Përmet të miratojë ñStrategjinë e Menaxhimit të Riskutò, të zhvillohen mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe të miratohet Plan Pune Vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjikò. Të mundësohet për të gjithë punonjësit përdorimi i email-it zyrtar të institucionit. Bashkia Përmet të implementoj program për burimet njerëzore, për financën dhe për drejtoritë që mbledhin taksat duke garantuar kështu shmangien e keqpërdorimit apo të abuzimit dhe cenimit të cilësisë.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mban përgjegjësi:Z. N. Sh., ish Kryetar i Bashkisë Përmet si Nëpunës Autorizues;Znj. A.H., Kryetar i Bashkisë Përmet si Nëpunës Autorizues;Znj. E.M., ish Nëpunës Zbatues*;* Znj. E. K., Drejtoreshë e Drejtorisë së Financave si Nëpunës Zbatues;Z. E. K., ish Specialist i Sektorit Juridik dhe Burimeve Njerëzore, në periudhën audituese 2018- 2019*;* Znj.

P.M., Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Shërbimeve Njerëzore në periudhën audituese nga fillimi i vitit 2020

2.6 Të ndryshme – Trajtimi i ankesave

Auditimi mbi ankesën me nr. 140 Prot., datë 20.10.2020, ardhur në KLSH në lidhje me veprimet e firmës ndërtuese "Vjosa" Shpk .

Në ankesën me *nr. 140 Prot., datë 20.10.2020, depozituar në KLSH znj. M. V.*qytetare nga Përmeti, denoncon veprimet abusive të firmës ndërtuese ñV.ò Shpk, me administrator znj. E. M. në lidhje me dokumentacionin e firmës.

Referuar ankesës; ñV.ò Shpk, ka shumë probleme me qytetarët dhe konkretisht mbi pallatin 5 katësh në Lagjen e Re Përmet.

"Kërkojmë verifikimin e dokumentacionit pasi siç jemi informuar nuk ekzistojnë dokumentat si me poshtë

A janë zhvilluar në përputhje me ligjin apo nuk janë kryer fare, Akt kolaudimi përfundimtar, dhënia e lejes së shfrytëzimit dhe procedurat e tjera ligjore sipas ligjit?.

Procesverbali i kolaudimit mban një date kur sapo kishin filluar punimet e brendshme??

Nuk ka proces verbal kolaudimi të firmosur nga kolauatori, zbatuesi dhe mbikqyrësi i punimeve siç e kërkonligji.

Nuk ka leje shfrytëzimi pallati e cila nxirret mbi bazën dhe pas depozitimit të procesverbalit të kolaudimit të objektit.

Shet pallate dhe për t'ju shmangur detyrimeve në shtet u dhuron fëmijëve hyrje siç ka vepruar me pasurinë me nr. 9/145 N6 ZK 2917 dhe nr.9/145 NB të cilën e ka shitur dhe kashmangur detyrimet në shtet si gjithnjë.

Para disa ditësh emisioni investigative fiks fare denoncoi fallcifikimin e dokumentave që kjo zonjë i ka bërë kunatit të saj mbi një pasuri.

Është pushuar nga puna nga Ujësjellësi Përmet, pasi auditi gjeti shkelje ndoshta dhe abuzime në punën e saj.

Pallati në të cilin banjo unë dhe nëntë familje të tjera ka problem si në dokumentacion edhe në ndërtim".

Nga grupi i auditimit KLSH-së, ju kërkua informacion zyrtar z. E. M., me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit e Pastrimit, në Bashkinë Përmet.

Z. E. M. na informojë që në lidhje me pallatin që ka ndërtuar ñV.ò Shpk, (*pallati për të cilin referohet ankimuesja, është ndërtuar në vitin 1994)* ka shumë probleme me qytetarë.

Me shkresën nr. 2722 Prot., datë 04.10.2021, Bashkia Përmet, në zbatim të kërkesës së grupit të auditimit i është drejtuar Zyrës Vendore të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, Përmet (ZVASHK), për dërgimin e të gjithë dokumentacionit për objektin 5 Kate nësezonin Z-3, Tip ï c, me 10 apartamente 2+1.

Me shkresën nr. 631/1 Prot., datë 12.10.2021, ñKthim, përgjigjeò ZVASHK Përmet i është drejtuar Bashkisë Përmet ku citohet që: ñNga verifikimet në bazë të të dhënave të dërguar në kërkesën tuaj, rezulton se objekti është pasuria me nr. 23/27 ZK 2917 Q, Përmet.

Bashkëlidhur është dërguar dokumentacioni për regjistrimin e objektit të sipërcituar, dokumentacion që disponohet (*fotokopje e dokumentacionit, zyrtarisht)* nga grupi i auditimit.

Nga dokumentacioni në dispozicion. grupi i auditimi konstaton që ekziston:

1.Vendimi për dhënien e sheshit të ndërtimit, datë 15.10.1993, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Përmet z. Dh. N.

2. Vendimi i Këshillit Bashkiak, Bashkia Përmet, me nr 58 datë 30.9.1993 (pika 5) për miratimin e krekesës së firmës ñV.ò Shpk për ndërtimin e një banese 5 katshe me 10

apartamente pallatine formë Z. Për shpërndarjen e apartamenteve të lidhet kontratë me Bashkinë.
Për zbatimin e këtij vendimi është ngarkuar Zyra e Shërbimeve Publike për të njoftuër personët e interesuar për plotësimin e mëtejshëm të dokunentacionit.
3.Vendimi nr.14, datë 08.03.1994 "Për miratimin e sheshit të ndërtimit…" nënshkruar nga Kryetari i Këshillit të Rregullimit të Territorit.
4.Leje ndërtimi (formulari nr.4-pa datëdhe nr. Prot) nënshkruarnga z. V. P., Kryetar i Këshillit të Rrethit, ku citohet: *"Afati i lejes deri më datë 20.09.1994.*
Piketimi i objektit do të bëhet nga Seksioni i Urbanistikës dhe Zyra e Urbanistikës në Bashkinë e Qytetit Përmet…"
Leje shfrytëzimi datë 23.08.1999, ngaPërgjegjësi i Seksionit të Urbanistikës në Bashkinë Përmet.
5.Procesverbali i kolaudimit të objektit, datë 07.02.1995, formulur nga inxhinier ekspert A. Zh. me licemcë nr. K0125
6. Kontrata e shtitjes së truallit (Kontrata e shitjes së truallit prej 250 m^2 është e datës 10.09.1999, e lidhur midis z. **P. M.**, përfaqsues i ñV.ò Shpk [blerësi] dhe z. B. M. Përgjegjës i Sektorit të Financave të Këshillit të Rrethit Përmet
7. **Vërtetim Pronësie** me nr. 2464, datë 07.10.1999, nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Përmet, Sektori i Hipotekës, kucitohet:
"Vertetojme se në Librin nr. 12 të Regjistrimit të Traskiptimeve të Hipotekës me numër rendor 203, datë 07.10.1999, figuron në favor të Shoqërisë Tregëtare "V." Shpk. me seli në qytetin e Përmetit një Pallat 5 KT në qytetin e Përmetit i përbërë nga 10 apartamente 2+1 me aneks me sipërfaqe të truallit 250 m^2.
Prona kufizohet: nga Veriu me Shesh, nga Lindja me Shesh, nga Jugu me Shesh, nga Perëndimi me Shesh.Pronësia është përfituar në bazë të ligjit të urbanistikës"

<u>Auditimi mbi ankesën me nr. 1131 Prot., datë 22.10.2021, ardhur në KLSH në lidhje me veprimet e firmës ndërtuese "V." Shpk</u>.
Nga Drejtoria e Planifikimi Zhvillim Terrirorit/Pastrim Gjelbërimit/Mirëmbajtjes (z. E. M.) në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Urbanistikës (z. L. B.) dheArshivë/Protokollit (z. A. C.- specialistit) është kërkuar informacioni tekniko-ligjor përobjektin e sipërpërcituar. Me shkresat nr. 2972 Prot., datë 25.10.2021 ñKërkesë për informacionò drejtuarAgjencisë Shtetërore të Kadastrës Përmet me objekt: "Kërkesë për informacion për dërgimin egjithë dokumentacionit për regjistrimin e objektit të sipërpërmendur pas përfundimit të tijò si dheshkresës me nr. 3001 Prot., datë 27.10.2021 ñKërkesë për verifikim dokumentacioni" drejtuarSektorit të Planifikim Zhvillim Territoritò

Me shkresën nr. 3001/1 Prot., datë 28.10.2021 është kthyer përgjigje nga Përgjegjësi i sektorit të Urbanistikës Ing. L.B. ku citohet se: -Referuar totove satelitore Ortofoto 2007, Ortofoto 2015- 8 cm dhe Ortofoto -2019UVA) të faqes zyrtare të ASIG Geoportal në objektin e sipecifikuar në kërkesën tuaj, nukrezulton të jenë kryer punime për mbingritie kati për periudhën kohore nga viti 2007 dhe nëvazhdim.
- Referuar procesverbaleve të dorëzimit, ju bëjmë me dije se dokumentacioni i lejeve tëndërtimit të periudhës së viteve 1991- 2007 eshte arkivuar dhe është kompetencë e sektorit arkivë/Protokoll.

Me shkresën 674/1 prot., datë 25.10.2021, "Kthim Përgjigjeò ZVASHK Përmet citon se:...ngakontrolli nësistemin elektronik të regjistrimit të pasurive të paluajtshme IPS për ZVASHKPërmet rezulton se pasuria me nr. 23/120; Vol.12; Faq.233 ZK.2917 Pëmet, është pasuri e llojitpallat me sipërfaqe Totale 371 m^2 nga kjo sipërfaqe Trualli 371 m^2 dhe siperfaqe

ndërtimi 316 m^2 dheështë regjistruar në pronësi të shoqërise ñV.ò Shpk. Bashkëlidhur është dërguardokumentacioni që disponohet (fotokopje e dokumentacionit, zyrtarisht).

Nga dokumentacioni tekniko ligjor i depozituar ekzistojnë këto dokumenta:
1. Shkresa ñDërgohet dokumentacioni në ZRPPò pa numër Protokolli e datës 05.01.2005, dërguar nga Ing D. Sh. Përgjegjëse e Sektorit të Urbanistikes
2. Vërtetim nga dokumentet Hipotekor me nr. 30, datë 05.01 2005
3. Akt Kolaudimi Objekt: Banesë 6-kate me podrum.
4. Hartë treguese provizore me nr 30 datë 05.01 2005.
5.Kontratë shitje trualli datë 15.01.2001 midis Administrata e Rretht Përmet dhe Firma "V." Shpk.
6. Leje ndërtimi nr.1164 Prot për objektin ñBanesë shumë familjare 6 kate me podrumò, Përmet (në emërte Entit të Banesave Dega Tepelenë)
7. Vendim për dhënie shesh ndërtimi nr. 20/6 Prot., datë
8. Leje shfrytëzimi ose banimi me vendim të KRRT nr.3 datë 17.03.2005, Objekti Banesë 6 kate mebodrum.
9. Planimetri e sheshit të ndërtimit e objektit banesë 6-kate me 24 apartamente banimi dhe podrum e firmës ñV.ò Shpk, Përmet Gusht 1999.
10. Planimetri e podrumit, Planimetrie katit përdhe, Planimetri e katit tip shk 1:100 hartuar nga Ing. S. J. dhe planimetri e verandës shk. 1: 100 punuar nga Ing. S. K..
11. Vendimi nr. 4, datë 17.03.2005 i KRRT Përmet ñPër miratimin e lejes së shfrytëzimit të objektit Banesë6 kate dhe podrumò të firmës ñV.ò Shpk
12. Vendimi i giyqtarit të vetëm nr. 6753/5, datë 31.05.2000 (për ndryshimin e administratorit nga P.M. në L. M.
13. Vendimi nr. 49, datë 29.10.1999 "Mbi miratimin e shesheve të ndertimitò
14. Vendimi nr. 38, datë 14.01.2000 i KRRT ñMbi shqyrtimin e sheshit të ndërtimit të objektit banesë 6katò për z. P. M., Përmet.
15. Vendimi nr. 176, datë 28.06.1995 ñMbi miratimin e lejës së ndertimit të objektit "Banesë 6 kate" përinvestitorin Enti Banesave Dega Tepelenë.
16. Vërtetimi i përfundimit të punimesh të objektit Banesë 6 kate me bodrumò për firmën "Vjosaò Shpk datë06.12.2004
17. Vërtetim për rregjistrimin e investitorit në Degën e Tatimeve nr. 976 Prot., datë 21.12.2004.
18. Vërtetim pronësie datë 13.01.1997 në favour të firmës "V." Shpk
19. Kërkese "Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Përmet datë 05.01.2005.
20. Urdhër ndarje pasurie nr.23/53; Volum 12; Faqe 231 në dy pasuri datë 05.01.2005.

Si përfundim theksohet se nga verifikimet e mësipërme dhe arkivës nuk rezulton të ketëdokumenta për shtesë katesh.*(Bashklidhur fotokopje e dokumentacionit)*
Nga dokumenacioni i paraqitur, në opinionin e grupit të auditimit *(përveç kohës 27-28 vjeçare kur ka filluar procedura e ndërtimit të objektit)* konstatohet një problematikë në lidhje meVendimin e Këshillit Bashkiak, BashkiaPërmet, me nr. 58 datë 30.9.1993 dhe Kontrata e shtitjes së truallit (Kontrata e shitjes së truallit prej 250 m^2 është e datës 10.09.1999).

Nisur nga ankesat e qytetarëve që janë për të njëjtin firmë ndërtimore ñV.ò Shpk, në pamje të parë nuk identifikohet ndonjë shkelje sa i përket denoncimit të ankimuesve.
Në opinionin e grupit të auditimit, nga dokumentacionin në dispozicion është pothuajse e pamundur të jepet një mendim profesional në lidhje me procedurën e pronësisë dhe

zhvillimin e kësaj prone, vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur për ndërtimet në fjalë, është jashtë afateve kohore e kompetencave ligjore për zhvillimin e procesit të auditimit.
Për një opinion auditimi më të thelluar e më profesional do të ishte i domosdoshëm auditimi për këtë pasuri në ZVASHK Përmet.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME
Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nuk janë miratuar nga Këshilli i Bashkisë, tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik, në zbatim me kërkesat e ligjit nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 37.
Mungon Plani i Masave dhe Veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.
Ka mungesë të dokumenteve (dëgjesa publike, takime për llogaridhënie për zbatimin e buxhetit etj), të cilat të dokumentojnë se janë konsultuar me komunitetin dhe grupet e interesit.
Nuk ka mbledhje të dokumentuara të GMS, për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
Nuk dokumentohet mbledhja e njësisë vendore dhe institucioneve të varësisë në lidhje me kërkesat e tyre buxhetore. Planifikimi Buxhetor Afatmesëm është kryer duke u mbështetur në PBA- të e viteve të mëparshme dhe jo mbi një analizë të mirëfilltë. Publikimi i dokumenteve në faqen zyrtare të bashkisë Përmet apo në vendime.al ka vonesa dhe mungesa në afatet e publikimit.
Ka diferenca midis treguesve të hartimit dhe zbatimit të buxhetit, përsa i përket pjesës së të ardhurave të veta dhe shpenzimeve të tyre. Realizimi i buxhetit ndaj planit për vitin 2018 ka arritur 85.1 %, për vitin 2019 ka arritur në 85.9 % dhe në vitin 2020 ka arritur në 84.6 %.
-Detyrimet kreditore për fund vitin 2017, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 5,448,254 lekë.
-Detyrimet kreditore për fund vitin 2018, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 9,782,208 lekë.
-Detyrimet kreditore për fund vitin 2019, sipas pasqyrave financiare të raportimit për këtë vit, llogaritë 401-408 për vlerën 3,427,178 lekë.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Bashkia Përmet, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, objektiv në realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mos krijuar diferenca midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit si dhe të analizohet brenda muajit qershor të çdo viti zbatimi i buxhetit.
Bashkia Përmet të marrë masa, të dokumentojë mbledhjet e strukturës dhe të institucioneve në varësi, duke parashtruar dhe kërkesat e tyre buxhetore.
Bashkia Përmet të marrë masa për publikimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak në faqen zyrtare apo në vendime.al brenda 15 ditëve.
Grupi i Menaxhimit Strategjik duhet të mblidhet për të diskutuar rreth planifikimit dhe monitorimit të politikave strategjike, PBA, risqeve kryesore dhe çështjeve të tjera të menaxhimit financiar dhe kontrollit (të dokumentuara).

Të kryhet Plani i Masave dhe Veprimit, për fazën përfundimtare të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Projektbuxhetit Vjetor për të gjithë periudhën e auditimit, ku të jenë përcaktuar aktivitetet që do të zhvillohen, afati, personat përgjegjës.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Detyrimet e prapambetura deri më datë 31.12.2020 janë në vlerën 14,666,184 lekë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò. Ndër të cilat vlerën më të lartë të shpenzimeve të pa likuiduara i zënë investimet në vlerën 10,335,785 lekë ose 70.47 %. Detyrimi i papaguar në lidhje me investimet e kryera si ndërtimi i shkollës së mesme me subjekt ñA. C.ò ShPK dhe rehabilitimi i banesave me subjekt ñN.ò ShPK, faturat janë të muajt shkurt dhe maj 2020. Mallra dhe shërbime në vlerën 2,346,886 lekë ose 16 %, vlerë e pa likuiduar i cili i përket Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), faturat e pa paguara të vitit 2007. Mbi arsyet e mos likuidimit të kësaj vlere, Bashkia Përmet deklaron se i kanë dërguar shkresa OSHEE- s në lidhje me detajimin e këtij detyrimi, nga e cila nuk ka patur përgjigje. Në vlerën e detyrimeve të papaguara shfaqet edhe detyrimi 1,983,513 lekë ndaj detyrimeve të vendimeve gjyqësore ose 13.5 %, nga të cilat 554,334 lekë janë detyrime që nga viti 2012 dhe 2013. Detyrimet për vendimet gjyqësore kanë të bëjnë me detyrime ndaj punonjësve të larguar nga ky institucion. Nga totali i detyrimeve të vendimeve gjyqësore, vetëm 2 prej këtyre rasteve kanë kaluar me përmbarues. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Bashkia Përmet të ndërpresë praktikën e krijimit të detyrimeve të reja dhe të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plan të detajuar për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Më datë 31.12.2020, balanca e llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò rezulton në vlerën 33,198,811 lekë për penalitete dhe kamatëvonesa. Në asnjë rast nuk janë evidentuar në llogaritë analitike, si për vitin 2018, 2019 dhe 2020, debitorët për taksat dhe tarifat vendore, tokën bujqësore, për taksën e ndikimit në infrastrukturë, subjekteve që tregtojnë karburante dhe dhënies me qira të apartamenteve në kundërshtim me Ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004, ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, Ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ñPër kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò dhe Udhëzimin nr. 8. datë 09.03.2018 ñPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò. Nga rakordimi me zyrën e Taksave dhe Tarifave të Bashkisë Përmet, janë evidentuar detyrimet për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Pra nuk është pasqyruar vlera e saktë në llogarinë 468 ñDebitorë të ndryshëmò dhe kundër partinë klasa 7 e llogarive ñTë ardhuratò, për rrjedhojë nuk janë njohur si të ardhura për vitin 2020, në vlerën 32,823,572 lekë. Nuk janë kryer kontabilizimet në lidhje me vlerën e:

- debitorëve familjarë për taksën e ndërtesës dhe taksën e shërbimit 6,697,803 lekë;
- debitorëve nga bizneset për taksat dhe tarifat vendore 14,022,894 lekë dhe 1,897,248 lekë
- taksës së ndikimit në infrastrukturë 258,481 lekë;
- tokës bujqësore 5,007,646 lekë;
- subjekteve që tregtojnë karburante 3,200,000 lekë dhe 100,000 lekë gjoba të llogaritura
- dhënies me qira të apartamenteve sociale 1,639,500 lekë

Këto vlera janë mbajtur jashtë bilancit nga Drejtoria e Financës në regjistrat e tyre progresivisht.

Nga auditimi rezulton se OSHEE vazhdon vendosjen në faturën mujore të energjisë elektrike vlerën e tarifës së shërbimit të televizorit prej 100 lekë/muaj, në kontratat për ndriçim publik të rrugëve të qytetit edhe pse Bashkia Përmet i ka bërë kërkesë për mosvendosjen e kësaj tarife.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Nga Bashkia Përmet, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet të llogarisë 468 ñDebitorë të ndryshëmò duke e debituar për vlerën 32,823,572 lekë. Gjithashtu të sistemohet e ardhura e akumuluar ndër vite nga taksat dhe tarifat vendore, për secilin vit përkatës në llogarinë 1210 ñRezultat i mbartur i seksionit të funksionimitò të vitit në vazhdim.

Me mbylljen e bilancit të vitit 2021

4. Gjetje nga auditimi: Referuar ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiareò, Udhëzimit nr. 8, datë 9.3.2018, ñPër Procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeñ grupi auditues konstatoi se në Aktivet Afatgjata Financiare, llogaria 26 ñPjesëmarrja me kapitalin e vetò është në vlerën 0 lekë, vlerë e cila duhet të përfaqësonte vlerën e aksioneve që ka Ujësjellës Kanalizime Sh.a Përmet. Bashkia Përmet i vendosi në dispozicion grupit auditues Vendimin e Gjyqtarit të vetëm, më datë 02.04.1999 për miratimin e ekspertit kontabël, i cili do bënte dhe vlerësimin e kapitalit kontabël sipas ligjit 8237, datë 1.09.1997 ñPër disa ndryshime në ligjin 7926, datë 20.04.1995 ñPër transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtareò, ndryshuar dhe me akte të tjera ligjore. Gjyqtari i vetëm ka vlerësuar kapitalin themeltar të shoqërisë prej 66,315,000 lekë, nga kjo vlera e truallit është 5,590,928 lekë, numri i aksioneve është 66,315 dhe vlera nominale e aksionit është 1000 lekë. Në llogarinë 26 nuk është përcaktuar dhe nuk është përditësuar vlera pasi është krijuar ndërmarrje ñUjësjellës Kanalizime Përmetò Sha. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 38-51 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Nga Bashkia Përmet, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të përditësuar në kontabilitet dhe për të regjistruar pjesëmarrjen 100% në kapitalin aksionar të Ujësjellës Kanalizime Përmet Sh.a me vlerë kontabël **0 lekë** në debi të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e bilancit të vitit 2021

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditmi i procedurës së prokurimit me objekt: ñRikonstruksion i shkollës së mesme ñSami Frashëriò, Bashkia Përmet, të zhvilluar në vitin 2018, me fond limit 72,310,465.lekë, u konstatua se:Kualifikimi i OE ñA. Konstruksionò ShPK, nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) është në kundërshtim me VKM nr. 42, datë 16.01.2008 *"Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zhatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi",* i ndryshuar.
OE ñA. K.ò ShPK, detyrohej që brenda 30 ditëve, të kishte bërë zëvendësimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë, në licencë, me personin e emëruar administrator sipas regjistrimit të bërë në Ekstraktin e QKB-së, ky veprim nuk është realizuar nga OE për më shumë se 9 (nëntë) muaj kalendarik.
Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, dhe shpallja fitues e OE ñA. K.ò ShPK, i cili nuk i plotëson kriteret e DT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masa për eleminimin e praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në Dokumentet e Tenderit.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara nga Njësia e Prokurimit për procedurën e prokurimit ñ*Rikonstruksion dhe ndërtim i urave në fshatrat Kutal, Verçisht dhe Zhepe*ò, i zhvilluar në vitin 2018, me fond limit 3,166,666. lekë, nuk kanë lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit, në zbatim të kërkesave të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, si dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014, ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, neni 26 dhe neni 61, ñHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, pika 2, paragrafi 2. Nuk janë argumentuar arsyet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë të ftuar për pjesëmarrje.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Përmet, të merren masa për përcaktimin e Dokumenteve të Tenderit në përputhje me natyrën dhe volumin e punimeve dhe për eliminimin e këtyre praktikave. Të argumentohen arsyet e përzgjedhjes së operatorëve ekonomik të ftuar për pjesëmarrje në prokurimin publik.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Për procedurën e prokurimitme objekt: *"Projekte për përmirësimin e kushteve të banimit për komunitetet e pa favorizuara"* mungon argumentimi i kritereve të veçanta të vendosura në DT nga Njësia e Prokurimit si dhe disa nga kriteret për kualifikim nuk janë në lidhje të ngushtë me objektin e prokurimit.
Kriteret për kualifikim dhe specifikimet teknike të hartuara për këtë prokurim nuk janë në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër prokurimin publikò, neni 46, pika 1 dhe kërkesat e VKM-së 914, datë 24.12.2014 ñPër rregullat e Prokurimit Publikò neni 26, pika 5.
Mos anulimi i procedurës është veprim në kundërshtim me nenin 24 pika 1 gërma (ç), nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 ñPër Prokurimin Publikò, dhe shpallja fitues e BOE ñE.ò Shpk & ñA. K.ò Shpk, i cili nuk i plotëson kriteret e DT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masa për përcaktimin e DT në përputhje me natyrën dhe volumin e punimeve dhe për eliminimin e këtyre praktikave të shpalljes fitues të Operatorëve Ekonomikë që nuk plotësojnë kriteret e miratuara në DT.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi*:* Në të gjitha rastet e audituara, procesverbalet/raporti përmbledhës dhe DT, nuk janë Protokolluar në Bashkinë Përmet. DT dhe shtojca për ndryshimin e DT nuk janë nënshkruar nga anëtarët e NJP. Veprime në kundërshtim me vendimin nr. 4, datë 19.6.2017 ñPër miratimin e rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisëò, neni 18, *"Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë";*
-Nuk janë kryer trajnime të stafit të prokurimit publik, në kundërshtim me pikën 2 , neni 61 të VKM r. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò e ndryshuar.
-Në dy raste, kualifikimi, shpallja fituese e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 29.12.206 ñPër prokurimin

publikò i ndyshuar. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 51-93 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Titullari i Autoritetit Kontraktor, dhe Njësia e Prokurimit në çdo rast në zhvillimin e procedurave të prokurimit natyrën dhe volumin e punimevelduke përshkruar procedurën e prokurimit publik në të gjithë fazat e realizimit.
Titullari i AK të marrë masa që ti kushtojë vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga KVO, të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomikë dhe ofertave të ofertuesve duke marrë masa për trajnimin e stafit mbi prokurimet publike, pasi në dy raste vlerësimi i ofertave konstatohet jo korrekt, me qëllim rritjen e efiçencës në shpenzimet publike, dukezhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kritereve ligjore, kapaciteteve ekonomike,financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruarqë Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, tëpakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

9. Gjetje nga auditimi: Bashkia Përmet nuk ka marrë të gjitha masat e duhura për të bërë të mundur zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit për shpërblim dëmi në vlerën 4,711,194 lekë dhe për 9 masa organizative që ende nuk janë zbatuar.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 93-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Përmet të analizojë me strukturat e bashkisë si dhe në Këshillin Bashkiak mos zbatimin e plotë të rekomandimeve të KLSH të dërguara me shkresat nr. 390/61 Prot., datë 22.10.2019 përkatës dhe hartimin e planeve specifike të punës për:

- Zbatimin rekomandimeve për shpërblim dëmi në vlerën **4,199,595**lekë;
- Zbatimin e 5 rekomandimeve organizative që janë nxjerrë urdhrat përkatës por rezultojnë ende në proces zbatimi;
- Zbatimin e 2 rekomandimeve organizative që ende nuk janë zbatuar.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve **të MFK-së referuar** Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, i ndryshuar si dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 **është konstatuar se:**

- Në Bashkinë Përmet nuk është hartuar ñHarta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzoreò, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve.
- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).
- Bashkia Përmet nuk ka miratuar ñStrategjinë e Menaxhimit të Riskutò si dhe nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, mbledhjet janë kryer nga GMS vetëm për Përgatitjen e Buxhetit Vjetor dhe Programit Buxhetor Afatmesëm. Bashkia Përmet nuk ka miratuar Plan Pune Vjetor lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjikò. Nuk e kanë të gjithë punonjësit mundësinë e përdorimit të email- it zyrtar të institucionit duke qënë se sistemi ofron një numër të kufizuar adresash email-i.
- Në vitin 2018 janë kryer vetëm 40 trajnime dhe për vitin 2019 vetëm 46 trajnime për punonjësit. Në vitin 2020 janë kryer trajnime nëpërmjet Zoom (online). Burimet Njerëzore nuk kanë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera për periudhën e auditimit.
- Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.

- Bashkia Përmet nuk ka patur në strukturën e saj Auditin e Brendshëm, e cila sjell mungesën e vlerësimeve specifike për sistemet e kontrollit të brendshëm.
- Bashkia nuk ka implementuar programe, sisteme për burimet njerëzore, për financën dhe për drejtoritë që mbledhin taksat. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 98-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Përmet të merren masa për zbatimin e të gjithë komponentëve të MFK-së:

- Të hartohet një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, ñHarta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzoreò
- Burimet Njerëzore të përpilojnë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera nga ana e tyre si dhe të njoftojë punonjësit të ndjekin trajnime me qëllim zhvillimin e tyre profesional
- Të kryejnë trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut
- Grupi i Menaxhimit Strategjik të kryej trajnime mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin
- Të ngrihet në strukturën e Bashkisë Përmet auditi i brendshëm ose të miratojë një marrëveshje me bashki të tjera për realizimin e shërbimit të Auditimit të Brendshëm.
- Bashkia Përmet të miratojë ñStrategjinë e Menaxhimit të Riskutò, të zhvillohen mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin si dhe të miratohet Plan Pune Vjetore lidhur me funksionimin e Grupit për Menaxhimin Strategjikò.
- Të mundësohet për të gjithë punonjësit përdorimi i email-it zyrtar të institucionit.

Bashkia Përmet të implementojë program për burimet njerëzore, për financën dhe për drejtoritë që mbledhin taksat duke garantuar kështu shmangien e keqpërdorimit apo të abuzimit dhe cenimit të cilësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DUKE RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1. Gjetje nga auditimi: Referuar ligjit 9632ñPër sistemin e taksave dhe tarifave vendore", në vitet 2018- 2020 ñUjësjellës Kanalizime Përmetò Sh.a, ka arkëtuar nga taksat dhe tarifat vendore vlerën 35,963,884 lekë, nga të cilat për vitet 2018 dhe 2019 ñUjësjellës Kanalizime Përmetò Sha ka përfituar 10 % të shumës mujore të derdhur dhe 5 % në vitin 2020 të të ardhurave të arkëtuara. Ky subjekt i ka transferuar nëpërmjet bankës së nivelit të dytë, Bashkisë në vlerën 22,252,444 lekë përkundrejt vlerës 32,9366,109 lekë që duhet të arkëtonte për llogari të institucionit. Detyrimi nga diferencat është rritur nga viti në vit dhe në 31.12.2020, ky detyrim është në vlerën **15,393,615 lekë, e ardhur e munguar në Bashkinë Përmet.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Bashkia Përmet të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **15,393,615 lekë** dhe të mos kemi rritje nga viti në vit të detyrimit të ñUjësjellës Kanalizime Përmetò Sh.a kundrejt Bashkisë Përmet.

Menjëherë dhe në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Vlera e debitorëve nga bizneset deri më datë 31.12.2020 paraqitet 14,022,894 lekë, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset, e cila përbën borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Përmet, referuar

ligjit 9632ñPër sistemin e taksave dhe tarifave vendore". Vlera e gjobave llogaritet në 1,897,248 lekë, e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Përmet. Në total llogaritet 15,920,142 lekë e ardhur e munguar për Bashkinë Përmet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara nga bizneset. Vlera e debitorëve nga familjarët deri më datë 31.12.2020 është 6,697,803 lekë, të ardhura të munguara për Bashkinë Përmet. Mbi këto debitorë familjarë nuk është aplikuar kamatëvonesë. Në lidhje me debitorët familjare, nuk disponojnë një database të saktë me të dhënat e tyre duke specifikuar taksat dhe tarifat që aplikohen, po ashtu nuk e kanë si format paraqitjen e informacionit të plotë ku të paraqitet debia për secilin vit duke filluar që nga vitet e mëparshme. Përdorimi i këtij formati ku të përmblidhen informacionet e mësipërme do të mundësonte analizimin e të dhënave dhe pasqyrimin më të plotë të situatës me debitorët, për secilën nga taksat dhe tarifat e papaguara. Të dhënat e mbajtura në këto formate ekzistuese, paraqesin informacion të cunguar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 18-38 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandim: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore në Bashkinë Përmet, të marrë të gjitha masat me qëllim arkëtimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën totale **22,617,945 lekë** dhe të ndjek hapat e tjera vijuese në masa shtrënguese. Në lidhje me debitorët familjare, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të krijojnë një regjistër, një database të saktë me të dhënat e debitorëve familjarë, duke specifikuar taksat dhe tarifat që aplikohen, po ashtu të paraqesin informacion të plotë ku të specifikohet debia për secilin vit, duke filluar që nga vitet e mëparshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

